

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2018



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Qershor 2019

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Përmbledhje	3
Hyrje	8
Reforma në Sektor dhe Nevoja për Agregim	10
1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	12
1.1 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave	12
1.2 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	12
1.2.1 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN	13
1.2.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale	14
1.2.3 Norma e Arkëtimit	17
1.2.4 Efiçenca e Stafit	18
1.2.5 Uji Pa të Ardhura (UPA)	19
1.2.6 Niveli i Matjes	20
1.2.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.....	20
1.3 Rezultatet Financiare të Sektorit	21
1.3.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet.....	21
1.3.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK	22
2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime	24
2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK	24
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	26
2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës	27
2.3.1 Uji Pa të Ardhura	27
2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M	33
2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale.....	39
2.3.4 Norma e Arkëtimit	41
2.3.5 Niveli i Matjes	47
2.3.6 Efiçenca e Stafit	52
2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.....	59
2.3.8 Mbulimi me Kanalizime	66
3 Konkluzione	73
4 Tema e Veçantë : Platforma e Data Baze për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë UK 74	
5 Aneks: Të dhënat Kryesore të Sektorit	77

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesor të Performancës
OAF	Operator i Alternativës së Fundit
SKP	Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korente
UPA	Uji pa të Ardhura

Përmbledhje

- Raporti i Performancës si instrument analize, informimi dhe transparence i sektorit UK** Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri të licencuar në këtë sektor përbën një detyrim ligjor të ERRU-së si institucion i pavarur. Raporti i Performancës së shoqërive UK 2018 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës të të gjithë sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri. Raporti analizon shkaqet e performancës së dobët të sektorit UK dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko ekonomike të performancës së shoqërive. Gjithashtu shoqëritë UK e shohin raportin si një mjet për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera në sektorin UK.
- Reforma e Qeverisë në Sektorin UK** Reforma në Sektorin UK e iniciuar në janar 2016, sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 për riorganizimin e sektorit në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale sipas parimit 1 bashki - 1 shoqëri UK është në përfundim të procesit. Riorganizimi i shoqërive dhe performanca e tyre në krahasim me vitin 2017 mori një shtysë të re në kuadër të aksionit të Qeverisë Qendrore për Sektorin UK. Në fakt shoqëritë UK, megjithëse operojnë dhe ofrojnë shërbimin sipas ndarjes së re territoriale nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat për riorganizimin, përkatësisht për inventarin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin në QKB të aseteve në pronësi të bashkisë. Si rezultat deri në fund të vitit 2018, vetëm 35 shoqëri UK kanë përfunduar riorganizimin e tyre. Gjatë Vitit 2018 reforma në sektor pati efekte pozitive në drejtim të eliminimit të lidhjeve të paligjshme, rritjes së numrit të ujëmatësve të instaluar, si dhe arkëtimeve të debive të prapambetura.
- Në fund të vitit 2018, për përsheptimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MIE ndërmori një iniciativë për hartimin e Ligjit të Ri për sektorin që presupozonte bashkimin e gjitha ligjeve, akteve nënligjore të sektorit në një ligj të veçantë për sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Ligji është subjekt diskutimi nga Grupi i Punës për vitin 2019, me përjasje që propozon ngritjen e strukturave të veçanta (Operatori i Alternativës së Fundit) për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK që performojnë jo mirë, administrimi i të cilave i delegohet OAF. Projekt ligji parashikon edhe një strategji agregimi të sektorit me anë të ngritjes së strukturës së Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta me pjesëmarrjen e disa njësive vendore dhe të qeverisë qendrore për menaxhimin e përbashkët të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve në dy ose më shumë bashki. .
- Shoqëritë e vogla UK kanë mungesë të kapaciteteve dhe kushteve për tu licensuar nga ERRU** Shoqëritë UK, kryesisht ato të vogla, të krijuara në zbatim të Reformës Territoriale, konstatohen se kanë mungesa në kapacitetet njerëzore kryesisht të drejtuesve teknike me diplomimin e duhur. Mbetet problem serioz pajisja e shoqërive UK me Akt Miratimin Higjeno-Sanitar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror dhe nevoja për të qartësuar procedurat dhe ndryshimet e duhura ligjore që duhet të përmbushin shoqëritë bazuar në Raportet e Inspektiveve Higjeno - Sanitare për komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë. Gjithashtu në mbështetje të mangësive të konstatuara nga këto raporte kërkohen financime për investimet e duhura në përmbushje të tyre.

**Planet e
Biznesit 5
Vjeçare për
shoqëritë UK**

Shoqëritë e riorganizuara duhet të shohin si prioritet hartimin e një Plani Biznesi 5 vjeçar me planet e veprimit përkatëse për përmirësimin e treguesve të performancës, ku përfshihet veçanërisht një program investimesh fizike, programi i lidhjeve të paligjshme, program i instalimit të ujëmatësve, përmirësimit të normës së arkëtimit etj., i cili duhet mbështetur financiarisht nga bashkitë dhe AKUM dhe donatorët kryesisht për shoqëritë e vogla, të cilat nuk kanë kapacitete dhe mjetet e duhura financiare për realizimin e tij.

**Performanca e
Sektorit UK**

Performanca e sektorit të UK jepet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 1 bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës që ERRU përdor për të vlerësuar performancën e shoqërive UK.

Tabela 1. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK

Treguesit e Performancës	2017	2018	Tendencë	Performancë e Mirë (ERRU)
Uji Pa të Ardhura (%)	65	63	↗	30
Mbulimi i Kostove O&M (%)	109	119	↗	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	85	92	↗	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	92.76	98	↗	82
Norma e Arkëtimit Korente(%)	78.84	79	↗	82
Niveli i Matjes (%)	68.3	74	↗	85
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.50	5.35	↗	4/6/10
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	12	12.7	↗	18
Mbulimi me Kanalizime UN (%)	50.2	52	↗	75
Mbulimi me F. me Ujë (%)	78.3	77	↘	n/a

Burim informacioni: AKUM

Treguesit e Performancës së sektorit për vitin 2018 përgjithësisht kanë tendencë pozitive krahasuar me një vit më parë, përveç treguesit "Mbulimi me furnizimin me ujë" që ka tendencë negative dhe treguesit "Norma e Arkëtimit Korente", e cila ka mbetur në të njëjtin nivel.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë krahasuar me vitin 2017, edhe pse është përmirësuar mbetet përsëri në vlera jo të kënaqshme. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit ka një përmirësim të lehtë, edhe pse në përgjithësi sektori paraqitet i mbingarkuar më staf dhe shtimi i tij konstatohet edhe përgjatë vitit 2018. Gjithashtu, një përmirësim të ndjeshëm për vitin 2018 kanë patur edhe treguesit financiarë të mbulimit të kostove O&M dhe atyre Totale respektivisht me 10% dhe 7% krahasuar me një vit më parë.

**Besueshmëria
dhe Saktësia e
të dhënave të
Raportuara
nga Shoqëritë
UK**

Besueshmëria dhe Saktësia e të dhënave në mënyrë sistematike mbetet një problem shqetësues në Raportimet që shoqëritë UK bëjnë pranë AKUM, të dhëna mbi të cilat bazohet edhe hartimi i Raportit të Performancës i vitit 2018. Pasaktësira të konsiderueshme vërehen si në drejtim të të dhënave ekonomike ashtu dhe në ato teknike e për rrjedhojë dhe llogaritja e treguesve rezulton me gabime. Ky fakt konstatohet nga ERRU gjatë verifikimeve të bilanceve Financiare por dhe gjatë aplikimeve për tarifa të shoqërive UK. Nga ana tjetër dhe bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, hartohen në mënyrë empirike dhe sipërfaqësore për shkaqe të ndryshme, por kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me

ujë. Kjo sjell si pasojë që treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura, si edhe tregues të tjerë të rezultojnë me shkallë të lartë pasaktësie.

Duke patur parasysh faktorët e mësipërm për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, hartuesit e Raportit kanë qenë shumë të kujdesshëm në kryerjen e analizës së të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij atë pjesë të të dhënave që nuk kanë një bazë justifikimi për të eliminuar vlerësimet e gabuara mbi performancën e sektorit në përgjithësi, si dhe të secilës shoqëri në veçanti. ERRU ka ndërmarrë hapat e duhur që brenda vitit 2019 të ndërtojë sistemin e saj të pavarur të të dhënave sipas një platforme praktike në Excel, e cila do të shërbejë si një bazë e mirë monitorimi dhe saktësimi të të dhënave.

**Gjendja
financiare e
Sektorit UK**

Gjendja financiare e sektorit për vitin 2018 krahasuar me vitin paraardhës është përmirësuar, të ardhurat nga aktiviteti (faturimi për shërbimet UK dhe të ardhura të tjera të aktivitetit) janë rritur me rreth 1 403,6 milion lekë ndërsa kostot e O&M dhe ato Totale janë rritur respektivisht me 468 milion lekë dhe 830.7 milion lekë. Shoqëritë me rritje të konsiderueshme të të ardhurave janë UK Tiranë me 1 177 milion lekë, UK Durrës me 207 milion lekë, UK Korçë me 64 milion lekë, UK Kavajë me 64 milion lekë dhe UK Sarandë me 26 milion lekë.

Në total për vitin 2018 janë 17 shoqëri që përballojnë kostot O&M nga 55 shoqëri që kanë dhënë informacion pranë AKUM. Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes është rritur ndjeshëm kryesisht për shoqëritë e grupit të parë nga 104% në vitin 2017 në 133% për vitin 2018.

Nevoja reale për subvencione për 38 shoqëri që nuk mbulojnë kostot O&M llogaritet në 1 041 milion lekë (rreth 8.3 milion euro) aq sa janë edhe subvencionet e akorduara për vitin 2018 në vlerën e 1 056 milion lekë (rreth 8,4 milion euro), nga të cilat 52% të totalit të nevojës për subvencione i përkasin shoqërive, UK Vlorë (21%), UK Kavajë (10%), UK Kurbin (7%), UK Patos (14%).

Nga shpërndarja reale e subvencioneve shihet se për disa shoqëri ato janë akorduar mbi nevojat reale të mbulimit të shpenzimeve për O&M, ndërsa në disa të tjera janë akorduar nën nevojat reale të tyre. Gjithsesi kërkohet më shumë transparencë për mënyrën e shpërndarjes së fondeve të subvencioneve në të ardhmen.

**Shoqëritë UK
janë të
mbingarkuara
me staf**

Efektet e riorganizimit të shoqërive vazhdojnë të ndihen sidomos në drejtim të rritjes së stafit drejtues dhe operues i cili është zëri kryesor në kostot e shoqërisë. Megjithatë për vitin 2018 ky tregues ka patur tendencë pozitive mesatarisht (5,35 nga 5.5 staf/1000 lidhje UK), ende mbetet jo në nivelin e kërkuar. Përmirësimi ka ardhur vetëm si rezultat i shtimit të numrit të lidhjeve UK dhe jo të reduktimit të stafit i cili përkundrazi është shtuar me 412 punonjës. Shtimi i numrit të punonjësve argumentohet si rezultat i riorganizimit të shoqërive në përputhje me reformën nga punonjësit shtesë të zonave rurale, si edhe në plotësim të detyrimeve ligjore në garantim të sigurisë së veprave të ujësjellësit me personel roje. Ky problem duhet konsideruar për t'i dhënë zgjidhje teknike sigurisë së këtyre objekteve për të mundësuar uljen e kostove të fuqisë punëtore në shoqëritë UK.

**Nevoja për
agregimin e
sektorit**

Nevoja për agregim është imediate pasi një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me 57 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta. Agregimi i shoqërive UK propozohet si zgjidhje dhe instrument i domosdoshëm që bën të mundur operimin më eficient të shoqërive. Për këtë ERRU propozon seleksionimin e 2-3 rasteve të mundshme të një agregimi të suksesshëm sipas parimit me baza vullnetare dhe

me incentiva nga qeveria qendrore. Këto raste do të shërbejnë më tej si bazë për agregimin aty ku është e mundshme për të gjithë sektorin.

Investimet në Nivelin Strategjik dhe Agregimi

Gjatë vitit 2018 investimet në sektorin e ujësjellës kanalizimeve janë realizuar pjesërisht nga buxheti i shtetit (35%), ndërsa pjesa tjetër prej 65% është realizuar nga donatorët e huaj në formën e granteve ose huave në norma të ulta interesi. Totali i këtyre investimeve shkon në rreth 70 milion euro, që akoma mbetet larg nevojave reale për investime në sektor. Tabela 2 jep investimet e realizuara në sektor gjatë 3-viteve të fundit që tregojnë se ka tendencë rënie të tyre.

Tabela 2. Investimet e Kryera në Sektor, Vitet 2016, 2017, 2018

		<i>në 000/lekë</i>		
	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Burimi i Financimit	Financim nga Buxheti	4,108,555	4,194,097	3,106,825
	Financim i Huaj	8,504,013	6,435,508	5,592,681
Total		12,612,568	10,629,605	8,699,506
Destinacioni	Ujësjellës	4,950,000	5,000,000	4,245,937
	Kanalizime	4,712,568	2,900,000	2,224,520
	ITUN	2,950,000	2,729,605	2,224,749

Referuar planifikimeve të investimeve të planifikuara dhe alokuara në sektor vërehet se deri në fund të vitit 2018 ato janë realizuar mesatarisht me rreth 95%, që konsiderohet si një performancë mjaft pozitive.

Referuar Master Planit të Furnizimit me Ujë dhe KUN nevojat për investime në sektor të projektuara deri në vitin 2040 vlerësohen rreth 6 miliard euro, ku pjesa më e madhe (rreth 4 miliard) i takon KUN dhe impianteve të pastrimit të tyre, ose kërkohen mesatarisht financime rreth 270 milion Euro në vit. Vlera është mjaft e lartë në lidhje me mundësitë reale të financimit të tij, i cili në 10 vitet e fundit ka rezultuar në shifrat rreth 50-60 milion euro në vit nga buxheti i shtetit dhe donatorët.

Ndihet nevoja e miratimit të draftit mbi dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve. Modeli i hartuar për mbulimin e skemës së financimit në 2016 identifikoi kostot për arritjen e objektivave të sektorit, sipas sistemit 3T-të, nga Taksat, Transfertat (qeveri, donatorë), si dhe nga Tarifat e konsumatorëve duke marrë parasysh kriterin e përballueshmërisë nga këto të fundit.

KONKLUZIONE

- Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK duhet të forcojnë angazhimin e tyre për të përfunduar procesin e riorganizimit sipas reformës me regjistrimin e aseteve dhe hapat e tjerë burokratike të domosdoshme.
- Shoqëritë duhet të kenë në vëmendje të tyre menaxhimin e aseteve, identifikimi dhe hartimi i planeve për menaxhimin e tyre mundëson jo vetëm një menaxhim më të mirë të aktiveve fikse, por për hartimin e planeve për uljen e humbjeve teknike dhe administrative në sistemet e furnizimit me ujë.
- Duke pasur parasysh deficitin financiar të operimit të sektorit UK dhe nevojës për subvencione, për shëndoshjen financiare të sektorit vëmendja kryesore duhet fokusuar në problematikat individuale të shoqërive, duke analizuar performancën e tyre, mundësitë për përmirësim e në fund në orientimin e drejtë të subvencioneve deri sa shoqëritë të bëhen të qëndrueshme nga ana financiare.

- Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK. Shoqëritë duhet të nxiten dhe të mbështeten nga qeveria qendrore që të instalojnë matës si në burim ashtu edhe në pikat e konsumit në mënyrë që të hartohen bilance të sakta të ujit, si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi tyre si një prerogativë ligjore kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja. AKUM të vlerësojë nevojat dhe të incetivojë financimin e hartimit të tyre nga qeveria qendrore dhe donatorët për shoqëritë që kanë mundësi financiare të kufizuara.
- Të rivlerësohet situata për konceptimin e ligjit të ri të sektorit UK si një ligj ku presupozohet përfshirja në një dokument të vetëm e gjithë legjislacionit aktual dhe nënakteve të tij, që e bën atë mjaft të rënduar për t'ju përgjigjur dinamizmit që kërkojnë mjaft pjesë të tij. Rekomandohet mbajtja e tij në kornizat e ligjit aktual nr. 8102 për rregullimin e sektorit i propozuar për t'u rishikuar dhe të trajtohen si nënakte më vete Kodi i Ujit (ka nevojë urgjente për tu rishikuar), si dhe legjislacioni për Akt Miratimin Higjeno Sanitar që lëshon Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, i cili ka mjaft mangësi praktike për realizimin e tij.
- Të analizohen thellësisht elementët bazë të qasjes së re si strategji për përmirësimin e performancës së sektorit në aspektet praktikore ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta.
- ERRU rekomandohet të përfshihet në procesin e përcaktimit të prioriteteve të investimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, si dhe në aprovimin e tyre bazuar në kritere tekniko ekonomike.
- Të thellohet vlerësimi i elementeve të përballueshmërisë së tarifave nga ERRU në bashkëpunim me INSTAT, si kriteri përfundimtar verifikues i mbulimit të kostove të shërbimeve nga fatura e konsumatorëve. Nisur nga ky kriter ERRU duhet të vlerësojë dhe të klasifikojë veç ato shoqëri shëndoshja financiare e të cilave kërkon tarifa mjaft të larta të papërballueshme për konsumatorët dhe që duhet të subvencionohen nga qeveria qendrore apo vendore.
- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.
- Sektori paraqitet mjaft i fragmentarizuar prandaj ndihet e nevojshme që qeveria qendrore të shoh si prioritet të afërt fillimin e realizimit të strategjisë së agregimit të shoqërive me një ose dy projekte pilot, aty ku shihet më i mundshëm suksesi, duke respektuar kriteret e vullnetit të lirë të pronarëve si dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Strategjia e agregimit të sektorit duhet të orientohet kryesisht në grupin e shoqërive të dimensionit të mesëm, rast pas rasti dhe jo në bllok.

Hyrje

Enti Rregullator i Ujit është një institucion publik i pavarur, përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar. Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri të licencuar në këtë sektor përbën një detyrim ligjor të ERRU-së. ERRU si institucion i pavarur ka për detyrë që të jetë sa më objektiv në vlerësimet e tij për sektorin e UK, pjesë e rëndësishme e të cilit është hartimi i Raportit Vjetor 2018 të Performancës të Sektorit UK.

Raporti i Performancës së shoqërive UK 2018 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës të të gjithë sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Raporti bazohet në të dhënat teknike ekonomike vjetore të operimit të shoqërive UK për vitin 2018 që raportohen në AKUM në Njësinë e Monitorimit dhe Benchmarking. Të dhënat në aspektin kohor janë të disponueshme për ERRU brenda muajit Maj 2019. Nisur nga rëndësia e analizës, konkluzioneve dhe rekomandimeve që jepen në Raport për përmirësimin e performancës së Sektorit UK, ERRU, tashmë për të tretin vit radhazi ka bërë përpjekjet maksimale që raporti të jetë i publikuar deri në fund të Qershorit 2019 në mënyre që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2018.

Raporti analizon shkaqet e performancës së dobët të sektorit UK dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të performancës së shoqërive. Gjithashtu shoqëritë UK e shohin raportin si një mjet për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera në sektorin UK.

Sektori UK gjatë vitit 2018 krahasuar me vitin paraardhës përgjithësisht ka patur tendencë pozitive pothuajse në të gjithë treguesit, përjashtuar vetëm treguesin e "Mbulimi me furnizimin me ujë" për të cilin tendenca është negative, ndërsa treguesi "Norma e Arkëtimit Korente" ka mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2017. Përmirësimi i performancës së sektorit argumentohet me një angazhim në rritje të stafit drejtues të shoqërive UK në intensifikim të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve që ka ndërmarrë qeveria qendrore.

Përmirësimi i performancës së sektorit UK në të gjithë treguesit e saj lidhet kryesisht me përballimin e problematikave nga riorganizimi i shoqërive UK pas reformës duke marrë zonat rurale që më parë administroheshin nga vetë ish Komunat.

Përfshirja e zonave të reja rurale në zonën e shërbimit të shoqërive UK përbën një barrë financiare shtesë për këto të fundit pasi shpenzimet e operimit i kanë pasur të pambuluara nga të ardhurat për shkak të tarifave mjaft të ulëta që aplikoheshin më parë në këto zona, si dhe nga shkalla e ulët e nivelit të arkëtimit. Problematikat e akumuluar në të shkuarën në sektor diktuan nevojën urgjente që reforma në sektor të rikonsiderohej në baza të tjera më realiste dhe efektive, ku të përfshinte ndër të tjera zbatimin e masave emergjente brenda një afati tremujor kryesisht në eliminimin e lidhjeve të paligjshme, si dhe objektiva që duhet të realizohen deri në fund të vitit 2018.

Qeveria qendrore gjatë vitit 2018, me synim shëndoshjen financiare të shoqërive UK, krahas fushatës për eliminimin e lidhjeve të paligjshme, procedoi me nënshkrimin e kontratave të performancës ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përfaqësuar nga AKUM dhe Bashkive në vend bazuar në tregues performance apriori dhe në vlera të njëjta për të gjitha shoqëritë, të cilat do të saktësoheshin nga analiza e realizimit të tyre në fund të vitit. Përcaktimi i vlerës së tyre nga vlerësimi i realizimit të tyre në fund të vitit do të shërbente si bazë nisje për vendosjen e objektivave për t'u arritur nga shoqëria në vitin në vazhdim (2019).

Si rezultat i reformës, sektori pati një ecuri pozitive në drejtim të eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rrjedhojë e aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar i cili ndikoi në rritjen e numrit të klientëve, rritjen e numrit të ujëmatësve të vendosur, gjithashtu edhe rritjen e arkëtimit të debive të prapambetura si rezultat i angazhimit serioz të shoqërive UK për arkëtimin e tyre, por edhe të rritjes së ndërgjegjes së konsumatorëve.

Është evident fakti se shoqëritë UK të riorganizuara kanë nevojë urgjente që të hartojnë Planet e Biznesit 5 Vjeçar për të bërë një skanim të situatës, problematikave në menaxhim dhe nevojave për investime.

Pajisja me Plane Biznesi 5 Vjeçare të shoqërive UK duhet të konsiderohet si domosdoshmëri apo prerogative ligjore, jo vetëm si instrument për mirëmanaxhimin e shoqërive, por edhe si argument kryesor justifikues kur ato aplikojnë për tarifa të reja tek ERRU-ja.

Planet e biznesit, planet e menaxhimit të aseteve, programet e lidhjeve ilegale janë disa nga instrumentet orientuese kryesore për shëndoshjen e gjendjes financiare të shoqërive UK dhe për të përcaktuar nevojat për investime fizike.

Si konkluzion, përmirësimi i performancës për të gjithë sektorin në tërësi duhet të lidhet ngushtësisht me një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve të këtij sektori, përkatësisht shoqërisë UK, bashkisë dhe qeverisë qendrore me të gjithë instrumentet e tjerë në mbështetje të tyre.

Reforma në Sektor dhe Nevoja për Agregim

Reforma në Sektorin UK e cila i ka fillimet e saj në janar 2016, kohë kur u miratua VKM nr. 63, presupozonte riorganizimin e shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki dhe duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2016, proces i cili akoma nuk ka përfunduar për të gjitha shoqëritë UK. Aktualisht shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin sipas ndarjes së re territoriale, por nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas parashikimeve që kishte procesi i riorganizimit në drejtim të inventarit fizik, vlerësimit dhe regjistrimit në pronësi të bashkisë të njërive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e shoqërive UK. Reforma paraqiti mjaft vështirësi në riorganizimin burokratik të shoqërive, si dhe në përmbushje të kërkesave të kapaciteteve të stafëve të shoqërive ku deri në fund të vitit 2018, vetëm 35 nga 58 shoqëri UK kishin përfunduar riorganizimin e tyre.

Shtypa kryesore për reformën ishte performanca mjaft e dobët e sektorit gjatë gjithë fazës së tranzicionit, si në aspektin financiar, edhe atë të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve pasi sektori UK mbetej një barrë e rëndë financiare për buxhetin për financimin e shpenzimeve të O&M, pa përmendur nevojat për investime fizike.

Në vijim të reformës me synim shëndoshjen financiare të shoqërive UK në fillim të vitit 2018 nga ana e qeverisë qendrore u procedua me nënshkrimin e Kontratave të Performancës ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përfaqësuar nga AKUM dhe Bashkive në vend bazuar në tregues performance apriori dhe në vlera të njëjta për të gjitha shoqëritë, të cilat do të saktësoheshin nga analiza e realizimit të tyre në fund të vitit. Përcaktimi i vlerës së tyre nga vlerësimi i realizimit të tyre në fund të vitit do të shërbente si bazë nisje për vendosjen e objektivave për t'u arritur nga shoqëria në vitin në vazhdim (2019).

Kontrata shoqërohej me incentiva si subvencione që duhet të përftonin shoqëritë UK, dhe/ose investime fizike për performancën e arritur. Duhet theksuar rëndësia e përqendrimit të fokusit në hartimin dhe monitorimin e saktë të kontratave të performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive ku padyshim kërkohet bashkëpunimi me ERRU-në për përcaktimin e Treguesve të Performancës bazë të këtyre kontratave dhe peshës së secilit tregues rast pas rasti. Shkalla e realizimit të treguesve nga ERRU, si institucion i pavarur dhe i ngarkuar për monitorimin e sektorit do t'i shërbente më mirë vlerësimit të performancës së secilës shoqëri UK.

Viti 2018, si rezultat i reformës të iniciuar nga qeveria qendrore, pati një ecuri pozitive në sektor në drejtim të:

- eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rezultat i aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar, kjo ndikoi edhe në rritjen e numrit të klientëve;
- rritjes së numrit të ujëmatësve të vendosur: pothuajse të gjitha shoqëritë për vitin 2018 kanë shtuar numrin e ujëmatësve të instaluar, kjo ka ndikuar edhe në përmirësimin e treguesit niveli i matjes;
- arkëtimeve të debive të prapambetura: u rrit ndjeshëm përgjegjshmëria qytetare për likuidimin e debive të prapambetura duke u bërë pjesë e marrëveshjeve individuale për shlyerjen e tyre.

Gjithsesi, me gjithë përmirësimin e lehtë të gjendjes financiare të sektorit, rezultoi se nuk u arritën pritshmëritë e parashikuara nga reforma sidomos në drejtim të influencës së uljes së humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme. Për uljen e humbjeve u realizua një studim me asistencën e huaj për

tetë shoqëritë UK më të mëdha të vendit financiar nga GIZ, që ofrojnë shërbime për mbi 70% të popullsisë për hartimin e një plani veprimi për zvogëlimin e tyre.

Në fund të vitit 2018, për përshpejtimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MEI përpiloi një qasje e cila është ende në diskutim me të gjithë aktorët në sektor para se të formalizohet për zbatim. Qasja ka në themel të saj që për shoqëritë UK që nuk performojnë të mundësohet marrja e menaxhimit të tyre nga një subjekt i quajtur Operatori i Alternatives së Fundit (OAF), i cili do të krijojë mundësinë e rritjes së performancës së tyre, si dhe duke ndjekur njëkohësisht dhe një strategji agregimi të tyre me anë të krijimit të Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta (SKP) me marrëveshje ndërmjet Qeverisë Qendrore dhe bashkive përkatëse.

Qasja është akoma në proces diskutimi në drejtim të detajeve të realizimit të saj në praktikë të të dy subjekteve. Gjithsesi nevoja për agregim është imediate pasi një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me 57 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta.

Vendi ynë është në prag të hapjes së negociatave për pranimin në Bashkimin Evropian. Me hapjen e negociatave pritët që Bashkimi Evropian të japë fonde të konsiderueshme për sektorin e ujit në përmbushje të standardeve të Direktivës së Ujit të KE. *Një sektor i fragmentarizuar ka kapacitete mjaft të kufizuara për përthithjen e këtyre fondeve.* Nga eksperiencia e mëparshme e vendeve pas hapjes së negociatave për në BE, përthithja e këtyre fondeve nga një sektor i fragmentarizuar bëhet me vështirësi, dhe në fund veprat e ndërtuara prej tyre rezultuan me kosto operimi dhe mirëmbajtje (O&M) të pajustificueshme nga ana ekonomike.

Agregimi i shoqërive UK, si shprehje tipike e avantazhit të ekonomisë së shkallës, propozohet si zgjidhje dhe instrument i domosdoshëm që bën të mundur jo vetëm përthithjen me të shpejtë në sasi të këtyre fondeve, por më tej, veprat e realizuara prej tyre kanë kosto O&M ekonomikisht efikase.

Për sa më sipër, ERRU ka rekomanduar:

- Të vazhdohet procesi i vlerësimit të treguesve të performancës dhe analizës për secilën shoqëri UK, si proces mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e instrumenteve përkatës për shëndoshjen financiare të tyre;
- Rivlerësimi i kontratave të performancës me pjesëmarrjen edhe të ERRU-se për vlerësimin e treguesve kryesorë të performancës dhe objektivave së bashku me AKUM.
- Duhet të punohet paralelisht për nisjen e procesit të agregimit si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar që fillimisht të realizohen 2-3 agregime të suksesshme. Realizimi me sukses do të shërbejë si shembull bëshmërie i realizimit të strategjisë së sektorit për t'u zhvilluar në shkallë të gjerë në periudhën afatmesme.

1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave

Raporti i performancës së shoqërive UK dhe të sektorit për vitin 2018 hartohet duke përdorur të dhënat e AKUM si dhe bilancet financiare të vitit 2018 që shoqëritë kanë dorëzuar pranë ERRU.

Ende vërehen pasaktësi të konsiderueshme si në drejtim të të dhënave teknike ashtu dhe në ato ekonomike e për rrjedhojë dhe llogaritja e treguesve rezultojnë me gabime. Ky fakt reflektohet veçanërisht në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilat hartohen në mënyrë empirike dhe sipërfaqësore për shkaqe të ndryshme, por kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo sjell si pasojë që treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura të rezultojë me shkallë të lartë pasaktësie.

Po kështu, ka pasaktësi edhe në raportimet që bëjnë shoqëritë në drejtim të arkëtimit të detyrimeve korente dhe atyre të prapambetura mbi bazën e të cilave llogaritet treguesi Norma e Arkëtimit.

Përveç faktorëve të njohur lidhur me mungesën e saktësisë së të dhënave nga shoqëritë UK, një ndikim negativ të konsiderueshëm ka patur mos përfundimi i riorganizimit të shoqërive sipas Reformës Territoriale dhe VKM Nr. 63, datë 27.01.2016, i cili duhej të kishte përfunduar në fund të vitit 2016. Deri në fund të vitit 2018 nga totali prej 57 shoqëri UK vetëm 35 prej tyre janë riorganizuar dhe licencuar nga ERRU.

Tabela 31 në Aneks 1 paraqet në detaje gjendjen e riorganizimit të sektorit për të gjithë shoqëritë UK sipas raportimeve të tyre. Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK duhet të forcojnë angazhimin e tyre për të përfunduar procesin e riorganizimit të tyre me regjistrimin e aseteve dhe hapat e tjerë burokratike të domosdoshme sepse pjesa dërmuese e shoqërive raportojnë pranë AKUM të dhënat për të gjithë zonën, pasi ato kryejnë shërbimin UK në zonë sipas ndarjes së re Administrative, pavarësisht se nuk ka përfunduar ligjërisht procesi i riorganizimit të tyre.

Duke patur parasysh faktorët e mësipërm për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, hartuesit e Raportit kanë qenë shumë të kujdesshëm në kryerjen e analizës së të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij atë pjesë të të dhënave që nuk ka një bazë justifikimi për të eliminuar vlerësimet e gabuara mbi performancën e sektorit në përgjithësi, si dhe të secilës shoqëri në veçanti.

1.2 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Performanca e përgjithshme e sektorit UK për vitin 2018 nëpërmjet 10 Treguesve Kryesorë të Performancës paraqitet në Tabelën 3. Në të jepet gjithashtu edhe tendenca e performancës krahasuar me arritjet e vitit 2017, si dhe me objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU.

Tabela 3. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK

Treguesit e Performancës	2017	2018	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
Uji Pa të Ardhura (%)	65	63	↗	30
Mbulimi i Kostove O&M (%)	109	119	↗	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	85	92	↗	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	92.76	98	↗	82
Norma e Arkëtimit Korente(%)	78.84	79	↗	82
Niveli i Matjes (%)	68.3	74	↗	85
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.5	5.35	↗	4/6/10
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	12	12.7	↗	18
Mbulimi me Kanalizime UN (%)	50.2	52	↗	75
Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	78.3	77	↘	n/a

Shënim: Burimi: AKUM

Nga tabela e mësipërme vërehet që nivelet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 përgjithësisht kanë tendencë pozitive. Vetëm për treguesin "Mbulimi me furnizimin me ujë" tendenca është negative, ndërsa treguesi "Norma e Arkëtimit Korente ka mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2017.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë (mesatarisht 12,7 orë/ditë), si dhe treguesi i Ujit Pa të Ardhura (63%) krahasuar me vitin 2017, edhe pse janë përmirësuar mbeten përsëri në vlera të papranueshme. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit (mesatarisht 5,35 staf/1000 lidhje) ka një përmirësim të lehtë edhe pse në përgjithësi sektori paraqitet i mbingarkuar me staf dhe shtimi i tij konstatohet edhe përgjatë vitit 2018.

Treguesit Mbulimi i Kostove O&M si dhe i Kostove Totale paraqitet në nivele të mira dhe me një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitin paraardhës. Gjithsesi baza e vlerësimit për të konsideruar si performancë e mirë ose jo që konsideron ERRU në metodologjinë e saj për disa prej tyre duket jo në përputhje me evoluimin e sektorit. ERRU krahas rishikimit të metodologjisë së vendosjes së tarifave është duke rishikuar edhe bazën e re të vlerave për Indikatorët Kryesor të Performancës për një vlerësim (benchmarking) të sektorit në përgjithësi dhe secilës shoqëri UK në veçanti.

1.2.1 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN

Treguesi "Mbulimi me FU" për të tretin vit radhazi rezulton me rënie ndërsa treguesi "Mbulimi me KUN" për vitin 2018 është përmirësuar me 1.8% krahasuar me vitin 2017.

Popullsia në zonën e juridiksionit për vitin 2018 raportohet rreth 4.1 milion banorë nga 3.8 milion që ishte në vitin 2017, pra me një rritje me 300 mijë banorë. Konstatohet se riorganizimi i shoqërive vit pas viti po afron raportimin e popullsisë së sektorit UK me atë të regjistrave të gjendjes civile.

Popullsia e shërbyer me furnizimin me ujë në krahasim me vitin 2017 raportohet të jetë shtuar me 208 mijë banorë, ndërsa ajo me kanalizime është shtuar me 233 mijë banorë ose të shprehura në përqindje, 69% dhe 78% përfitojnë shërbimet respektive ujë dhe kanalizime kundrejt popullsisë prej 300 mijë

banorëve të shtuar në juridiksion. Gjithsesi këto të dhëna për popullsinë duken që përmbajnë pasaktësi sepse dihet që popullsia rezidente në vendin tonë është ulur ndjeshëm. Me censusin e ri të popullsisë që INSTAT do të zhvillojë së shpejti do të kemi shifra më të sakta që do të merren parasysh në llogaritjen e treguesve të performancës, si dhe të kërkesës reale për ujë.

Zona urbane aktualisht shërbehet me ujë të pijshëm në nivelin 93.2% kundrejt 58.5% që shërbehet në zonat rurale.

Theksohet se shërbimi i kanalizimeve në zonën rurale është ende në nivele të ulëta rreth 15% kundrejt 79.8 % që është në zonën urbane. Në pjesën më të madhe në zonën rurale mungon rrjeti mbledhës dhe zgjidhja e shkarkimeve të ujërave të ndotura kryesisht bëhet individualisht me gropa septike.

Duke patur parasysh dendësinë e popullsisë me një shtrirje në distanca të mëdha të konsumatorëve në to, zgjidhjet individuale kanë sens ekonomik, por janë të pranueshme nga ana inxhinierie dhe mjedisore vetëm kur respektohen kushtet teknike për gropat septike. Kjo është një sfidë e së ardhmes, sepse në përgjithësi zbatohen gropa të thjeshta grumbullimi ujërash të ndotura në vend të gropave septike. Gjithsesi nevojat për investime krahas shërbimit të FU duhet të orientohen edhe drejt atij të KUZ me qëllim që të rregullohen dhe balancat midis dy shërbimeve.

1.2.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale

Viti 2018 krahasuar me vitin 2017 ka shënuar një përmirësim të treguesve të Mbulimit të Kostove të O&M dhe ato Totale respektivisht me 10% dhe 7%. Ky përmirësim ka ardhur nga fakti se të ardhurat nga aktiviteti për sektorin UK janë rritur me rreth 1 403.6 milion lekë, ndërsa Kostot e O&M janë rritur me 468 milion lekë, ndërsa Kostot Totale me 830.7 milion lekë.

Tabela 4 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2017 dhe 2018 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në Lekë dhe në përqindje.

Tabela 4. Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2017 e 2018

Nr	Zërat e Shpenzimeve	Viti 2017	Viti 2018	Diferenca (2018-2017)	Rritja në % 2018/2017
1	Kostot e Punës	3,367,455	3,760,301	392,846	11.6%
2	Kostot e Energjisë Elektrike	2,516,869	2,365,574	(151,295)	(6%)
3	Kostot e Riparimeve	705,816	545,576	(160,240)	(22.7%)
4	Shërbimet nga Nënkontraktorët	638,394	779,886	141,492	22%
5	Kosto e Materialeve e Kimikateve	162,998	216,069	53,071	32.5%
6	Kosto të Tjera	337,400	559,484	222,084	66%
	Kostot e O&M	7,728,932	8,226,890	+497,958	6.4%
7	Kostot e Amortizimit	1,657,834	1,897,345	239,511	14.4%
8	Të tjera Financiare Tatime Taksa, Kredi	462,613	555,886	93,273	20%
	Kostot Kapitale	2,120,447	2,453,231	332,784	15.7%
	Kostot Totale	9,849,379	10,680,121	830,742	8.5%

Për vitin 2018 kostot e Operimit dhe të Mirëmbajtjes janë rritur me rreth 6.4%. Rritje të konsiderueshme ka shënuar zëri “Kostot e Punës “ si dhe “ Shërbimet nga nënkontraktorët” që të dyja në total zënë 66% të kostove të rritura të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Rritje të ndjeshme kundrejt vitit 2017 ka shënuar zëri “Kosto të Tjera” në të cilin shoqëritë fusin ato kosto të cilat nuk janë të pasqyruar në zërat e tjerë të cituar më lart, të cilat përmbledhin kryesisht kostot për pagesat rregullatore dhe detyrime të prapambetura ndaj ERRU, SHUKALB-it, Këshillave të Administrimit, tarifave ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël etj. Këto kosto rezultojnë të larta edhe për faktin se një pjesë e zërave analitik të tyre deri në mbyllje të nëntëmujorit 2017 janë raportuar në zëra të tjerë sintetik të kostove e mbas kësaj periudhe me sugjerim dhe të AKUM raportohen në zërin “Kosto të Tjera”.

Në detaje analiza për secilin zë të kostos të paraqitur në Tabelën 3 paraqitet si me poshtë:

Kosto e Punës Sektori për vitin 2018 e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 7 124 punonjës ose 374 punonjës më shumë se ata të raportuar në vitin 2017.

Shoqëritë që kanë rritur ndjeshëm numrin e punonjësve (punonjësit e vet dhe ata nga nënkontraktorët) janë UK Kurbin me 55 punonjës, UK Vorë me 52 punonjës UK Maliq me 28 punonjës, UK Lushnjë me 20 punonjës.

Efektet e riorganizimit të shoqërive vazhdojnë të ndjehen sidomos në drejtim të rritjes së stafit drejtues dhe operues. Shoqëritë argumentojnë se shtimi i numrit të punonjësve ka ardhur si rezultat i riorganizimit të tyre në përputhje me reformën ku përfshihen mjaft punonjës shtesë të sistemeve të zonave rurale që më parë administroheshin nga vetë ish komunat, apo punonjësit shtesë që kërkohen për të menaxhuar komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë nga projekte të ndryshme.

Në përgjithësi, sektori është i mbingarkuar me staf të pajustificuar. Lidhur me këtë tregues, kërkohet një analizë e thelluar për secilën shoqëri në lidhje me numrin e punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesën reale për çdo pozicion pune.

Në total, rritja e raportuar e numrit të stafit ka sjellë rritjen e Kostove të Punës me rreth 392.8 milion lekë në vit.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara Në të gjithë sektorin UK janë 8 shoqëri që shërbimin e rojeve e kryejnë nga njësi të specializuara. Për vitin 2018 numri i punonjësve nga nënkontraktorët është rritur me 56 punonjës, gjë e cila ka dhënë efekt në rritjen e kostove të këtij shërbimi në total për sektorin me rreth 141 milion lekë. UK Tiranë ka rritur kostot e shërbimeve të nënkontraktuara në mënyrë të ndjeshme me vlerën rreth 65% të totalit të mësipërm. Rritje të konsiderueshme të numrit të punonjësve dhe të kostove përkatëse paraqesin gjithashtu edhe shoqëritë UK Vlorë e UK Shkodër.

Nga ana e stafit drejtues të shoqërive, ky shtim i numrit të punonjësve justifikohet me rritjen e numrit të vend rojeve si pasojë e rritjes së komponentëve të ujësjellësit (depo, stacione pompimi, puse etj.) nga riorganizimi i shoqërive, të cilët konsiderohen si objekte me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit të popullsisë. Siç është theksuar edhe në raportet e mëparshme legjislacioni për këtë pikë duhet rishikuar për garantimin e sigurisë së objekteve të rëndësisë së veçantë me zgjidhje alternative teknike apo logjistike.

Një menaxhim i mirë i shoqërive duhet shoqëruar me menaxhim të mirë të burimeve njerëzore, duke punësuar staf të kualifikuar e në përputhje me nevojat, por duke treguar kujdes që ritmet e rritjes së

kostove të shoqërohen me rritje të të ardhurave me qëllim që shoqëritë të rikuperojnë kostot e pranueshme dhe të domosdoshme.

Kosto të tjera. Ky zë ka një rritje me rreth 222 milion lekë të rritjes totale të kostove, një pjesë e të cilave konsiderohen artificiale sipas sqarimit të mësipërm.

Në kostot e tjera shoqëritë raportojnë detyrimet ndaj ERRU, SHUKALB-it, pagesat e këshillave të Administrimit, tarifatat ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël e të tjera kosto që nuk kategorizohen në zërat e tjerë sintetik të kostove.

Rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2017 ka shënuar UK Tiranë me 60 milion lekë, UK Durrës me 54.3 milion lekë, UK Korçë me 10.3 milion lekë, UK Vlorë me rreth 27.7 milion lekë. Luhatje në vlera më të ulëta kanë dhe shumë shoqëri të tjera ashtu sikurse ka shoqëri që kanë shënuar ulje të këtyre shpenzimeve dhe konkretisht UK Kavajë, UK Kurbin, UK Shkodër dhe UK Delvinë.

Kosto e Energjisë Elektrike Kostot e energjisë për vitin 2018 raportohen rreth 151.3 milion lekë më të ulëta se viti 2017. Kjo për faktin se konsumi i energjisë elektrike për sektorin UK ka rënë me rreth 10.5 milion kWh. Kjo ulje e energjisë së konsumuar në një kohë kur vëllimi i prodhimit të ujit me ngritje mekanike është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës shpjegohet me faktin e instalimit të pompave të reja rendimenti i të cilave është i lartë, favorizimit nga moti pa ngrica që ka reduktuar për shumë shoqëri përdorimin e pompave apo dhe me mbajtjen nën kontroll të situatës së furnizimit me ujë të pijshëm nëpërmjet një mirëmenaxhimi nga ana e shoqërive UK, si dhe rritjes së kujdesit për një lexim korrekt të matësve të energjisë elektrike në bashkëpunim me punonjësit e OSSHE.

Midis shoqërive UK ka dhe shoqëri që kanë shënuar rritje të konsiderueshme të kostove të energjisë elektrike si UK Kavajë 87.2 milion lekë, UK Shkodër me rreth 32.7 milion lekë apo UK Vorë me rreth 24.7 milion lekë. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së volumit të ujit të prodhuar me ngritje mekanike krahasuar me vitin 2017. UK Kavajë raporton kosto të rritura të energjisë për faktin se depot e Çermës dikur administroheshin nga UK Lushnje, e cila përballonte të gjitha kostot e prodhimit të ujit ndërsa nga 1-janari i vitit 2018 sipas një akt-marrëveshje midis dy shoqërive administrimi është marrë nga UK Kavajë dhe kostot përballohen nga kjo e fundit. UK Shkodër ka rritur sasinë e ujit të prodhuar me rreth 2.5 milion m³ për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit ndërsa UK Vorë raporton kosto të rritura për shkak se gjatë vitit 2017 ka patur në administrim pjesërisht sistemin e furnizimit me ujë i cili më parë ishte në administrim të UK Tiranë. Shumica e shoqërive raportojnë kosto të ulura të këtij zëri ku renditen UK Tiranë (119.7 milion lekë), UK Durrës (51.6 milion lekë), UK Lezhë (9.3 milion lekë) si dhe shoqëri të tjera me ulje deri në 4 milion lekë.

Problem për shoqëritë vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura që ato kanë ndaj OSHEE-së, të cilat në mbyllje të vitit 2018 raportohen rreth 6.2 miliard lekë ose rreth 70% të detyrimeve që sektori UK ka ndaj të tretëve. Pothuajse të gjitha shoqëritë kanë detyrime ndaj OSHEE-së, por detyrimin më të madh e ka UK Durrës me rreth 2 miliard lekë ose 32% të të gjithë detyrimit të sektorit, duke vijuar me UK Vlorë me 790 milion lekë, UK Patos me 497 milion lekë, UK Tiranë me 569 milion lekë, UK Kurbin me 223 milion lekë dhe shumë shoqëri të tjera.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve gjatë vitit 2018 krahasuar me ato të vitit 2017 kanë pësuar ulje me rreth 160 milion lekë. Defektet në rrjet (çarjet) për vitin 2018 raportohen rreth 37 660 nga 42 700 defekte që ishin në vitin 2017. Investimet fizike të bëra në rrjetin e ujësjellësit kanë dhënë ndikimin e vet në reduktimin e kostove të riparimeve. Ulje të konsiderueshme të kostove të riparimit kanë shoqëritë UK

Durrës me 107 milion lekë, si dhe UK Tiranë me rreth 87 milion lekë. Krahas shoqërive me ulje të kostove ka dhe shoqëri të cilat kanë kosto të rritura të këtij shërbimi dhe kjo justifikohet me rrjetin mjaft të amortizuar dhe me pamundësinë për të investuar zëvendësimin e tyre.

Gjithashtu, rritje të kostove të defekteve kanë patur edhe shoqëritë ku janë bërë investime, por këto investime kanë qenë të orientuara në zonën urbane, ndaj rritja e defekteve ka ardhur kryesisht nga gjendja e rënduar e sistemeve që janë marrë nga zonat rurale mbas riorganizimit të shoqërive.

Kostot Kapitale. Referuar Tabelës 3 në këto kosto përfshihen kryesisht kostot e Amortizimit dhe të Interesave të Kredive që zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 23% të totalit të kostove të sektorit. Kostot e amortizimit për vitin 2018 rezultojnë 239.5 milion lekë më të larta se viti 2017, e cila kryesisht ka ardhur nga saktësimi i vlerës së aktiveve të shoqërive, si edhe nga investimet e kryera dhe të pasqyruara në aktivet në bilancet e shoqërive.

Sektori është larg mbulimit të kostove totale në nivelin 100%, pasi aktualisht vetëm UK Tiranë dhe UK Kolonjë arrijnë t'i mbulojnë ato në nivelin mbi 100%. Konstatohet se shumë shoqëri si UK Korçë, UK Lezhë, UK Pogradec, UK Kamëz të cilat kanë nivele të larta të mbulimit të kostove O&M që variojnë nga 115% deri në 200%, por që kanë vlera mjaft të larta të kostove kapitale zënë deri në 55% të kostove totale. Këto shoqëri kanë detyrime mjaft të mëdha për kreditë e investimeve të marra në të kaluarën, por akoma janë në pamundësi financiare për përballimin e tyre.

1.2.3 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit e performancës së shoqërive, sepse lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimit, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korente (NAK). NAP në përlogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, d.m.th. edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK përjashton këto të fundit.

Tabela 32, Aneks 2 jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2018 dhe krahasuar ato me vitin 2017.

ERRU edhe për vitin 2018 konstaton pasaktësi në informacionin e dhënë pranë AKUM në lidhje me arkëtimet korente dhe ato të prapambetura. Mbas kontaktimit me një pjesë të konsiderueshme të shoqërive është korrigjuar informacioni dhe mbi këtë bazë ka llogaritur edhe treguesit e NAP dhe NAK.

Norma e Arkëtimit Korente raportohet për të gjithë sektorin për vitin 2018 në nivelin 79 %, pra në të njëjtin nivel me vitin 2017 me rreth 21% të faturimeve (shitjeve) të vitit nuk arkëtohen brenda vitit duke iu shtuar vlerës së debisë së vjetër. Nëse një pjesë e mirë e debive të vjetra janë debi të këqija dhe praktikisht të pamundura për t'u mbledhur, gjë që reflektohet si tregues në NAP, NAK tregon se shoqëritë po performojnë dobët në drejtim të arkëtimit të faturave të vitit në vazhdim ose vitit korent.

Nga shembujt pozitivë që performojnë me normë të lartë arkëtimi korentë përmenden shoqëritë UK Maliq, UK Ersekë, UK Berat-Kuçovë, UK Tiranë, UK Lezhë dhe UK Fushë Arrëz, ndërsa disa nga shoqëritë që operojnë me normë arkëtimi korentë shumë të ulët janë përkatësisht, UK Mirditë, UK Gramsh, UK Pustec dhe UK Lushnje.

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2018 ka shënuar nivelin 98% kundrejt 92.76% që ishte në vitin 2017. Ky rezultat është arritur në sajë të rritjes së angazhimit të shoqërive UK në përgjigje të aksionit të Qeverisë në sektorin e ujit nëpërmjet nënshkrimit të aktmarrëveshjeve me klientët për likuidimet e debive të vjetra sipas një kalendari të përcaktuar ku rezultojnë rreth 1.78 miliard lekë arkëtime vetëm gjatë vitit 2018.

Edhe pse gjatë vitit 2018 është punuar mirë në këtë drejtim, debitë e prapambetura mbeten në vlera tepër të larta me rreth 14 miliard lekë, nga të cilat rreth 11 miliard i përkasin kategorisë së klientëve familjarë. Krahas debive të vjetra që janë për t'u arkëtuar, shoqëritë kanë shumë detyrime ndaj të tretëve vlera e të cilave për sektorin në mbyllje të vitit 2018 është rreth 9 miliard lekë.

Arkëtimi nga shoqëritë UK në mënyrë sa më të plotë i debive të prapambetura të klientëve do të mund të balanconte mirë kapacitetin e shoqërive UK për të paguar detyrimet që ato kanë ndaj të tretëve, por kjo ka kufizimet e veta në drejtim të mbledhjes së debive të këqija, si ndaj subjekteve private që kanë falimentuar, apo të familjeve në pamundësi financiare për t'i shlyer ato.

1.2.4 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit që përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje UK merr rëndësi të veçantë për faktin se lidhet direkt me kostot e punës të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove. Nga të dhënat, vihet re që gjatë vitit 2018 numri total i punonjësve në sektorin UK është rritur me 412 punonjës nga të cilët 56 punonjës shtesë nga nënkontraktorët (treguesi merr në konsideratë të dy kategoritë e punonjësve)

Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit për vitin 2018 është mesatarisht 5,35 staf/1000 lidhje UK, me një përmirësim të vogël prej (0.15 staf/1000 lidhje UK), por ende jo në nivelin e kërkuar.

Ky përmirësim ka ardhur vetëm nga shtimi i numrit të lidhjeve të ujit me 64 677 dhe lidhjeve të kanalizimeve me 57 077 lidhje, sepse siç u theksua më sipër në total kemi një rritje të numrit të punonjësve. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, numër i cili në mjaft raste rritet artificialisht me punonjës që nuk përputhen me kërkesat dhe përshkrimet e vendit të punës. Vetëm pak shoqëri, si UK Korçë, UK Tiranë, UK Kamëz., etj. plotësojnë kushtin ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore. Nga ana tjetër, zgjerimi i zonës së shërbimit që rezulton në shtim të lidhjeve të reja për zonat e pa shërbyera më parë, ka dhënë efektet e veta edhe në drejtim të rritjes së numrit të punonjësve të shoqërive UK.

Gjithsesi ky tregues, si të gjithë treguesit jep tendencën për gjithë sektorin, ndërkohë që në raport paraqiten më tej analiza e TKP që pasqyrojë ecurinë, arritjet si dhe problematikat e shoqërive të veçanta. Në mjaft raste treguesi Efiçencës së Stafit është artificialisht i lartë për shkak të veçorive që paraqesin komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në plotësim të detyrimeve ligjore në garantim të sigurisë së këtyre veprave me personel roje. Kështu në ato zona shërbimi ku sistemet e furnizimit me ujë kanë një numër të madh depush, pusesh etj., shoqëritë paraqesin në organigramën e tyre një numër mjaft të madh punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte.

Është theksuar edhe në raportet e viteve 2016 dhe 2017 që ky problem duhet konsideruar për t'i dhënë zgjidhje teknike (me survejim në distancë ose masa të tjera inxhinierie sigurie për garantimin e mos aksesit

në këto objekte) sigurisë së këtyre objekteve për të mos rritur artificialisht dhe në mënyrë të panevojshme kostot e fuqisë punëtore në shoqëritë UK.

Theksohet fakti, i cituar edhe me sipër që është një problem evident në sektorin UK punësimi i njerëzve nga shoqëritë UK jo mbi baza të nevojave reale dhe sipas kualifikimeve të duhura për stafin, por me urdhra partiake.

Përmirësimin e politikave të punësimit në drejtim të numrit real të punonjësve në shoqëritë UK ERRU e ka prioritet të punës së saj kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja shërbimesh duke kërkuar dhe analizuar me hollësi argumentimin e organigramës për numrin e punonjësve dhe secilin pozicion që duhet të paraqesin shoqëritë UK, sepse pagat e stafit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kostos së operimit që do reflektohet në tarifë.

1.2.5 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Treguesi "Uji Pa të Ardhura" për vitin 2018, për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në rang sektori rezultoi në nivelin 63%, pra është përmirësuar duke u ulur me 2% krahasuar me vitin 2017, por ende mbetet në nivele të papranueshme. Në vlerë absolute sasia e ujit të prodhuar në vitin 2018 në sektor është rreth 284.7 milion m³ ujë, ose rreth 1.5 milion m³ ujë më pak se në vitin 2017, ndërkohë që sasia e ujit të faturuar është rritur me rreth 5.6 milion m³. Është pikërisht tendenca pozitive e dy variablave (prodhimi dhe faturimi në m³ i sasisë së ujit) që ky tregues rezultoi i përmirësuar me 2%.

Prej gjashtë vitesh shoqëritë depozitojnë pranë ERRU-së Bilancin e Ujit, i cili është një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin e humbjeve teknike dhe administrative si dhe orientimin e shoqërive drejt përmirësimit të treguesit "Uji pa të Ardhura". Vlerësimi dhe jo matja e ujit të prodhuar si pasojë e mungesës në një pjesë të madhe të sistemeve të matësve në burim, si dhe e mospajisjes 100% të të gjithë konsumatorëve individualë të shoqërive UK me matësa, e bën vlerësimin e këtij treguesi të vështirë për të qenë afër realitetit që ai përfaqëson si tregues.

Perceptimi real i gjendjes së sektorit që jep ky tregues vështirësohet akoma më tej nga fakti që llogaritja e tij në përqindje realizohet përgjithësisht për sisteme furnizime me ujë me ndërprerje. ERRU në të ardhmen synon vlerësimin e këtij treguesi që ka për bazë humbjet administrative dhe fizike jo më në përqindje, por në njësi të tjera që eksperiencia bashkëkohore përdor në raste të tilla.

Për sa më sipër, edhe përfundimet në lidhje me vlerësimin e UPA si sektor dhe përmirësimi i këtij treguesi në vitin 2018 me 2% krahasuar me vitin 2017 duhen marrë me rezerve.

Sfidë e sektorit për përmirësimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura mbetet ulja e humbjeve administrative dhe humbjeve fizike që lidhen me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, si dhe me rritjen e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë drejt objektivit të furnizimit me ujë 24 orë në dite. Për arritjen e këtij objektiv kërkohej një vlerësim dhe menaxhim i kërkesës për ujë që nga burimi deri tek konsumatori i fundit i rjetit shpërndarës. Për këtë është domosdoshmëri hartimi i bilanceve të detajuara dhe të besueshme që kërkon që të gjitha burimet e sistemeve të furnizimit me ujë të jenë të pajisura me ujëmatës.

Nga ana tjetër ulja e humbjeve lidhet direkt me menaxhimin e kontrollit dhe humbjeve sidomos në rrjetet shpërndarëse. Rrjetet shpërndarëse në sektor kërkohet që të jenë të seksionuara me zona të mbyllura të matura (DMA) në përputhje me modele hidraulike të tyre që lejojnë vlerësimin dhe kontrollin e humbjeve dhe përcaktojnë masat për zvogëlimin e tyre. Ky duhet të jetë prioritet kryesor i sektorit në vendin tonë. Rezulton gjithashtu e domosdoshme që shoqëritë të hartojnë regjistra të saktë të aseteve që disponojnë me karakteristikat përkatëse të materialeve dhe të kohës së instalimit të tyre që do të shërbejnë si bazë e Planeve të Menaxhimit të Aseteve që përgjithësisht mungojnë. Plani i Menaxhimit të Aseteve nënkupton prioritetet e ndërhyrjeve për zëvendësimin e aseteve për të zvogëluar humbjet teknike në linjat e transmetimit dhe rrjetet shpërndarëse.

1.2.6 Niveli i Matjes

Treguesi i Nivelit të Matjes për vitin 2017 është 74%, treguesi i cili krahasuar me atë të vitit 2017 ka përmirësim me rreth 5.7%, konsiderohet i ulët dhe larg objektivit të përcaktuar nga ERRU. Duke patur parasysh riorganizimin e shoqërive me ndarjen e re administrative, aktualisht asnjë shoqëri UK nuk i ka të pajisur me matës 100% të konsumatorëve, madje në disa shoqëri ky tregues është nën nivelin 20%. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre. Pjesa e konsumatorëve që faturohen pa matje, pra aforfe me 150 litra/ditë/banor, nuk është korrekte dhe i mbifaturon ato sepse shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të presupozuar. Ndërkohë që një pjesë e konsumatorëve, kryesisht ato me shtëpi private apo zona rurale abuzon dukshëm mbi këto vlera duke përdorur ujin e pijshëm për ujitje.

Në disa raste shoqëritë kanë “interes” nga ana financiare të kryejnë faturime aforfe, por kjo shpesh herë stimulon mbikëmbim të ujit në zona të caktuara duke çënuar cilësinë e shërbimit (orët e furnizimit dhe presionet) në zonat shpërndarëse mbas tyre sidomos gjatë stinës së nxehtë.

Prioritet i shoqërive UK duhet të jetë pajisja 100% me ujëmatës në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë, por duhet konsideruar mundësia e financimit të tyre nga qeveria qendrore.

Shoqëritë UK për vitin 2018 kanë raportuar instalimin e 93 000 matësve të rinj, por arritja e objektivit për të patur sektorin 100% me matës kërkon dhe instalimin e rreth 225 mijë prej tyre.

UK Tiranë është shoqëria që ka instaluar rreth 25 000 matës ose 27% e totalit të instaluar për të gjithë sektorin UK. Mirë kanë punuar dhe shumë shoqëri të tjera si UK Durrës, UK Fier, UK Vlorë, UK Berat Kuçovë, UK Himarë si dhe UK Mallakastër.

Pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbikëmbimit në sisteme.

1.2.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Për vitin 2018 treguesi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë për sektorin mbetet mesatarisht në vlerën 12,7 orë/ditë. Një furnizim me këtë nivel mesatar në ditë është i papranueshëm, por theksohet se ka shoqëri si UK Durrës, UK Divjakë, UK Roskovec dhe U Kurbin që furnizojnë mesatarisht popullsinë me rreth 3 deri

4 orë në ditë. Ky tregues krahas nivelit të ulët të shërbimit të ofruar lidhet edhe me problemet e rrezikut të shëndetit të publikut nga mundësia e futjes në tubacione të ujërave nëntokësore të ndotura gjatë kohës që tubacionet janë bosh madje dhe nën presion negativ.

Me riorganizimin e ri të shoqërive, asnjë shoqëri nuk ofron furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur si mesatare për të gjithë zonën e re të shërbimit. Referuar të dhënave të vitit 2018 krahasuar me vitin 2015 (para fillimit të reformës territoriale) popullsia e zonës rurale që shërbehet nga shoqëritë UK është rritur ndjeshëm me rreth 52% ose me 351 000 banorë, por kohëzgjatja e furnizimit me ujë të pijshëm për këto zona përgjithësisht është e ulët krahasuar me zonën urbane. Kjo është arsyeja që shumë shoqëri që dikur ofronin shërbim mbi 20 orë në ditë kanë pësuar rënie të këtij treguesi. Nga ana tjetër, ky është një tregues që aktualisht llogaritet vetëm duke u nisur nga koha e zbrazjes së depos dhe për mjaft zona të rrjetit shpërndarës paraqitet fiktiv.

1.3 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.3.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet

Tabela 33 në Aneks 3 jep për çdo shoqëri UK të ardhurat nga aktiviteti duke i krahasuar ato me Kostot e O&M dhe Kostot Totale, si dhe rezultatin përkatës financiar vjetor me humbje ose fitim. Në të jepen gjithashtu edhe nevojat reale për subvencione për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra nga shoqëritë

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 9 799.2 milion lekë të ardhura nga të cilat 87% i takojnë shoqërive të grupit të parë (13 shoqëritë e mëdha) dhe 13% i takon 44 shoqërive të mesme e të vogla.

Krahasuar me vitin paraardhës të ardhurat nga aktiviteti (faturimi për shërbimet UK dhe të ardhura të tjera të aktivitetit) janë rritur me rreth 1 403.6 milion lekë. Janë pikërisht shoqëritë e grupit të parë që kanë rritur të ardhurat pasi dy grupet e tjera në total kanë shënuar rënie të tyre.

Shoqëritë me rritje të konsiderueshme të të ardhurave janë UK Tiranë me 1 177 milion lekë, UK Durrës me 207 milion lekë, UK Korçë me 64 milion lekë dhe UK Kavajë me 64 milion lekë, UK Sarandë me 26 milion lekë si dhe një numër i konsiderueshëm shoqërish të tjera të mesme e të vogla me rritje deri në 7 milion lekë. Theksohet fakti se nga totali janë 12 shoqëri që kanë shënuar rënie të të ardhurave krahasuar me vitin 2017.

Analiza konstaton se për vitin 2018 janë 17 shoqëri që i mbulojnë mbi 100% kostot O&M nga 55 shoqëri që kanë dhënë informacion pranë AKUM. Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes për shoqëritë e grupit të parë është rritur ndjeshëm nga 104% në vitin 2017 në 133% për vitin 2018, ndërsa për shoqëritë e dy grupeve të tjera ky nivel është i njëjtë me atë të vitit 2017.

Shoqëritë UK akoma nuk arrijnë të performojnë për të përballuar kostot totale pa patur nevojë për subvencione. Vetëm dy shoqëri, UK Tiranë dhe UK Kolonjë, arrijnë të mbulojnë kostot totale.

Në detaje, situata financiare për çdo shoqëri UK për vitin 2018 në drejtim të shpenzimeve, të ardhurave dhe nevojës për subvencione jepet në Tabelën 33, Aneks 3.

Referuar kësaj tabelle rezulton se janë 38 shoqëri që nuk mbulojnë kostot O&M (nga 55 që kanë raportuar) dhe nevoja reale për subvencione për to llogaritet në 1 041 milion lekë (rreth 8.3 milion euro me kursin aktual të këmbimit). Nga ana tjetër vihet re që 52% të totalit të nevojës për subvencione i përkasin shoqërive, UK Vlorë (21%), UK Kavajë (10%), UK Kurbin (7%), UK Patos (14%). Për shëndoshjen financiare të sektorit vëmendja kryesore duhet fokusuar në problematikat individuale të shoqërive, duke analizuar performancën e tyre, mundësitë për përmirësim e në fund në orientimin e drejtë të subvencioneve deri sa shoqëritë të bëhen të qëndrueshme nga ana financiare.

Tabela 34 në Aneksin 4 jep një pasqyrë të detajuar të nevojës për subvencione për vitin 2018, si dhe alokimin (shpërndarjen) e realizuar praktikisht gjatë vitit për çdo shoqëri UK.

Nga tabela konstatohet që për vitin 2018 sektori UK është subvencionuar me një vlerë totale prej 1056 milion lekë (rreth 8,4 milion euro) e barabartë kjo me nevojat e sektorit për përbalimin e Kostove O&M, e ndarë në 996 milion nga buxheti i shtetit, nga të cilat 400 milion për mbulimin e diferencës kosto-tarife dhe 596.8 milion lekë si bonus për performancë të mirë të shoqërive. Bashkitë nga fondet e tyre kanë dhënë subvencione për shoqëritë në shumën 59 milion lekë.

Nga shpërndarja e subvencioneve shihet se për disa shoqëri ato janë akorduar mbi nevojat reale të mbulimit të shpenzimeve për O&M, ndërsa në disa të tjera janë akorduar nën nevojat reale të tyre. Nuk njihet arsyeja dhe kriteret e përdorura të shpërndarjes së subvencioneve sipas situatës që jep tabela e mësipërme, por gjithsesi kërkohet më shumë transparencë për mënyrën e shpërndarjes së fondeve të subvencioneve në të ardhmen.

1.3.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK

Gjatë vitit 2018 investimet në sektorin e ujësjellës kanalizimeve janë realizuar pjesërisht nga buxheti i shtetit (35%), ndërsa pjesa tjetër prej 65% është realizuar nga donatorët e huaj në formën e granteve ose huave në norma të ulta interesi. Totali i këtyre investimeve shkon në rreth 70 milion euro, që akoma mbetet larg nevojave reale për investime në sektor. Tabela 5 jep investimet e realizuara në sektor gjatë 3-viteve të fundit të ndara sipas vlerave, burimit të financimit dhe destinacioneve, përkatësisht, në sisteme të furnizimit me ujë, në kanalizimet e ujërave të ndotura, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Siç shihet në këto tre vite ka një tendencë rënieje të investimeve në sektor.

Tabela 5. Investimet e Kryera në Sektor, Vitet 2016, 2017, 2018

		Në 000/lekë		
	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Burimi i financimit	Financim nga Buxheti	4,108,555	4,194,097	3,106,825
	Financim i Huaj	8,504,013	6,435,508	5,592,681
	Total	12,612,568	10,629,605	8,699,506
Destinacioni	Ujësjellës	4,950,000	5,000,000	4,245,937
	Kanalizime	4,712,568	2,900,000	2,224,520
	ITUN	2,950,000	2,729,605	2,224,749

Burimi i të dhënave MIE

Investimet në sektor janë orientuar kryesisht në drejtim të zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit me rreth 205 km, atij të kanalizimeve me rreth 54 km si dhe në ndërtimin e 4-implanteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN).

Krahas investimeve në sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizime rreth 14.5 milion euro, janë pjesë e financimeve për shërbime inxhinierike, si konsulencë, projektim, supervizion punimesh etj.

Referuar planifikimeve të investimeve të planifikuara dhe alokuara në sektor vërehet se deri në fund të vitit 2018 ato janë realizuar përkatësisht, 98% në zgjerimin e rrjeteve të ujësjellësit, 68% në kanalizimet e ujërave të ndotura, 100% në ndërtimin e 4 implanteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN). Gjithsesi kjo konsiderohet një performancë mjaft pozitive në drejtim të realizimit të investimeve.

Nevojat për investime në sektorin e ujësjellës kanalizimeve të projektuara deri në vitin 2040 vlerësohen rreth 6 miliard euro, ku pjesa më e madhe (rreth 4 miliard) i takon kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe implanteve të pastrimit të tyre.

Referuar Masterplanit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime për Shqipërinë për periudhën 2011-2040 nevojat për investime në sektorin UK parashikohen të jenë në vlerën e 6 miliard Euro, përkatësisht 4 miliard Euro për sektorin e KUN dhe ITUN, 1 miliard Euro për sektorin e ujësjellësve dhe pjesa tjetër për shërbimet inxhinierike, nevojë e projektuar deri në vitin 2040. Kjo vlerë përkon mesatarisht me një nevojë për financim prej rreth 270 milion Euro në vit dhe vetëm për territorin brenda zonës së shërbimit të shoqërive UK para reformës administrative territoriale, pasi studimi nuk përfshinte në vlerësim nevojat për investime për të ashtuquajturat “zona gri” të territorit të 131 ish komunave ku shërbimet e furnizimit me ujë dhe KUN manaxhoheshin nga vetë këto të fundit. Kuptohet që Master Plani ka nevojë që të rishikohet në funksion të realitetit të ri të sektorit të ujësjellës kanalizimeve.

Vlera e financimit paraqitet mjaft e lartë në lidhje me mundësitë reale të financimit të tij, financim i cili në 10 vitet e fundit ka rezultuar në shifrat rreth 50-60 milion euro në vit përfshirë të gjitha burimet e financimit të tij, pra buxheti i shtetit dhe donatorët.

Ndihet nevoja e miratimit të draftit mbi dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve në Shqipëri i iniciuar që në maj të vitit 2016, i cili përfshin një model për financimin e sektorit, i cili akoma nuk është miratuar me ndonjë Vendim të Këshillit të Ministrave. Ky model identifikoi kostot për arritjen e objektivave të sektorit, burimet e ndryshme të financimit për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të tij (3T-të) si dhe këto kosto të jenë të përballueshme nga konsumatorët. Financimi i sektorit me 3T ka parasysh financimin nga burime të brendshme financiare të shoqërive të gjeneruara nga aktiviteti i saj (tarifa), financime nga qeveria qendrore (taksa), dhe së fundi nga donatorët (transferta). Sipas këtij modeli, elementi i ri në lidhje me bëshmërinë e skemës së financimit të nevojave për investime fizike në sektor është mbulimi i një pjese të konsiderueshme të financimit nga vetë shoqëritë. Gjithsesi në varësi edhe të vlerave të nevojës për investime që do të përcaktohen nga Master Plani Kombëtar i rishikuar, duhen përditësuar gjithashtu të dhënat në këtë Strategji që duhet miratuar përfundimisht me vendim të veçantë të KM.

2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime

2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjetllës kanalizime është i bazuar në 9 tregues kryesorë të performancës të cituara më sipër dhe të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare, në përzgjedhjen e TKP përparësi u është dhënë atyre treguesve që vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.

Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimet më të rëndësishme të punës së operatorëve duke na dhënë një pasqyrë të plote të nivelit të ofruar të shërbimeve.

Tashmë kemi shoqëri të reja të organizuara në përputhje me reformën si UK Cërrik, UK Roskovec, U Pustec, UK Vorë dhe U Konispol, treguesit e llogaritur të të cilave mund të krahasohen me ato të një viti më parë pasi janë shoqëri të cilat kanë raportuar të dhëna për të dytin vit radhazi dhe ka një bazë për ti vlerësuar dhe krahasuar treguesit e performancës së tyre. Për vitin 2018 është shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Dropull që ka raportuar për herë të parë.

Në këtë raport ne nuk kemi informacion lidhur me dy shoqëri të reja konkretisht, UK Bashkia Klos, UK Finiq detyrimisht këto shoqëri janë përfshirë në analizën e performancës, pra nga 57 shoqëri procesi i analizës dhe ecurisë si dhe krahasimi me vitin paraardhës do të bëhet vetëm për 55 shoqëri të ndara në tre grupe respektive.

Edhe në këtë raport performance është përdorur e njëjtën metodologji, si për ndarjen në grupe të shoqërive, ashtu dhe në vlerësimin e treguesve të tyre, por krahasueshmëria me vitin/vitet paraardhëse do të shqyrtohet në varësi të statusit të çdo shoqërie nëse është e riorganizuar apo jo sipas Reformës Territoriale.

Kemi një ndryshim në Grupet e renditjes së shoqërive krahasuar me vitin paraardhës, bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive, dy shoqëri përkatësisht UK Lezhë dhe UK Kamëz janë përfshirë në grupin e parë për shkak të shtimit të numrit të lidhjeve në përputhje me këtë kategori. Tabela 6 jep tre grupimet e shoqërive UK sipas madhësisë (numrit të lidhjeve).

Tabela 6. Tre Grupimet e Shoqërive Sipas Numrit të Lidhjeve

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup	Numri i shoqërive që do të analizohen në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjetllës	14	14
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjetllës	29	29
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjetllës	14	12

Në detaje përkatësia e çdo shoqërie në secilin grup jepet në Tabelën 7

Tabela 7. Përkatësia e Shoqërive në Secilin Grup

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 1			Grupi 2 (vazhdimi)		
UK	Tiranë	247,818	UK	Vorë	4,756
UK	Durrës	85,160	U	Përmet	4,741
UK	Vlorë	55,025	UK	Malësi e Madhe	4,677
UK	Elbasan	41,165	UK	Tepelenë	4,655
UK	Fier	37,299	UK	Roskovec	4,500
UK	Shkodër	30,042	U	Selenicë	4,273
UK	Korçë	28,765	UK	Ura -Vajgurore	4,067
UK	Berat -Kuçovë	28,665	U	Bulqizë	4,021
UK	Kavajë	24,279	UK	Peqin	3,900
UK	Lushnje	22,537	UK	Vau-Dejës	3,699
UK	Sarandë	19,712	UK	Dropull	3,462
UK	Pogradec	17,871	UK	Skrapar	3,405
UK	Kamëz	17,440			
UK	Lezhë	16,358	Grupi 3		
Grupi 2			UK	Delvinë	2,971
UK	Gjirokastrë	10,150	UK	Tropojë	2,963
UK	Maliq	9,840	UK	Polican	2,953
UK	Dibër	8,684	UK	Mirditë	2,901
UK	Devoll	8,220	UK	Kolonjë	2,201
UK	Kurbini	7,693	UK	Konispol	1,957
UK	Cërrik	7,365	UK	Pukë	1,708
UK	Belsh	6,883	UK	Këlcyrë	1,610
UK	Krujë	6,260	UK	Has	1,458
UK	Kukës	6,021	UK	Libohovë	1,343
UK	Librazhd	5,983	UK	Pustec	734
UK	Mallakastër	5,923	UK	Fushë – Arrëz	706
UK	Patos	5,845	UK	Bashkia Klos	-
UK	Mat	5,662	U	Finiq	
UK	Rrogozhinë	5,631			-
U	Gramsh	5,630			
UK	Himarë	5,475			
UK	Divjakë	5,318			

Burimi i informacionit: AKUM

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme.

Në tabelën Nr. 7 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa në grafikun 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP.




Figura 1. Grafik i Analizës së TKP-ve

Tabela 8. Objektivat për TKP të Vendosura nga ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat nga ERRU		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efienca e Stafit (numri i stafit për 1000 lidhje) ¹	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji pa të ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

¹ Për TKP Efienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.3.1 Uji Pa të Ardhura

Sasinë e ujit nga vëllimi total i ujit të prodhuar që shoqëria nuk arrin t'ja faturoje klientëve quhet "Ujë Pa të Ardhura", ku pjesa kryesore e tyre përbehet nga humbjet administrative (të dukshme) dhe humbjet reale (teknike). Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet administrative reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Tendenca në rënie për treguesin "Ujë Pa të Ardhura" ka bërë të mundur që për vitin 2018 niveli i humbjeve në sektor të jetë 63%. Menaxhimi më i mirë i shoqërive UK nëpërmjet uljes së prodhimit me 1,5 milion m³ si dhe rritjes së faturimit me 5,6 milion m³ ka përmirësuar këtë tregues me 2%. Reforma në sektorin e ujit angazhoi më shumë shoqëritë në procesin e eliminimit të lidhjeve të paligjshme. ERRU vazhdimisht thekson se menaxhimi më i mirë i kompanive, hartimi i planeve të biznesit dhe përfshirja në to e planeve të veprimit për përmirësimin e treguesve të performancës dhe sidomos të UPA do të sjellë ndryshimet e kërkuara në sektorin UK. Analiza e këtij treguesi për secilin grupim të shoqërive jepet në paragrafet në vijim.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për Grupin e I-rë, Viti 2018

Në grafikun e Figurës 2 në Grupin e I-rë të përbërë nga 14 shoqëri UK, klasifikohen si shoqëri me performacë të mirë shoqëritë UK Korçë, perkatesisht me nivel të UPA 26%, si dhe UK Pogradec me nivel të këtij treguesi prej 29%. Klasifikohen më tej 11 shoqëri UK që performojnë dobët, me nivelin e UPA nga 60-80 %.

Ndërkohë konstatohet se kanë përmirësuar këtë tregues shoqëritë UK Sarandë (-6,8%), UK Fier (-6,8%), UK Tiranë (-4,97%), UK Lushnje (-3,42%), UK Berat-Kuçovë (-3,06%). Arsyja kryesore e këtij përmirësimi qendron në reduktimin e sasisë së ujit të prodhuar, si dhe rritjen e volumit të ujit të faturuar.

Saktësimi i të dhënave për volumin e ujit të prodhuar që rezultoi se ishte raportuar me pasaktësi për vitin 2017, ka ndikuar në renditjen e UK Kavajë (-9,83%) artificialisht si shoqëria me performancën më të mirë në Grup dhe për UK Shkodër(+6,99%) e ka penalizuar si performuesi më i dobët i Grupit. Me të njëjtat argumenta shoqëria UK Durrës ka rritur treguesin me (+2.76%) pasi vendosja e matësit elektronik në prodhim saktësoi se sasia e ujit që hyn në sistem nuk ishte vlerësuar korrekt më parë. Tabela 9 jep në detaje ecurinë e treguesit UPA në tre vitet e fundit për secilën shoqëri të Grupit të I-rë.

Tabela 9. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Kavajë	54.06	62.83	53.00	-9.83*
UK	Sarandë	77.20	70.80	64.00	-6.80
UK	Fier	61.58	65.73	59.00	-6.73
UK	Tiranë	67.77	66.97	62.00	-4.97
UK	Lushnje	78.19	78.42	75.00	-3.42
UK	Berat - Kuçovë	83.47	80.06	77.00	-3.06
UK	Pogradec	30.91	31.50	29.00	-2.50
UK	Korçë	30.01	28.46	26.00	-2.46
UK	Vlorë	81.01	78.19	77.00	-1.19
UK	Lezhë	47.64	39.26	39.00	-0.26
UK	Elbasan	67.00	75.22	75.00	-0.22
UK	Durrës	71.59	71.24	74.00	2.76
UK	Kamëz	7.00	47.70	52.00	4.30
UK	Shkodër	69.11	60.01	67.00	6.99

*Shënim: Për këtë tregues shenja (-) tregon përmirësim të performancës

Nga krahasimi i të dhënave për tre vitet e fundit vërejmë se shoqëritë UK Sarandë, UK Tiranë, UK Berat-Kucovë, UK Pogradec, UK Korçë dhe UK Vlorë vazhdojnë të ruajnë trendin në përmirësim të këtij treguesi.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për Grupin e II-të, viti 2018

Referuar Figures 3, në Grupin e II-të të shoqërive, performojnë mirë me tregues të UPA nën 30%, përkatësisht shoqëritë: UK Belsh (22%), UK Devoll (22%) dhe UK Kukës (23%).

Nga grafiku shihet që janë 5 shoqëritë që operojnë me nivel të UPA nga 30-50%, ndërsa 21 shoqëritë e tjera të këtij Grupi klasifikohen me performancë të dobët të realizimit të këtij treguesi.

Arsyet e përmirësimit të këtij treguesi respektivisht për shoqëritë: UK Kukës (-20.33%), UK Çorovodë (-11.50%), UK Belsh (-11.42%), UK Rrogozhinë (-10.91%), UK Librazhd (-7.39%) qendron se ato raportojnë reduktimin e volumit të ujit që hyn në sistem dhe rritjen e faturimit. Përmirësimi i këtij treguesi për shoqëritë e mësipërme duhet marrë me rezervë sepse raportimi për këtë tregues për faktorët “Ujë i Prodhuar” dhe “Ujë i Faturuar” nuk ka vlera të njëjta në të dy institucionet ku raportohet, përkatësisht pranë AKUM dhe ERRU (në Bilancin e Ujit).

Me rezerva duhet marre gjithashtu tendenca e raportuar në përmirësim të treguesit UPA per nivelin aktual të humbjeve për shoqëritë UK Gjirokastrë (56%) dhe UK Tepelenë (62%). Përmirësimi i saktësisë së të dhënave do të jetë në fokusin kryesor të punës së ERRU-së sidomos për shoqëritë e cituara më sipër.

Mungesa e matësave në pikat e prodhimit dhe në depo kanë bërë që shumë prej shoqërive të mos vlerësojnë saktë sasinë e ujit që hyn në sistem, për këtë arsye disa shoqëri paraqesin luhatje të nivelit të humbjeve nga njëri vit në tjetrin, domosdoshmëria e vendosjes së matësave në të gjitha pikat e prodhimit dhe të depozimit është emergjente.

Performojnë dobët duke rritur humbjet e ujit, shoqëritë UK Himarrë (+24.08%), UK Mallakastër (+13.14%), UK Devoll (+10.26%), UK Vorë (+10.00%), UK Maliq (+9.64%), UK Roskovec (+7.66%), UK Selenicë (+8.14%).

Me nivelin më të lartë të Ujit Pa të Ardhura në grup paraqiten shoqëritë UK Dropull (70%), UK Vorë (68%), UK Krujë (68%), UK Roskovec(68%), UK Selenicë (68%), UK Librazhd (66%), UK Kurbin(65%) etj.

Tabela 10 jep ecurinë e treguesit Uji Pa të Ardhura për tre vitet e fundit në Grupin e Dytë.

Tabela 10. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Kukës	52.79	43.33	23.00	-20.33
UK	Tepelenë	63.61	80.15	62.00	-18.15
UK	Belsh	27.00	33.42	22.00	-11.42
UK	Çorovodë	59.19	55.50	44.00	-11.50
UK	Rrogzhinë	68.79	64.91	54.00	-10.91
UK	Patos	49.49	60.24	54.00	-6.24
UK	Gjirokastrë	67.72	65.52	56.00	-9.52
UK	Librazhd	36.29	73.39	66.00	-7.39
UK	Malësi e Madhe	37.53	60.74	57.00	-3.74
UK	Kurbin	71.44	67.55	65.00	-2.55
UK	Ura Vajgurore	59.91	61.02	59.00	-2.02
UK	Mat	38.18	39.40	38.00	-1.40
U	Gramsh	30.63	41.84	41.00	-0.84
UK	Vau I Dejës	74.94	55.20	55.00	-0.20
UK	Divjake	48.98	53.55	54.00	0.45
UK	Cërrik		60.13	62.00	1.87
UK	Dibër	57.65	33.55	35.00	1.45
UK	Peqin	45.53	51.69	57.00	5.31
UK	Krujë	62.29	61.29	68.00	6.71
U	Përmet	38.79	44.46	52.00	7.54
U	Bulqizë	54.75	52.42	60.00	7.58
UK	Roskovec		60.34	68.00	7.66
U	Selenice	91.00	59.86	68.00	8.14
UK	Maliq	38.29	31.36	41.00	9.64
UK	Vorë		58.00	68.00	10.00
UK	Devoll	20.94	11.74	22.00	10.26
UK	Mallakastër	56.62	48.86	62.00	13.14
UK	Himarë	22.00	34.92	59.00	24.08
UK	Dropull			70.00	

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 4 jep grafikisht vlerat e treguesit Uji Pa të Ardhura për Grupin e III-të për vitin 2018




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për Grupin e III-të, Viti 2018

Në Grupin e III-të, edhe për gjatë vitit 2018 asnjë prej shoqërive nuk performon nën kufirin 30% të performancës së mirë, gjashtë shoqëri performojnë brenda kufirit nga 30-50%, ndërsa pjesa tjetër mbi kufirin e performancës së dobët.

Kanë përmiresuar treguesin duke e zvogeluar atë nëpërmjet menaxhimit më të mirë, shoqëritë UK Pustec (-23%), Delvinë (-18.39%), Pukë (-12.52%), Poliçan (-10.18%), Kolonjë (-9.23%), ndërsa ky tregues është përkeqësuar dukshëm për shoqërinë UK Konispol duke u rritur me +19%.

Shoqëritë që performojnë mbi kufirin e performancës së dobët janë U Kelcyrë (80%), UK Fushë Arrëz (69%), UK Pukë (64%), UK Tropojë (61%).

Shoqëria UK Libohovë raporton një tregues mjaft të lartë të UPA në nivelin 34%, por paportimi me pasaktësi e bën të pabesueshëm arritjen e këtij niveli, rrjedhimisht është marrë në konsideratë vendi që ajo zë në këtë renditje.

Tabela 11. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Pustec		73.00	50.00	-23.00
UK	Delvinë	62.87	66.39	48.00	-18.39
UK	Pukë	77.02	76.52	64.00	-12.52
UK	Poliçan	69.44	56.18	46.00	-10.18
UK	Kolonjë	51.46	52.23	43.00	-9.23
UK	Mirditë	60.02	52.16	48.00	-4.16
UK	Tropojë	61.86	62.43	61.00	-1.43
UK	Këlcyrë	77.57	80.21	80.00	-0.21
UK	Fushë-Arrëz	70.54	68.29	69.00	0.71
UK	Has	52.28	50.12	52.00	1.88
UK	Konispol		31.00	50.00	19.00
UK	Libohovë	66.51	83.79	34.00	49.79

Përfundime

Analiza e mesipërme nxjerr në pah se manaxhimi i përmirësuar i shoqërive UK dhe reformat e ndërmarra në sektorin UK janë faktorët kryesor që kanë ndikuar në përmirësimin e treguesit UPA me 2% për vitin 2018 duke arritur vlerën prej 63%. Në sektorin UK performojnë nën kufirin 30% të performancës së mirë pesë shoqëri UK, 12 shoqëri të tjera performojnë brenda kufirit 30-50% dhe pjesa e mbetur mbetet me një performancë mjaft të dobët me mbi 50% të nivelit të UPA.

Angazhimi për marrjen e masave të duhura dhe hartimi i planeve të veprimit për të reduktuar shpenzimet e panevojshme që lindin nga mbiprodhimi si dhe menaxhimi i mirë i humbjeve komerciale (dukshme) dhe atyre teknike (reale) mbetet emergjente për shumicën e shoqërive UK. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj, rritja e faturimit dhe arkëtimit, vendosja e matësve në prodhim dhe shpërndarje mbeten ende detyrat kryesore për të gjitha shoqëritë UK, pasi përmirësimi i treguesit UPA do të jetë faktori kryesor që do të ndikojë në përmirësimin e situatës së tyre financiare.

Mbetet shqetësim për ERRU raportimi i pa saktë nga mjaft shoqëri UK të cilat bëjnë të mundur që treguesi të mos ketë të njëjtat nivele të raportuara në ERRU dhe AKUM. Vlerësimi jo korrekt i sasisë së ujit të prodhuar shpesh ka sjell luhatje të mëdha të treguesit UPA. Vendosja e matësve në pikat e prodhimit është emergjente pasi shumë nga kompanitë nuk ndjekin procedurat e duhura për vlerësimin e tij, shpesh herë faktori “pasaktësia në matje për sasinë e ujit që hyn në sistem” arrin në volume të konsiderueshme pasi vlerësimi ka mjaft pasaktësi.

ERRU ka mbështetur dhe do të mbështesë të gjitha shoqëritë UK në punën e tyre nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese që ajo harton për sektorin. Gjithashtu sugjeron të gjitha shoqëritë UK që ti kushtojnë vëmendje "Bilancit të Ujit", i cili ende nuk hartohet saktë nga shumë shoqëri ose neglizhohet prej tyre. Vlerësimi i saktë i komponentëve që përbëjnë këtë bilanc do të jetë pasqyra në të cilën duhet të bazohen për të hartuar planet e veprimit për të reduktuar në kohë Ujin Pa të Ardhura, për të patur shoqëri të forta financiarisht.

2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i Kostove O&M” është treguesi që pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij, (pa kostot kapitale dhe të amortizimit), tregues që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie.

Në vitin 2018, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 119 % nga 109 % që ishte në vitin paraardhës duke shënuar një progres të ndjeshëm. Sektori nga viti 2013 e në vijim ka mbuluar kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes mbi 100 % me luhatje pozitive apo negative gjatë viteve. ERRU konstaton se edhe pse në nivele shumë të mira janë vetëm 17 shoqëri nga 55 që kanë raportuar të dhëna që e kanë këtë tregues mbi 100%. Me poshtë ky tregues analizohet në detaje për secilin grupim të shoqërive.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Në Grupin e I-rë, bëjnë pjesë 14 shoqëritë më të mëdha, një pjesë e të cilave për disa vite rresht arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%. Figura 5 jep grafiksht realizimin e këtij treguesi për shoqëritë e Grupit të I-rë për vitin 2018.

Siç shihet nga grafiku, niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë 100% i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 9 shoqëri, përkatësisht: UK Lezhë, UK Korçë, UK Tiranë, UK Kamëz, UK Berat-Kuçovë, UK Pogradec, UK Sarandë UK Durrës si dhe UK Fier.




Figura 5. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë, viti 2018.

Këto shoqëri edhe pse kanë pësuar përgjithësisht rritje të kostove nga ana tjetër kanë shënuar rritje të të ardhurave të aktivitetit në nivele më të larta se kostot duke patur dhe nivele të larta të mbulimit të kostove O&M.

Në këtë grup janë tre shoqëri që i përkasin brezit të performancës së dobët dhe konkretisht UK Vlorë, UK Kavajë dhe UK Lushnje respektivisht me 60%, 61% dhe 77% të nivelit të këtij treguesi, ku si shkak kryesor i përkeqësimit është rritja e ndjeshme e kostove krahasuar me të ardhurat. UK Kavajë raporton rreth 113 milion kosto të rritura dhe rreth 64 milion rritje të të ardhurave që e ka pozicionuar këtë shoqëri në nivel shumë të ulët.

Në brezin e performancës së pranueshme janë 2 shoqëri, UK Elbasan, UK Shkodër.

Tabela 12 paraqet ecurinë e treguesit mbulimi i Kostove O&M për tre vitet e fundit.

Tabela 12. Ecuria e Treguesit Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshim 2018-2017 (%)
UK	Lezhë	124.54	162.00	201.00	39.00
UK	Tiranë	157.00	159.00	186.00	27.00
UK	Durrës	88.44	80.00	107.00	27.00
UK	Korçë	157.00	173.00	199.00	26.00
UK	Berat - Kuçovë	127.00	131.00	138.00	7.00
UK	Lushnje	99.00	70.00	77.00	7.00
UK	Pogradec	110.00	123.00	123.00	0.00
UK	Fier	126.85	103.00	103.00	0.00
UK	Vlorë	75.27	62.00	60.00	2.00
UK	Elbasan	100.46	95.00	92.00	3.00
UK	Kavajë	63.00	64.00	61.00	3.00
UK	Kamëz	144.00	174.00	170.00	4.00
UK	Sarandë	118.65	122.00	115.00	7.00
UK	Shkodër	104.31	98.00	89.00	9.00

Krahasuar me vitin 2017 në këtë grup përgjatë vitit 2018 kanë pasur përmirësim gjashtë shoqëri në mbulimin e kostos së operimit dhe mirëmbajtjes me një rritje nga 7% deri në 39%. Progresin më të madh e ka realizuar UK Lezhë, ndërkohë që kanë paraqitur një nivel të mirë edhe shoqëritë UK Tiranë, UK Durrës dhe UK Korçë.

Drejtuesit e këtyre shoqërive kanë punuar mirë kryesisht në drejtim të rritjes së të ardhurave me qëllim përballimin e kostove në shumë raste të rritura edhe ndjeshëm sikurse është UK Tiranë.

Në nivelin e vitit 2017 pa pësuar asnjë ndryshim paraqiten shoqëritë UK Pogradec dhe UK Fier.

Rënie të këtij treguesi që varion nga 2% deri në 9% kanë pësuar gjashtë shoqëri UK Vlorë, Elbasan, Kavajë, Kamëz, Sarandë dhe UK Shkodër e cila ka rënie më të madhe me 9%, rënie që ka ardhur nga fakti i rritjes së kostove me rreth 46 milion lekë krahasuar me një rritje minimale të të ardhurave me rreth 3.4 milion lekë. Edhe pse në nivele të performancës shumë të mirë shoqëritë UK Kamëz dhe UK Sarandë për vitin 2018 kanë pësuar rënie me 4% dhe 7%.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Grupi II-të për vitin 2018 në përputhje me kriterin e grupimit sipas numrit të lidhjeve përfshin 29 shoqëri nga 26 që ishin në vitin 2017. Evidentohen si shoqëri me performancë të mirë shtatë shoqëri që kanë arritur të mbulojnë Kostot e O&M me mbi 100%. Sipas grafikut shoqëria e radhitur e para në performancë është UK Devoll me 124% të mbulimit të Kostove të O&M, e ndjekur nga UK Kukës me 120%, UK Librazhd dhe UK Malësi e Madhe me 117%. Më tej renditen tre shoqëritë UK Mat, UK Bulqizë dhe UK Gramsh me 110-100%.

Grupi II-të - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 6. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e II-të, viti 2018

Në zonën e performancës së dobët nën 80% renditen 18 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët me 23% mbulim kosto O&M është UK Patos e cila për vite mbetet në fund të klasifikimit.

Në brezin e performancës së pranueshme, (80%-100%) janë renditur pesë shoqëri, ku UK Himarë është shoqëria që ka përmirësim me 20% duke arritur në nivelin e treguesit 98%. Nga ana tjetër e theksojmë se UK Gjirokastër ka shënuar rënie të treguesit e cila e ka kaluar këtë shoqëri nga brezi i performancës shumë të mirë për vitin 2017 (104%) në brezin e performancës së pranueshme (95% për vitin 2018).

Tabela 13 paraqet ecurinë e këtij treguesi për Grupin e II-të gjatë tre viteve të fundit.

Tabela 13. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për Grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Vorë		87.53	92.0	4.47
UK	Skrapar	35.70	43.00	72.00	29.00
U	Bulqizë	81.00	85.77	110	24.23
UK	Himarë	70.00	78.00	98.00	20.00
UK	Maliq	67.93	59.00	76.00	17.00
UK	Divjakë	51.00	53.00	69.00	16.00
UK	Mallakastër	47.34	42.00	55.00	13.00
UK	Krujë	98.33	60.00	71.00	11.00
UK	Roskovec		70.00	78.00	8.00
UK	Patos	18.42	19.00	23.00	4.00
UK	Librazhd	118.00	115.00	117.00	2.00
UK	Belsh	60.67	73.00	74.00	1.00
UK	Malësi e Madhe	41.38	111.00	111.00	0.00
UK	Peqin	49.72	52.00	52.00	0.00
UK	Dibër	116.86	93.00	91.00	2.00
U	Përmet	75.11	73.00	71.00	2.00
UK	Kukës	97.00	124.00	120.00	4.00
U	Gramsh	104.00	104.00	100.00	4.00
U	Selenicë	42.60	65.00	60.00	5.00
UK	Rrogozhinë	51.00	65.00	58.00	7.00
UK	Kurbin	43.21	47.00	40.00	7.00
UK	Gjirokastër	135.00	104.00	95.00	9.00
UK	Cërrik		81.00	69.00	12.00
UK	Mat	127.00	123.00	110.00	13.00
UK	Tepelenë	85.54	58.00	45.00	13.00
UK	Vau i Dejës	26.30	48.00	34.00	14.00
UK	Devoll	93.00	144.00	124.00	20.00
UK	Ura Vajgurore	82.00	76.00	53.00	23.00

Shënim: Shoqëria UK Dropull nuk paraqitet në tabelë pasi është shoqëri e re që ka raportuar për herë të parë.

Nga 28 shoqëri të këtij grupi raportohen 12 shoqëri që e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të Kostove të O&M në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Përmirësimi në mbulimin e Kostove të O&M varion nga 1% deri në 29%.

Përmirësimin më të madh e ka shënuar UK Skrapar me 29% gjatë vitit 2018 duke arritur nivelin e mbulimit në 78%, që gjithsesi duhet përmirësuar në të ardhmen. Arsyeja e përmirësimit është rritja e të ardhurave me rreth 60% më të larta se viti 2017 kundrejt Kostove O&M që janë rritur vetëm me rreth 10%.

UK Bulqizë gjithashtu ka një përmirësim me 24.23% duke e renditur shoqërinë nga performanca e pranueshme në atë të performancës shumë të mirë me mbulimin 110% të kostove O&M.

Dy shoqëritë UK që kanë performuar progres krahasuar me vitin 2017 janë UK Malësi e Madhe dhe UK Peqin, ku kjo e fundit mbetet akoma në nivelin 52% të mbulimit të Kostove O&M.

Në këtë grup ka shoqëri si UK Kukës, U Gramsh, UK Mat dhe UK Devoll të cilat edhe pse kanë performancë shumë të mirë (mbi 100%) kanë shënuar regres për vitin 2018 respektivisht në përqindje nga 3% deri 13 % (UK Mat). Rënia e këtij treguesi për këto katër shoqëri ka ardhur sepse kanë rritur kostot në nivele më të larta se të ardhurat. Rënie më të madhe të këtij treguesi e ka shënuar UK Ura Vajgurore me -23% e cila ka disa vite që përkeqëson performancën, dhe aktualisht niveli i mbulimit të kostove O&M është 53%.

Grupi i III-të i Shoqërive

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 14 shoqëri, nga të cilat shoqëritë UK Finiq dhe Bashkia Klos nuk kanë raportuar të dhëna.

Performanca për Vitin 2018

Grupi III-të - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 7. Mbulimi i Kostove O&M Grupi III-të, Viti 2018

Objektivi i vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për të mbuluar tërësisht Kostot O&M është arritur vetëm nga UK Kolonjë me 141% .

Në zonën e performancës së pranueshme për vitin 2018 janë tre shoqëri, përkatësisht, Bashkia Pukë, UK Delvinë dhe UK Tropojë me nivele të këtij treguesi 99%, 88% dhe 86%.

Shoqëria me performancën më të dobët është UK Libohovë që mbulon 45% të Kostove të O&M.

Tabela 14 paraqet ecurinë e këtij treguesi për Grupin e III-të gjatë tre viteve të fundit.

Tabela 14. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Konispol		41.00	73.00	32.00
UK	Bashkia Pukë	103.00	77.00	99.00	22.00
UK	Poliçan	34.57	61.00	71.00	10.00
UK	Delvinë	41.00	80.00	88.00	8.00
UK	Kolonjë	117.00	144.00	141.00	3.00
UK	Libohovë	46.66	48.03	45.00	3.03
UK	Këlcyrë	59.77	63.00	58.00	5.00
UK	Pustec		71.00	64.00	7.00
UK	Mirditë	69.75	68.00	61.00	7.00
UK	Has	59.04	62.00	49.00	13.00
UK	Fushë Arrëz	56.11	63.00	49.00	14.00
UK	Tropojë	105.16	105.00	86.00	19.00

Për shoqëritë e Grupit të III-të, për pjesën më të madhe të shoqërive, treguesi i mbulimit të Kostove O&M në vitin 2018 ka patur tendencë negative krahasuar me vitin 2017.

Shoqëria UK Tropojë ka shënuar regresin më të madh me 19% duke e zbritur shoqërinë nga niveli i performancës shumë të mirë për dy vite rresht në nivelin e performancës së pranueshme me 86%. Rënia e këtij treguesi ka ardhur nga fakti se të ardhurat kanë shënuar ulje me rreth 4 milion lekë dhe kostot janë mbajtur në nivelin e vitit paraardhës.

Përmirësimin më të madh e ka shënuar UK Konispol me 32% si dhe Bashkia Pukë dhe UK Poliçan respektivisht me 22% dhe 10%. UK Konispol është shoqëri e re e cila është krijuar në zbatim të Reformës Territoriale.

Përfundime

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2018 është përmirësuar krahasuar me vitin 2017. Nga 55 shoqëri të cilat kanë raportuar të dhëna për vitin 2018 dhe janë analizuar rezultojnë se 17 prej tyre kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 9 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 29 shoqëri janë në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 7 shoqëri të cilat nuk mbulojnë as 50% të kostove O&M. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot e vijueshmërisë së shërbimit, rrjedhimisht mbështetja me subvencione nga buxheti i shtetit është e domosdoshme.

UK Kamëz nuk është analizuar në vitet e mëparshme pasi ka qenë pjesë e UK Tiranë dhe këtë vit është përfshirë në analizën krahasimore, pasi dhe disponohet informacion krahasimor. Sipas të dhënave të AKUM kjo shoqëri raporton mbulimin e kostove O&M në masën 170 %, edhe pse është shoqëri e pa licencuar dhe pa tarifa të miratuara nga ERRU për probleme të përmbushjes së kushteve ligjore për licencim, zgjidhja e të cilave është akoma në proces gjyqësor me shoqërinë UK Tiranë.

Edhe pse 50% e shoqërive raportojnë rënie të këtij treguesi tendenca e sektorit për vitin 2018 ka qenë pozitive me +10%. Përmirësimi ka ardhur nga influenza sasiore e shoqërive të Grupit të I-rë të cilat janë dominuese në sektor, ku peshën kryesore e ka UK Tiranë. Të ardhurat nga aktiviteti UK dhe Kostot O&M të Grupit të I-rë të shoqërive zënë respektivisht 87% dhe 78% të gjithë sektorit UK, ku vetëm UK Tiranë si shoqëria më e madhe që operon në sektor përfaqëson 43% të të ardhurave dhe 29% të kostove të gjithë sektorit.

ERRU konsideron mbulimin total të Kostove O&M nga shoqëritë, si një hap i parë drejt mbulimit të Kostove Totale në të ardhmen. Kostot e O&M janë elementi bazë i propozimeve të shoqërive për tarifa të reja për ti mbuluar ato. Vendosja e tarifave sa më të drejta kërkon vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer.

ERRU është gjithnjë e më shumë kërkuese ndaj shoqërive për të argumentuar në mënyrë të detajuar justifikimin e kostove që raportojnë, si dhe analizon me kujdes elementet ku ato mund të reduktohen. Një nga këto aspekte është ndarja e shpenzimeve sipas qendrave të kostos për të bërë një tarifim sa më të saktë për të dy shërbimet veç e veç dhe për të qenë transparent ndaj konsumatorëve.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar gjithashtu se përmirësimi i situatës financiare të shoqërive UK duhet të vijë jo vetëm nga rritja e tarifave, por edhe nga një manaxhim i mirë i burimeve teknike e financiare, analiza e së cilave është pjesë e pandashme e procesit të marrjes në konsideratë të propozimeve të shoqërive për tarifa të reja.

2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale

Objektivi final i çdo shoqërie duhet të jetë mbulimi i Kostos Totale me të ardhurat. Për vitin 2018, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 92%. duke shënuar përmirësim me 7%. Gjithsesi ky tregues edhe për vitin 2018 qëndron mbi nivelet e performancës së mirë (80%) të përcaktuara nga ERRU.

Në dallim nga analizat e viteve të kaluara ERRU në këtë raport nuk i ka analizuar në grupe shoqëritë por sektorin në tërësi pasi janë vetëm dy shoqëri UK Tiranë dhe UK Kolonjë që mbulojnë Kostot Totale përkatësisht 129% dhe 128% dhe pjesa tjetër e shoqërive janë në nivele nga 22% deri në 98%.

Në totalin e shoqërive që kanë raportuar të dhëna në nivelin e performancës së mirë mbi 80% janë 18 shoqëri dhe pjesa tjetër 35 shoqëri janë nën këtë nivel.

Raportohen 15 shoqëri me nivele shumë të ulëta të mbulimit të kostove totale nën 50%, shoqëritë UK Patos, UK Vau Dejës, UK Has, UK Tepelenë, UK Mirditë, UK Kurbin dhe UK Fushë Arrëz me nivel realizimi të këtij treguesi nga 22% deri 38%.

Një situatë e tillë është krejtësisht e papranueshme pasi këto shoqëri nuk arrijnë të përballojnë as pagat e stafit të tyre e jo më të arrijnë të përmirësojnë shërbimin duke kryer investime qofshin minimale. Rregullimi i tyre nëpërmjet agregimit me shoqëri të forta financiarisht ose mbajtja me subvencione nga qeveria mund të zgjidhë situatën e tyre.

Për përballimin e Kostove Totale për sektorin UK nevojat për subvencione llogariten në 18.2 milion euro. Tabela 15 paraqet ecurinë e këtij treguesi për të gjithë shoqëritë gjatë tre viteve të fundit.

Tabela 15. Ecuria e Mbulimit të Kostove Totale

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Vorë	-	51.00	85.00	34.00
UK	Konispol	-	41.00	67.00	26.00
UK	Himarë	67.00	70.00	92.00	22.00
UK	Durrës	76.15	73.00	94.00	21.00
UK	Skrapar	36.38	34.00	54.00	20.00
UK	Tiranë	138.00	129.00	148.00	19.00
UK	Maliq	57.69	51.00	68.00	17.00
UK	Mat	102.00	83.00	97.00	14.00
UK	Divjakë	43.52	48.00	62.00	14.00
UK	Lezhë	95.52	83.00	94.00	11.00
UK	Dibër	106.50	85.00	96.00	11.00
UK	Mallakastër	44.47	38.00	48.00	10.00
UK	Roskovec	-	49.00	58.00	9.00
UK	Poličan	31.44	57.00	66.00	9.00
UK	Elbasan	76.86	67.00	75.00	8.00
UK	Kavajë	39.01	42.00	50.00	8.00
U	Bulqizë	77.94	71.00	79.00	8.00
UK	Bashkia Pukë	82.00	62.00	70.00	8.00
U	Selenicë	28.94	53.00	60.00	7.00
UK	Delvinë	38.00	57.00	64.00	7.00
UK	Krujë	56.52	42.00	48.00	6.00
UK	Berat - Kuçovë	98.00	94.00	98.00	4.00
UK	Patos	17.39	18.00	22.00	4.00
UK	Lushnje	65.00	49.00	52.00	3.00
UK	Vlorë	51.85	45.00	48.00	3.00
UK	Librazhd	100.00	89.00	92.00	3.00
UK	Kukës	71.00	93.00	94.00	1.00
UK	Sarandë	88.00	92.00	92.00	0.00
UK	Fier	102.72	88.00	88.00	0.00
UK	Pogradec	54.00	58.00	58.00	0.00
UK	Malësi e Madhe	31.99	83.00	83.00	0.00
UK	Peqin	46.69	48.00	48.00	0.00
U	Gramsh	84.00	79.00	78.00	1.00
UK	Belsh	58.73	69.00	68.00	1.00
UK	Kolonje	107.00	128.00	127.00	1.00
U	Përmet	69.12	70.00	68.00	2.00
UK	Mirditë	33.91	36.00	34.00	2.00
UK	Rrogozhinë	47.20	55.00	52.00	3.00
UK	Libohovë	40.72	47.00	43.00	4.00
UK	Devoll	92.00	95.00	89.00	6.00
UK	Kurbin	39.05	42.00	36.00	6.00
UK	Vau i Dejës	25.19	30.00	24.00	6.00
UK	Korçë	98.60	98.00	90.00	8.00
UK	Këlcyrë	54.78	58.00	50.00	8.00
UK	Pustec		67.00	55.00	12.00
UK	Fushë Arrëz	41.77	50.00	37.00	13.00
UK	Gjirokastër	104.00	96.00	82.00	14.00
UK	Cërrik		77.00	63.00	14.00
UK	Tepelenë	54.47	46.00	32.00	14.00
UK	Shkodër	78.65	72.00	57.00	15.00
UK	Tropojë	78.93	80.00	65.00	15.00
UK	Has	44.29	51.00	32.00	19.00
UK	Ura Vajgurore	51.96	67.00	45.00	22.00

Edhe pse shoqëritë kanë nivele të ulëta të treguesit “Mbulimi i Kostove Totale”, ajo që paraqitet akoma më problematike është se raportohet që 21 shoqëri kanë tendencë negative të treguesit krahasuar me vitin 2017. Me rënie të konsiderueshme paraqiten shoqëritë UK Ura Vajguore, UK Has, UK Shkodër, UK Gjirokastër si dhe UK Fushë Arrëz.

UK Kamëz rezulton me pasaktësi në raportimet e viteve 2016 dhe 2017 në drejtim të kostove dhe për këtë arsye nuk është konsideruar për tu krahasuar me vitin 2018. Gjithashtu dhe UK Dropull ka vetëm të dhëna për vitin 2018 pasi është shoqëri e re.

Në sektor konstatohen që ka shumë shoqëri që kanë shtuar përpjekjet e tyre në drejtim të një menaxhimi sa më të mirë, duke reduktuar kostot e pajustificuara, duke legalizuar lidhjet e paligjshme kanë arritur të rrisin të ardhurat e tyre duke përmirësuar treguesin” Mbulimi i Kostove Totale”.

Shoqëri me tendencë pozitive të treguesit numërohen 27 nga të cilat me rritje të konsiderueshme janë UK Vorë (+34%), UK Konispol (+26%), UK Himarë (+22%) UK Durrës (+21%) si dhe UK Maliq, UK Mat, UK Divjakë, UK Lezhë, UK Dibër etj.

Janë 5 shoqëri që treguesin e Mbulimit të Kostove edhe për vitin 2018 e kanë mbajtur konstant në nivelin e vitit paraardhës dhe konkretisht: UK Sarandë (92%), UK Fier (88%), UK Pogradec (58%), UK Malësi e Madhe (83%), dhe UK Peqin (48%).

Përfundimisht themi se efektin pozitiv apo negativ edhe për këtë tregues e japin shoqëritë e mëdha, kryesisht ato të Grupit të I-rë pasi të ardhurat dhe kostot e tyre llogariten respektivisht 87% dhe 80% ndaj totalit të sektorit, dhe vetëm UK Tiranë është shoqëria dominuese në sektor e cila zë 44% të të ardhurave dhe 27 % të kostove të gjithë sektorit UK.

2.3.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës kanalizime. Ky tregues tregon efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj.

Në thelb, norma e arkëtimit varet kryesisht nga faktorë manaxherial. ERRU në analizën e shoqërive sipas grupeve edhe për vitin 2018 ka verifikuar të dhënat për shumë shoqëri për të cilat mendohej se informacioni ishte i pasaktë, mbi bazën e tyre ka rillogaritur treguesit Norma e Arkëtimit Korente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin korent (2018) si dhe Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku janë përfshirë dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues.

Për vitin 2018 NAK rezulton 79% që është në të njëjtin nivel me vitin 2017 ndërsa NAP është 98% me një përmirësim prej 5%.

Nga debitë e prapambetura gjatë vitit 2018 janë arkëtuar rreth 1 787 milion lekë, duke shënuar një rritje me 71% (rreth 750 milion lekë) kundrejt vitit paraardhës. Kjo tregon për një angazhim maksimal nga ana e shoqërive edhe në kuadër të nismave të qeverisë për rregullimin e sektorit UK.

Në analizën e Grupeve fokusi është NAK pasi sa më e lartë efiçenca e mbledhjes së të ardhurave korente aq më pak rritet debia e vjetër.

Performanca për Vitin 2018

Grupi i I-rë i Shoqërive

Figura 7 jep grafikisht Normën e Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë të shoqërive UK




Figura 7. Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë, Viti 2018

Në Grupin e I-rë, shoqëritë me performancën më të mirë me mbi 82% të këtij treguesi për vitin 2018 janë UK Kamëz me 96%, UK Tiranë me 87%, UK Lezhë me 85% si dhe UK Berat-Kuçovë me 83%. Në brezin e performancës së dobët nën 60% është vetëm UK Kavajë me 50%, pjesa tjetër e shoqërive janë në brezin e performancës së pranueshme (60% deri 82%)

Tabela 16 paraqet ecurinë e treguesit Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë.

Tabela 16. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Lushnje	57.17	70.28	79.00	8.72
UK	Kamëz	90.00	88.16	96.00	7.84
UK	Durrës	76.60	67.77	74.00	6.23
UK	Shkodër	62.51	65.10	71.00	5.90
UK	Lezhë	79.69	79.63	85.00	5.37
UK	Sarandë	62.13	74.42	79.00	4.58
UK	Elbasan	74.36	60.08	63.00	2.92
UK	Tiranë	86.11	86.24	87.00	0.76
UK	Vlorë	66.19	64.48	63.00	1.48
UK	Berat - Kuçovë	83.32	85.86	83.00	2.86
UK	Fier	62.02	77.02	72.00	5.02
UK	Korçë	79.00	79.93	74.00	5.93
UK	Pogradec	84.88	85.63	75.00	10.63
UK	Kavajë	79.02	82.98	50.00	32.98

Në Grupin e I-rë përmirësimi në mbledhjen e të ardhurave krahasuar me një vit më parë varion nga 0.76% deri në 8.72%. Nga 14 shoqëri të analizuar, 8 prej tyre kanë shënuar përmirësim dhe 6 të tjera përkeqësim të treguesit NAK. Rënien më të madhe të treguesit në këtë grup e ka UK Kavajë me rreth 33% për të cilën shoqëria sqaron se kjo është situata reale dhe është punuar më shumë në drejtim të arkëtimit të debive të vjetra. Analiza e kësaj gjendje për UK Kavajë do të jetë në fokusin kryesor për vitin 2019 që përbën një rekord tendence negative aq më shumë angazhimit në rritje që duhej të rezultonte nga Reforma në Sektor me fokus të veçantë rritjen e efijencës së arkëtimit.

Rënie të konsiderueshme të NAK kanë shënuar dhe UK Pogradec me 10.63%, UK Korçë me 5.93% si dhe UK Fier me 5.02%. Kjo rënie për këto shoqëri shpjegohet me faktin e influencës akoma negative të zonave rurale të përfshira në zonën e shërbimit, të cilat këtë tregues e kanë patur në nivele përgjithësisht mjaft të ulëta.

Përmirësimin më të ndjeshëm të këtij treguesi e ka patur UK Lushnje me + 8.72%, UK Kamëz me 7.84% si dhe shoqëritë e tjera UK Durrës, Shkodër, Lezhë, Sarandë dhe Elbasan. UK Tiranë ka një përmirësim të vogël me rreth 0.76%, e cila progreson vit pas viti me nivele të ulëta por që kanë peshë të konsiderueshme në vlerë absolute.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 12 jep grafikisht Normën e Arkëtimit Korente për Grupin e II-të të shoqërive UK




Figura 8. Norma e Arkëtimit Korente për grupin e II-të, Viti 2018

Në Grupin e II-të nga 29 shoqëri që kanë raportuar të dhëna dhe që paraqiten në grafikun e mësipërm, UK Dropull është shoqëri e re e formuar në kuadër të reformës administrative territoriale, e cila në grafik paraqitet vetëm me një shtyllë atë të vitit 2018 ku NAK është 68% duke u klasifikuar në brezin e performancës së pranueshme.

Në brezin e performancës së pranueshme janë 20 shoqëri duke filluar nga UK Librazhd me 81% deri te UK Rrogozhinë me 62%. Në zonën e performancës së dobët janë dy shoqëri, përkatësisht UK Dibër me 48% dhe UK Roskovec me 42%.

Tabela 17 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e II-të të shoqërive.

Tabela 17. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Krujë	65.63	72.82	89.00	16.18
UK	Malësi e Madhe	76.77	54.85	70.00	15.15
UK	Peqin	77.28	71.42	86.00	14.58
UK	Ura Vajgurore	87.14	71.99	83.00	11.01
UK	Kukës	69.40	60.09	71.00	10.91
U	Gramsh	84.19	82.61	88.00	5.39
U	Selenicë	91.41	71.73	76.00	4.27
UK	Rrogozhinë	76.41	58.89	62.00	3.11
UK	Patos	77.15	80.34	82.00	1.66
UK	Skrapar	78.96	82.42	84.00	1.58
UK	Vorë		64.31	64.00	0.31
UK	Roskovec		43.20	42.00	1.20
UK	Kurbin	93.40	80.52	79.00	1.52
UK	Tepelenë	75.05	75.93	74.00	1.93
U	Bulqizë	74.75	77.60	75.00	2.60
UK	Himarë	63.26	75.34	72.00	3.34
UK	Mat	82.82	77.53	74.00	3.53
UK	Belsh	80.00	72.80	69.00	3.80
UK	Vau i Dejës	87.63	81.36	76.00	5.36
U	Përmet	89.56	86.48	79.00	7.48
UK	Dibër	68.88	57.32	48.00	9.32
UK	Gjirokastër	98.73	87.40	75.00	12.40
UK	Cërrik		89.41	76.00	13.41
UK	Maliq	81.77	96.40	82.00	14.40
UK	Mallakastër	79.86	78.17	63.00	15.17
UK	Librazhd	97.07	97.65	81.00	16.65
UK	Divjakë	89.55	86.82	69.00	17.82
UK	Devoll	80.49	82.84	63.00	19.84

Ecurinë më të mirë e ka UK Krujë me (+16.18%) që e ka çuar këtë shoqëri nga performanca e pranueshme në atë të performancës së mirë, UK Malësi e Madhe me (+15.15%), UK Peqin (+14.58%) si dhe 7 shoqëri të tjera, por me vlera më të ulëta, përkatësisht UK Ura Vajgurore(+11.01), UK Kukës (+10.91), UK Gramsh (+5.39), UK Selenicë (+4.27), UK Rrogozhinë (+3.11), UK Patos (+1.66) dhe UK Skrapar me (+1.58).

Në këtë Grup janë 18 shoqëri që kanë përkeqësuar treguesin e NAK nga të cilat 7 shoqëri kanë rënie në nivelin 2-shifror, ku rënien më të madhe e ka shënuar UK Devoll me (-19.84%) duke vijuar me UK Divjakë (-17.82), UK Librazhd (-16.65), UK Mallakastër (-15.17), UK Maliq (-14.4), UK Cërrik (-13.41) dhe UK Gjirokastër (-12.4). Këto shoqëri megjithëse kanë nivel të përkeqësuar të treguesit NAK, realizojnë

treguesin e NAP në nivele shumë të mira. Kjo tregon një vëmendje të shtuar për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura duke lënë mbas dore arkëtimet korente.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 9 jep grafikisht Normën e Arkëtimit Korente për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 9. Norma e Arkëtimit Korente për grupin e III-të, Viti 2018

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 12 shoqëri, ku në 2 prej tyre treguesi NAK është në nivelin mbi 82% (performancës së mirë), përkatësisht shoqëritë UK Kolonjë me 92.% dhe UK Fushë Arrëz me 82%.

Në nivelin e performancës së pranueshme (60-82%) janë 8 shoqëri duke filluar me UK Poliçan me NAK 79 % deri te UK Tropojë me 64%. Në brezin e kuq të performancës së dobët janë dy shoqëri, përkatësisht UK Has me 59% dhe UK Pustec me 38%. Kjo e fundit me këtë performancë nuk ka likuiditete as për të përballuar pagat.

Tabela 18 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e III-të të shoqërive.

Tabela 18. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Fushë Arrëz	68.33	57.72	82.00	24.28
UK	Tropojë	56.35	50.62	64.00	13.38
UK	Këlcyrë	76.42	60.19	71.00	10.81
UK	Delvinë	61.99	72.07	78.00	5.93
UK	Libohovë	65.08	65.11	69.00	3.89
UK	Poliçan	75.33	79.34	79.00	0.34
UK	Kolonjë	91.06	92.43	90.00	2.43
UK	Mirditë	77.69	69.38	64.00	5.38
UK	Pustec		46.52	38.00	8.52
UK	Bashkia Pukë	88.21	89.27	73.00	16.27
UK	Has	71.06	76.14	59.00	17.14
UK	Konispol		94.77	77.00	17.77

Siç tregohet në tabelën 18, në Grupin e III-të janë 5 shoqëri që raportojnë përmirësim të treguesit NAK, në krye qëndron UK Fushë Arrëz me (+24.28%) e me radhë shoqëritë e tjera sipas tabelës së mësipërme. Në fund ecurinë më të dobët e kanë 4 shoqëri, përkatësisht UK Konispol me (-17.77%), UK Has (-17.14%) UK Bashkia Pukë (-16.27%).

Përfundime

Përlllogaritja e këtij treguesi është bërë mbi bazën e informacionit shtesë nga shoqëritë lidhur me arkëtimet korente pasi raportimi në AKUM i shoqërive rezultoi i pasaktë. Kjo evidentohet sepse pyetësorët nuk janë plotësuar në të njëjtën mënyrë nga të gjitha shoqëritë ku ka një ndërthurje dhe një raportim të pasaktë në arkëtimet e debive të vjetra ku shumë shoqëri përfshijnë në këto debi dhe arkëtimet e vonuara të vitit aktual që në fakt nuk duhet të konsiderohet si debi e vjetër.

ERRU ka korrigjuar të dhënat për rreth 15 shoqëri, por gjithsesi kërkohet kohë më shumë për të vlerësuar marzhin e gabimit në raportim për këtë tregues nga shoqëritë e tjera.

Referuar sektorit në tërësi, nga 54 shoqëri të analizuar 13 shoqëri rezultojnë me NAK në nivelin e performancës së mirë. Në nivelin e performancës së pranueshme (60%-82%) janë 36 shoqëri, dhe në nivelin e performancës së dobët (nën 60%) janë 5 shoqëri.

Gjithsesi vërehet se NAK mesatare për sektorin është në të njëjtin nivel me atë të vitit 2017 ndërsa NAP ka një përmirësim me 5%. Pavarësisht se për vitin 2018 NAK ka mbetur konstant me atë të vitit 2017, vërehet se 43% ose (23 shoqëri) e shoqërive kanë progresuar, ndërsa 31 shoqëritë e tjera paraqiten me rënie të këtij treguesi. Stafet e shoqërive të fundit duhet të shtojnë përpjekjet, me plane veprimi me qëllim arkëtimin e faturave për shërbimet UK.

Një saktësim i mëtejshëm dhe i tendencës së ecurisë për këto indikatorë është i nevojshëm për disa shoqëri që janë të reja, ose akoma nuk kanë përfunduar riorganizimin, vlerësimi i të cilave do të kryhet rast pas rasti.

2.3.5 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes është raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje. Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matës të kategorive të konsumatorëve dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në komponentet e sistemeve të furnizimit me ujë. Rritja e nivelit të matur të ujit, influencën në vlerësimin më realist të gjendjes së treguesit "Uji Pa të Ardhura". Treguesi i Nivelit të Matjes është rritur me 5.7 % për vitin 2018 duke e çuar nivelin e matjes në 74 % nga 68.3% që ishte në vitin 2017. Sërisht ky tregues vazhdon të qëndrojë larg objektivit të vendosur nga ERRU i cili është 85%.

Ecuria ndër vite tregon se mbetet ende shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim në arritjen e këtij treguesi. Ky tregues është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë duke ndikuar në përmirësimin e tyre.

Qeveria qendrore me anë të MIE ka demonstruar një interes të veçantë për të financuar instalimin e plotë të matësve për të gjithë konsumatorët familjarë gjatë vitit 2019. Ndërkohë vërehet një interesim në rritje nga vetë shoqëritë për planifikimin dhe instalimin e matësve brenda mundësive financiare të tyre.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2018

Figura 10 jep grafikisht Nivelin e Matjes për Grupin e I-rë të shoqërive UK




Figura 10. Niveli i Matjes për grupin e I-rë, Viti 2018

Ecuria e këtij treguesi ka ndryshuar në funksion të realizimit të procesit të riorganizimit të shoqërive në kuader të reformës. Ky tregues në disa raste ka reflektuar rënie të tij për shkak të nivelit të ulët të tij për zonat rurale që i janë bashkuar zonës së shërbimit të shoqërive të mëparshme. Kështu Sh.a UK Korçë, e

cila për vite me radhë ka qenë shoqëria e vetme me nivel matje 100%, për këtë vit ka raportuar nivel të matjes 94 % me një rritje pothuajse të pa përfillshme krahasuar me vitin 2017 prej 0.44 %. Nga 14 shoqëri të këtij grupi, 13 shoqëri kanë përmirësim të këtij treguesi ndërsa vetëm një shoqëri ka raportuar ulje të nivelit të matjes.

Krahasuar me vitin 2017, rritje të dukshme të këtij treguesi kanë raportuar 3 shoqëri, përkatësisht UK Kamëz (58 %) me rritje 24.17 %, UK Sarandë (84 %) me rritje 11.39 % si dhe UK Lezhë (83 %) me rritje 10.45 %. Mbi nivelin e performancës së mirë prej 85 % kanë raportuar 4 shoqëri UK Korçë (94 %), UK Durrës (93 %), UK Lushnje (93 %) dhe UK Tiranë (86 %). Shoqëritë e tjera kanë nivelin e matjes nën kufirin e performancës së mirë.

Tabela 19 paraqet ecurinë e treguesit të Nivelit të Matjes për Grupin e I-rë të shoqërive.

Tabela 19. Ecuria e Nivelit të Matjes për Grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Kamëz		33.83	58.00	24.17
UK	Sarandë	67.58	72.61	84.00	11.39
UK	Lezhë	66.46	72.55	83.00	10.45
UK	Fier	54.73	47.73	56.00	8.27
UK	Vlorë	37.79	39.16	46.00	6.84
UK	Berat - Kuçovë	49.69	64.86	71.00	6.14
UK	Tiranë	77.09	80.27	86.00	5.73
UK	Shkodër	51.85	54.49	60.00	5.51
UK	Lushnje	79.54	88.89	93.00	4.11
UK	Durrës	87.35	89.69	93.00	3.31
UK	Elbasan	66.07	66.45	69.00	2.55
UK	Kavajë	51.03	53.32	54.00	0.68
UK	Korçë	96.44	93.56	94.00	0.44
UK	Pogradec	99.19	99.87	84.00	15.87

Përkeqësim të këtij treguesi gjatë vitit 2018 krahasuar me vitin 2017 ka pësuar vetëm UK Pogradec (84 %) me një rënie shumë të lartë të nivelit të matjes me 15.87 % duke bërë që të zbres dhe nën nivelin e performancës së mirë. Sipas shoqërisë kjo rënie e theksuar ka ardh si rrjedhojë e marrjes së zonave të reja rurale të cilat nuk kanë pasur matësa të instaluar.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2018

Figura 11 jep grafikisht Nivelin e Matjes për Grupin e II-të të shoqërive UK




Figura 11. Niveli i Matjes për Grupin e II-të, Viti 2018

Në Grupin e II-të për vitin 2018 bëjnë pjesë 29 shoqëri, 1 (një) shoqëri më shumë se në vitin 2017, por janë analizuar 28 shoqëri, pasi UK Dropull është shoqëri e re e krijuar pas reformës administrative dhe nuk ka raportime për vitin 2018.

Për këtë vit mbi kufirin e performancës së mirë me nivel matje 85 % kanë raportuar 8 (tetë) shoqëri, përkatësisht UK Devoll, UK Librazhd, UK Himarë, UK Divjakë, UK Peqin, UK Rrogozhinë, UK Ura Vajgurore dhe UK Belsh. Nivelin e matjes 100% nuk e ka asnjëra prej këtyre shoqërive, ndërkohë që janë shumë afër këtij treguesi 5 prej tyre, si UK Devoll (99 %), UK Librazhd (97 %), UK Himarë (97 %), UK Divjakë (96 %) dhe UK Peqin (95 %).

Tabela 20 paraqet ecurinë e treguesit të Nivelit të Matjes për Grupin e I-rë të shoqërive për tre vitet e fundit.

Tabela 20. Ecuria e Nivelit të Matjes për Grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Himarë	56.74	62.00	97.00	35.00
UK	Vau i Dejës	8.78	46.16	70.00	23.84
UK	Maliq	45.51	47.97	71.00	23.03
UK	Mallakastër	29.38	39.32	62.00	22.68
UK	Skrapar		6.51	27.00	20.49
U	Vorë		46.52	63.00	16.48
UK	Gjirokastër	6.20	29.90	46.00	16.10
U	Gramsh	45.61	53.15	67.00	13.85
UK	Mat	44.59	43.47	57.00	13.53
UK	Rrogozhinë	63.21	76.49	90.00	13.51
UK	Malësi e Madhe	33.16	34.57	48.00	13.43
UK	Patos	19.16	21.80	32.00	10.20
UK	Ura Vajgurore	75.52	79.43	89.00	9.57
UK	Peqin	81.92	85.50	95.00	9.50
UK	Belsh	74.90	79.46	88.00	8.54
UK	Kurbin	13.03	12.17	19.00	6.83
U	Bulqizë	11.62	11.46	18.00	6.54
UK	Cërrik		74.19	80.00	5.81
UK	Krujë	73.67	64.58	70.00	5.42
U	Përmet	68.08	72.31	76.00	3.69
UK	Tepelenë	61.73	64.18	67.00	2.82
U	Selenicë	5.52	5.37	8.00	2.63
UK	Dibër	36.72	45.03	47.00	1.97
UK	Librazhd	95.17	95.43	97.00	1.57
UK	Dropull				0.00
UK	Devoll	98.45	99.57	99.00	0.57
UK	Divjakë	100.00	97.37	96.00	1.37
UK	Kukës	29.30	25.58	23.00	2.58
UK	Roskovec		68.15	59.00	9.15

Në këtë grup për këtë vit ka pasur tendencë rritje niveli i matjes pasi nga 28 shoqëri që merren në krahasim, 24 prej tyre kanë pësuar rritje të treguesit. Rritje më të lartë në këtë grup ka pësuar UK Himarë me 35 %, UK Vau – Dejës me 23.84 %, UK Maliq me 23.03 %, UK Mallakastër me 22.68 %, UK Skrapar me 20.49 %, UK Vorë me 16.48% dhe UK Gjirokastër me 16.1%. Përgjithësisht rritja e këtij treguesi ka ardhur nga financimet e qeverisë qendrore, pjesërisht janë financuar nga vetë shoqëritë, përveç UK Vau Dejes që financimi ka ardhur kryesisht nga vetë bashkia Vau Dejes.

Përkeqësim të këtij treguesi ka shoqëria UK Roskovec me rënie të nivelit të matjes me 9.15 %, por shoqëria pretendon se kjo ka ardhur për shkak të pasaktësisë së të dhënave të vitit 2017. Ndërsa 3 shoqëritë e tjera siç vërehet dhe nga tabela kanë pësuar rënie jo të ndjeshme të nivelit të matur në vlerën nën 2.58 %.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2018

Figura 12 jep grafikisht Nivelin e Matjes për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 12. Niveli i Matjes për Grupin e III-të, Viti 2018

Në Grupin e III-të për vitin 2018 merren në analizë 12 shoqëri pasi UK Finiq nuk ka raportime. Ky grup për vitin 2018 ka përmirësim krahasuar me vitin 2017 sepse të gjitha shoqëritë kanë pasur rritje të nivelit të matjes. Nivelin e performancës së mirë prej 85 % e ka kaluar vetëm UK Konispol e cila për vitin 2018 ka raportuar nivel matje 96 %.

Tabela 21 paraqet ecurinë e treguesit të Nivelit të Matjes për Grupin e III-të të shoqërive për tre vitet e fundit.

Tabela 21. Ecuria e Nivelit të Matjes për Grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Pustec		29.35	60.00	30.65
UK	Fushë Arrëz	1.15	0.67	31.00	30.33
UK	Poliçan	55.48	46.43	64.00	17.57
UK	Mirditë	43.45	40.18	55.00	14.82
UK	Këlçyrë	26.75	37.08	46.00	8.92
UK	Bashkia Pukë	43.02	46.44	55.00	8.56
UK	Konispol		91.21	96.00	4.79
UK	Has	62.97	63.78	68.00	4.22
UK	Delvinë	40.72	41.52	44.00	2.48
UK	Tropojë	34.84	72.08	74.00	1.92
UK	Libohovë	0.26	0.15	1.00	0.85
UK	Finiq				0.00
UK	Kolonje	66.27	68.92	52.00	16.92

Në këtë grup përmirësim të këtij treguesi kanë 4 shoqëri UK Pustec me rritje 30.65 %, UK Fushë Arrëz me rritje 30.33 %, UK Poliçan me rritje 17.57 % dhe UK Mirditë me rritje 14.82 %. Shoqëria më problematike për këtë tregues paraqitet UK Libohovë me vetëm 1 % të nivelit të matjes.

Përkeqësim në krahasim me vitin 2017 ka vetëm UK Kolonjë e cila ka një rënie të treguesit me 16.92 % ku nga 68.92 % në 52 % në vitin 2018.

Përfundime

Mesatarja e treguesit të nivelit të matjes për sektorin për vitin 2018 është 74 % me një rritje prej 5.7 % krahasuar me vitin 2017. Pavarësisht ecurisë së mirë kërkohet më shumë angazhim nga ana e shoqërive për të përmbushur objektivin prej 85 % për nivelin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive, dhe gjithashtu i krijon mundësi shoqërive të ulin prodhimin sipas kërkesës reale për ujë.

Për të tre grupet në total janë 13 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë mbi 85 % nga 9 që kanë qënë për vitin 2017. Nga këto shoqëri 4 janë në Grupin e I-rë, 8 në Grupin e II-të dhe vetëm 1 shoqëri në Grupin e III-të, në të cilin shoqëria UK Libohovë vazhdon të jetë pothuajse me shërbim të pa matur.

Rritje më të lartë të nivelit të matjes kanë UK Himarë me 35 %, UK Pustec me rritje 30.65 % dhe UK Fushë–Arrëz 30.33 %. Rënie më të dukshme të këtij treguesi kanë UK Pogradec me 15.87 %, UK Kolonjë me 16.92 % dhe UK Roskovec me 9.15 %. Në fokus të punës së operatorëve duhet të jetë zbatimi i programeve për instalimin e matësve individual dhe në prodhim për të bërë të mundur eliminimin e praktikës së faturimit aforfe të konsumatorëve. ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësve plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK si dhe mbështet e nxit të gjitha shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve individual.

2.3.6 Efiçenca e Stafit

Përmirësimi i efiçencës operacionale është kusht për arritjen e standarteve sa më të larta të shërbimit. Meqenëse kostoja e personelit zë një përqindje të madhe të kostove O & M, treguesi i efiçencës së stafit është tregues mjaft i rëndësishëm në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, si edhe me potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiçencës në punë.

Efikasiteti i stafit nënkupton që shoqëritë të mos kenë njerëz në organikën e tyre që nuk justifikojnë pozicionin dhe intensitetin e punës që presupozohet të kryejnë. Fatkeqësisht akoma sektori paraqitet i mbingarkuar me staf të pajustificuar që në përgjithësi janë punësuar në kritere partiake. Në mjaft raste kjo pjesë e stafit është jo vetëm jo efikase, por dekurajon edhe pjesën tjetër të stafit si shembull negativ i performancës në punë.

E veçanta e gjendjes së stafeve të shoqërive UK për vitin 2018 është se për shkak të marrjes në administrim të zonave rurale ka bërë që numri i stafit administrativ dhe operativ të rritet me rreth 358 punonjës. Duke patur parasysh që sektori gjatë vitit 2018 ka patur rritje me 62 848 lidhje të reja ujësjellësi dhe 54 352

lidhje KUN, efikasiteti i stafit për 1000 lidhje UK për sektorin në vitin 2018 është përmirësuar duke e ulur këtë tregues nga 5,5 në vitin 2017 në 5.35 në vitin 2018.

Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë e të tjera arsye, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Për Grupin e I-rë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët.

Figura 13 jep grafikisht Eficiencën e Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive UK




Figura 13. Eficienca e Stafit për Grupin e I-rë, Viti 2018

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen tre shoqëritë UK Korçë me 2.18/staf për 1000 lidhje, UK Kamëz me 2.27/staf për 1000 lidhje, dhe UK Tiranë me 3.81/staf për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme sipas grafikut paraqiten 7 shoqëri nga UK Vlorë me 4.38/staf për 1000 lidhje deri tek UK Pogradec me 5.24/staf për 1000 lidhje.

Në brezin e performancës së dobët janë 4 shoqëri dhe konkretisht UK Fier me 6.15/staf për 1000 lidhje, UK Shkodër, UK Lushnje dhe UK Kavajë me 8.14/staf për 1000 lidhje.

Tabela 22 paraqet ecurinë e treguesit të Eficiencës së Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 22. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2016 nr.	2017 nr.	2018 nr.	Ndryshimi 2018-2017 staf/1000 lidhje
UK	Lezhë	4.52	5.32	4.47	-0.85*
UK	Kamëz		2.77	2.27	-0.50
UK	Fier	7.20	6.56	6.15	-0.41
UK	Pogradec	6.03	5.50	5.24	-0.26
UK	Durrës	5.24	5.33	5.08	-0.25
UK	Elbasan	5.24	4.73	4.58	-0.15
UK	Shkodër	5.97	6.70	6.56	-0.14
UK	Berat - Kuçovë	4.78	4.96	4.85	-0.11
UK	Tiranë	3.08	3.92	3.81	-0.11
UK	Korçë	2.06	2.23	2.18	-0.05
UK	Vlorë	4.98	4.40	4.38	-0.02
UK	Sarandë	4.23	5.15	5.14	-0.01
UK	Lushnje	5.88	6.52	6.63	0.11
UK	Kavajë	6.72	7.97	8.14	0.17

***Shënim:** Shenja (-) tregon përmirësim të performancës

Tendencën pozitive më të mirë në Grupin e I-rë e ka pasur UK Lezhë, UK Kamëz, UK Fier, UK Pogradec dhe UK Durrës ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur përkatësisht me (0.85), (0.50), (0.41), (0.26) dhe (0.25) punonjës për 1000 lidhje.

Për UK Lezhë përmirësimi ka ardhur për shkak të numrit të lidhjeve UK përkatësisht me (3563) Ujë dhe (3278) KUN dhe një rritje e numrit të punonjësve me (11) e cila justifikohet me rritjen e numrit të lidhjeve UK. Shoqëria UK Kamëz ka një rënie me (0.5) të numrit të punonjësve edhe rritje të numrit të lidhjeve me (1464) Ujë dhe (7578) lidhje KUN.

Përmirësimi për shoqërinë UK Fier ka ardhur për faktin se si numri i stafit dhe ai i lidhjeve kanë pasur tendencë pozitive ku stafi është zvogëluar me 7 punonjës dhe lidhjet UK janë shtuar me 2959 lidhje.

Për UK Elbasan stafi është zvogëluar me (6) punonjës dhe janë shtuar lidhjet +(904) lidhje UK, ndërsa për shoqërinë UK Berat-Kuçovë ndryshimi me (0.11) ndërmjet dy viteve ka ardhur si pasojë e shtimit të lidhjeve UK me (1966).

Për Grupin e I-rë dy shoqëri kanë shënuar një përkeqësim të lehtë të treguesit që varion nga (+0.11) për UK Lushnje sepse ka një shtesë në staf prej 20 punonjësve dhe në (+0.17) për UK Kavajë sepse ka një ulje të numrit të lidhjeve të kanalizimeve. Të dy këto dy Shoqëri duhet të analizojnë më thellësisht shkaqet e mbingarkesës me staf si për numrin e madh të lexues-faturues, apo të pozicioneve të tjera në operim-mirëmbajtje, që kryesisht janë marrje në punë të natyrës partiake.

Gjithsesi vlerësimi i performancës duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë. Është i njohur fakti që ky tregues influencohet mjaft nga numri i personelit roje të cilin shoqëria është e detyruar ta zbatojë për të garantuar sigurinë në këto objekte që konsiderohen të rëndësishme të veçantë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Për Grupin e II-të, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6/staf për 1000 lidhje.

Figura 14 jep grafikisht Eficiencën e Stafit për Grupin e II-të të shoqërive UK




Figura 14. Efienca e Stafit për Grupin e II-të, viti 2018

Në këtë grup në nivelin e performancës së mirë bëjnë pjesë UK Devoll me një përmirësim prej 0.34, UK Librazhd me 0.33, dhe UK Maliq me 2.49 staf për 1000 lidhje.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 14 shoqëri duke filluar nga UK Krujë deri tek UK Bulqizë që variojnë brenda kufirit prej 6.06 deri 9.99 staf për 1000 lidhje.

Shoqëria UK Dropull nuk mund të ketë bazë krahasimi këtë vit sepse raporton për herë të parë.

Në zonën e kuqe, atë të performancës së dobët mbi 10 staf për 1000 lidhje renditen 11 shoqëri. Performuesi më i dobët në këtë grup është UK Peqin me tregues 23.16, duke vijuar me UK Mallakastër me 15.59, UK Malësi e Madhe me 13.11, si dhe UK Përmet, Divjakë, Patos, Kurbin e deri tek UK Vau-Dejës me 10.82 staf për 1000 lidhje UK.

Tabela 23 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e II-të të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 23. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2016 nr.	2017 nr.	2018 nr.	Ndryshimi 2018-2017 staf/1000 lidhje
UK	Roskovec		16.24	8.84	-7.40
U	Bulqizë	13.50	13.27	9.99	-3.28
UK	Kurbin	16.29	14.51	11.49	-3.02
UK	Ura Vajgurore	13.48	13.86	11.27	-2.59
UK	Maliq	8.16	8.55	6.06	-2.49
UK	Malësi e Madhe	16.30	15.28	13.11	-2.17
U	Selenicë	11.84	12.39	10.94	-1.45
UK	Divjakë	12.86	13.89	12.58	-1.31
U	Përmet	15.26	14.25	12.99	-1.26
UK	Tepelenë	7.41	9.59	8.43	-1.16
UK	Mallakastër	15.55	16.67	15.59	-1.08
UK	Patos	19.68	13.12	12.43	-0.69
UK	Peqin	20.98	23.67	23.16	-0.51
UK	Devoll	9.00	5.53	5.19	-0.34
UK	Librazhd	6.38	6.39	6.06	-0.33
UK	Cërrik		7.69	7.40	-0.29
UK	Skrapar	11.14	8.37	8.24	-0.13
UK	Belsh	9.56	9.13	9.10	-0.03
UK	Dibër	8.05	6.98	7.06	0.08
UK	Vorë		8.88	8.96	0.08
UK	Kukës	7.94	8.01	8.19	0.18
UK	Rrogozhinë	5.95	7.58	7.87	0.29
UK	Krujë	5.83	5.83	6.39	0.56
U	Vau i Dejës	11.35	10.24	10.82	0.58
UK	Mat	5.96	5.70	6.45	0.75
UK	Gramsh	10.32	7.79	8.84	1.05
UK	Himarë	6.50	6.19	7.35	1.16
UK	Gjirokastër	7.34	9.17	11.07	1.90
UK	Dropull			6.58	6.58

Për vitin 2018 për 18 shoqëri të këtij grupi tendenca ka qenë pozitive me përmirësime që variojnë me ndryshimet nga 0.03 p/1000/lidhje në 7.40 p/1000/lidhje, përmirësim që i takon UK Roskovec e cila ka patur tendencën pozitive më të madhe në grupin e dytë me një ndryshim (-7.40) p/1000/lidhje. Ky përmirësim ka ardhur për faktin e rritjes së numrit të lidhjeve të ujit (+1,233) dhe me sistemin e kanalizimeve (+1469 lidhje Kanalizime) ndërsa numri i punonjësve është zvogëluar me (-2).

Janë 10 shoqëri që kanë pasur tendencë lehtësisht përkeqësimi ku fillon me UK Dibër dhe përfundon me UK Gjirokastër që kanë një rritje me (+0.08) dhe (+1.90) punonjës për 1000 lidhje. Këtë vit edhe UK Vorë që analizohet për herë të parë ka një tendencë përkeqësimi me (+0.08) me një shtesë (+52) punonjësish.

Gjithsesi vlerësimi i performancës duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë. Është i njohur fakti që ky tregues influencohet mjaft nga numri i personelit roje të cilin shoqëria është e detyruar ta zbatojë për të garantuar sigurinë në këto objekte që konsiderohen të rëndësishme të veçante.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Për Grupin e III-të niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.

Figura 15 jep grafikisht Efiçencën e Stafit për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 15. Efiçenca e Stafit për Grupin e III-të, Viti 2018

Në Grupin e III-të, 6 nga 12 shoqëri kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është UK Kolonjë me tregues 5.83 punonjës për 1000 lidhje.

Në nivelin e performancës së mirë renditen edhe UK Delvinë me 6.21, UK Poliçan me 7.88, UK Pustec me 8.85, UK Fushë-Arrëz me 9.16 dhe Bashkia Pukë me 9.84 punonjës për 1000 lidhje.

UK Poliçan së bashku me UK Pukë e kanë këtë tregues respektivisht 7.88 dhe 9.84 duke kaluar nga brezi i performancës së pranueshme në atë të mirë.

Në brezin e performancës së pranueshme, pra në nivelin 10-15 punonjës janë 4 shoqëri, respektivisht, UK Mirditë, Libohovë, Konispol dhe Tropojë. Dy nga këto shoqëri kanë qenë në këtë zonë edhe në vitin 2017, ndërsa shoqëritë UK Tropojë dhe UK Libohovë e kanë përmirësuar këtë tregues respektivisht në 10.42 dhe 14.09 duke kaluar kështu në brezin e shoqërive me performancë të pranueshme.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 2 shoqëri. UK Këlcyrë renditet e fundit me (20.55) punonjës për 1000 lidhje dhe UK Has me (19.44) punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 24 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e III-të të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 24. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2016 nr.	2017 nr.	2018 nr.	Ndryshimi 2018-2017 staf/1000 lidhje
UK	Poliçan	28.96	16.86	7.88	-8.98
UK	Tropojë	16.41	15.06	10.42	-4.64
UK	Bashkia Pukë	9.43	11.61	9.84	-1.77
UK	Libohova	12.76	15.44	14.09	-1.35
UK	Delvinë	7.26	6.59	6.21	-0.38
UK	Kolonjë	5.41	6.11	5.83	-0.28
UK	Mirditë	12.49	11.94	11.77	0.17
UK	Fushë - Arrëz	8.64	9.22	9.16	0.06
UK	Has	20.61	19.31	19.44	0.13
UK	Pustec		6.78	8.85	2.07
UK	Konispol		8.70	12.99	4.29
UK	Këlcyrë	13.77	14.25	20.55	6.30

Ndryshim pozitiv të ndjeshëm kanë patur shoqëritë UK Poliçan, UK Tropojë si dhe Bashkia Pukë.

Tendencën negative më të madhe e ka UK Këlcyrë me +6.30, UK Konispol +4.29, UK Pustec +2.07 dhe UK Has me +0.13 punonjës për 1000 lidhje.

Gjithsesi vlerësimi i performancës duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë. Është i njohur fakti që ky tregues influencohet mjaft nga numri i personelit roje të cilin shoqëria është e detyruar ta zbatojë për të garantuar sigurinë në këto objekte që konsiderohen të rëndësishë së veçantë. Kjo influencë është më e dukshme në shoqëritë e vogla që i përkasin Grupit të III-të.

Përfundime

Përmirësimi i efiçencës së stafit ndikon në rënien e kostove të punës dhe vlerësohet si një element thelbësor i efiçencës operacionale dhe financiare të shoqërive UK.

Në vitin 2018, treguesi staf për 1000 lidhje ka pësuar një rënie të lehtë me vitin paraardhës.

Nevoja dhe rritja e numrit të punonjësve justifikohet në pjesën më të madhe të tyre nga zhvillimet në sektor, riorganizimi i shoqërive dhe zgjerimi i zonës së shërbimit.

Krahasuar me një vit më parë numri i lidhjeve UK është rritur me rreth 64 677 lidhje Uji dhe 57 077 Lidhje KUN dhe në pamje të parë duket sikur ky tregues do të ishte përmirësuar në nivele të konsiderueshme, por efikasiteti i stafit për 1000 lidhje UK për sektorin në vitin 2018 është përmirësuar lehtësisht duke e ulur këtë tregues nga 5,5 në vitin 2017 në 5.35 në vitin 2018. Situata nuk ka ndryshime të theksuara për arsye sepse ka vazhduar edhe rritja e numrit të punonjësve për shërbimet ujësjellës kanalizime me 412 punonjës të rinj, motivi i marrjes në punë të tyre paraqitet jo i justifikuar.

Rritja e numrit të punonjësve është e lidhur me kostot e punës, të cilat janë rritur me 392 milion lekë. Objektivi kryesor strategjik i sektorit UK për të arritur qëndrueshmërinë financiare përmes mbulimit të kostove, mbetet një shqetësim për ERRU-në pasi rritja e numrit të stafit dhe nivelet e ulëta të produktivitetit të tyre kanë ndikim të madh në performancën e shoqërisë.

Fatkeqësisht akoma sektori paraqitet i mbingarkuar me staf të pajustificuar që në përgjithësi janë punësuar në kritere partiake. Në mjaft raste kjo pjesë e stafit është jo vetëm jo efikase, por dekurajon edhe pjesën tjetër të stafit si shembull negativ i performancës në punë.

Lidhur me këtë tregues suksesi qëndron në optimizimin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të dedikuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësive si dhe zgjerimin e bazës së klientëve.

Rritja e kapaciteteve profesionale, tërheqja dhe motivimi i profesionistëve të trajnuar dhe transferimi efikas i njohurive teknike do të kishte efekt të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërive.

ERRU do të kushtojë kujdes të veçantë shqyrtimit të organogramave të shoqërive kur ato paraqesin aplikime për tarifa të reja që ato të jenë të justifikuara në numër punonjësish, pozicione dhe përshkrime të punës për secilin prej tyre.

2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Një nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit mbetet kohëzgjatja e furnizimit me ujë e cila është mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët.

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë lidhet me aftësinë e shoqërisë për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi në mënyrë që t'u japë konsumatorëve të saj shërbimin në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbikonsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete.

Ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, kërkon vëmendjen nga shoqëritë UK dhe duhet të mbetet prioritet, pasi me arritjen e standardeve të kërkuara për këtë tregues, shoqëritë përmirësojnë shërbimin ndaj konsumatorëve, rrisin të ardhurat e tyre dhe ulin kërkesën e konsumatorëve për burime të tjera të furnizimit me ujë.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 16 jep grafikisht Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë për Grupin e I-rë të shoqërive UK

Grupi I-rë - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 16. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për Grupin e I-rë, Viti 2018

Gjatë vitit 2018, në Grupin e I-rë rezultojnë 5 shoqëri të klasifikuara me performancë të mirë për treguesin e Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë, përkatësisht UK Korçë, Fier, Pogradec, Lezhë dhe Shkodër. Në këtë grup nga analiza e bërë gjatë vitit 2018 shihet që ka pasur luhatje të vogla të këtij treguesi.

Shoqëria që paraqet një përmirësim të dukshëm të këtij treguesi deri në 14.30 orë/ditë është UK Berat-Kuçovë si pasojë e përfundimit të rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm që ka ulur nivelin e humbjeve teknike dhe administrative.

Shoqëria e dytë është UK Durrës që ka përmirësim të këtij treguesi nga 3.01 orë/ditë në vitin 2017 në 5.08 orë/ditë në vitin 2018. Megjithatë UK Durrës është ndër shoqëritë më të mëdha të Grupit të I-rë edhe pas këtij përmirësimi mbetet përsëri për të tretin vit rradhazi nën kufirin e performancës së dobët. Pritet një përmirësim i dukshëm i këtij treguesi për Durrësin për vitin 2019 ku pritet të përfundojnë punimet për ujësjellësin e ri, i cili do të shtojë një prurje rreth 650 litra/sek në zonën e shërbimit.

Në këtë grup janë 5 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë me mbi 18 orë ujë në ditë dhe përveç UK Korçë, UK Shkodër dhe UK Fier që ishin në vitin 2017, janë shtuar dhe 2 shoqëri të reja që në vitin 2017 kanë qenë pjesë e grupit të dytë, si UK Lezhë dhe UK Pogradec. Kjo e fundit ka një rënie krahasuar me vitin 2017 nga 23.82 orë ujë në ditë në 21 orë ujë në ditë. Shoqëria me performancën më të mirë është UK Korçë me 23.50 orë furnizim me ujë në ditë.

Tabela 25 paraqet ecurinë e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë për Grupin e I-rë të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 25. Ecuria e Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë për Grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2016 (orë/ditë)	2017 (orë/ditë)	2018 (orë/ditë)	Ndryshim 2018-2017 (orë/ditë)
UK	Berat - Kuçovë	8.88	7.36	14.30	6.94
UK	Durrës	3.56	3.01	5.08	2.07
UK	Vlorë	11.97	11.10	12.30	1.20
UK	Lezhë	20.14	20.66	21.30	0.64
UK	Lushnje	5.00	6.86	7.40	0.54
UK	Shkodër	21.39	20.14	20.40	0.26
UK	Fier	20.96	19.49	19.70	0.21
UK	Elbasan	11.84	11.58	11.50	0.08
UK	Tiranë	10.83	10.20	10.10	0.10
UK	Korçë	24.00	23.72	23.50	0.22
UK	Kamëz	4.11	4.30	4.00	0.30
UK	Pogradec	23.72	23.82	21.00	2.82
UK	Sarandë	8.00	12.20	9.00	3.20
UK	Kavajë	9.24	9.29	6.00	3.29

Rënie më të dukshme të këtij treguesi krahasuar me vitin 2017 e kanë shoqëritë UK Pogradec me 2.82 orë/ditë, UK Kavajë me rënie prej 3.29 ore/ditë, të dy për shkak të marrjes së zonave të reja, si dhe UK Sarandë me rënie 3.2 orë/ditë për shkak të saktisimit të të dhënave.

Shoqëritë e Grupit të I-rë mbulojnë me shërbim pjesën më të madhe të popullsisë në vend dhe duhet ta kenë prioritet përmirësimin e shërbimit tek konsumatori që është kohëzgjatja e furnizimit me ujë. Duke krahasuar të dhënat e raportuara në vitin 2018 me raportimet e vitit 2017 shihet se nga 14 shoqëritë e këtij grupi 7 kanë performuar mirë pasi kanë pësuar përmirësim të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë. Shoqëria me performancë më të dobët për arsye objektive të nevojës për investime për shtrirje rrjeti dhe shtim prurjeje është UK Kamëz me furnizim me ujë 4 orë /ditë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 17 jep grafikisht Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë për Grupin e II-të të shoqërive UK




Figura 17. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e II-të, Viti 2018

Gjatë vitit 2018 në këtë grup bëjnë pjesë 29 shoqëri, nga të cilat paraqitet me performancë më të mirë shoqëria UK Tepelenë me kohezgjatje të furnizimit me ujë për konsumatorët 24 orë/ditë. Shoqëria UK Librazhd e cila e ka patur këtë tregues dy vitet e fundit me 24 orë/ditë, gjatë vitit 2018 ka pësuar një rënie të lehtë me 0.3 orë /ditë, por gjithsesi është shoqëri që ofron cilësi të lartë të shërbimeve të furnizimit me ujë.

Nga grafiku vërehet se janë 6 shoqëri të klasifikuara me performancë të mirë për këtë tregues, përkatësisht, UK Tepelenë 24 orë/ditë, UK Librazhd 23.7 orë/ditë, UK Devoll 22.79 orë/ditë, U Gramsh 22.50 orë/ditë, UK Devoll 20.1 orë/ditë, UK Mat 19.3 orë/ditë dhe UK Himarë 19.1 orë/ditë.

Gjithashtu, këtë vit pjesë e këtij grupi janë bërë 3 (tre) shoqëri UK Vorë, UK Bulqizë dhe UK Dropull (shoqëri e re e licencuar në vitin 2018) që kanë qenë në Grupin e III-të.

Tabela 26 paraqet ecurinë e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë për Grupin e II-të të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 26. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (orë/ditë)	2017 (orë/ditë)	2018 (orë/ditë)	Ndryshim 2018-2017 (orë/ditë)
U	Bulqizë	7.40	6.95	13.10	6.15
U	Përmet	15.81	12.32	17.40	5.08
UK	Gjirokastër	3.44	12.60	17.30	4.70
UK	Dropull			4.60	4.60
UK	Himarë	15.08	15.16	19.10	3.94
UK	Cërrik		14.60	17.20	2.60
UK	Tepelenë	22.44	21.70	24.00	2.30
UK	Mat	22.93	17.16	19.30	2.14
UK	Belsh	11.18	9.41	11.10	1.69
U	Gramsh	20.19	21.25	22.50	1.25
U	Selenicë	5.36	4.99	6.20	1.21
UK	Vau i Dejës	8.72	9.97	10.90	0.93
UK	Skrapar	7.08	7.51	8.40	0.89
UK	Ura Vajgurore	5.59	6.29	6.60	0.31
UK	Peqin	11.56	13.94	13.90	0.04
UK	Rrogozhinë	10.85	9.46	9.20	0.26
UK	Kurbin	4.84	4.00	3.70	0.30
UK	Librazhd	24.00	24.00	23.70	0.30
UK	Patos	7.08	8.67	8.30	0.37
UK	Divjakë	4.82	3.9	3.40	0.50
UK	Roskovec		3.99	3.40	0.59
UK	Kukës	10.83	8.70	8.10	0.60
UK	Mallakastër	13.37	9.43	7.40	2.03
UK	Krujë	4.56	8.92	6.60	2.32
UK	Dibër	7.83	10.52	8.00	2.52
UK	Maliq	14.68	14.25	11.70	2.55
UK	Devoll	24.00	22.79	20.10	2.69
UK	Malësi e Madhe	13.15	11.59	8.80	2.79
UK	Vorë		8.09	5.30	2.79

Në këtë Grup 14 shoqëri kanë raportuar rritje të këtij treguesi nga 0.31 në 6.15 orë ujë në ditë. Përmirësimin më të mirë të këtij treguesi krahasuar me vitin 2017 e ka patur UK Bulqizë me 6.15 orë/ditë. UK Dropull është shoqëri që raporton për herë të parë pasi është shoqëri e re e licencuar gjatë vitit 2018 e krijuar sipas reformës administrative.

Në Grupin e dytë përkeqsim të kohëzgjatjes së furnizimit kanë raportuar 7 shoqëri, përkatësisht UK Mallakastër me 2.03 orë/ditë, UK Krujë me 2.32 orë/ditë, UK Dibër me 2.52 orë/ditë, UK Maliq me 2.55 orë/ditë, UK Malësi e Madhe me 2.79 orë/ditë, UK Vorë me 2.79 orë/ditë dhe UK Devoll me 2.69 orë/ditë. Gjithsesi shoqëria UK Devoll mbetet ndër shoqëritë me performancë të mirë me furnizim me ujë prej 20.1 orë/ditë.

Nën kufirin e performancës së dobët nën nivelin e furnizimit me ujë deri në 8 orë/ditë janë 9 (nëntë) shoqëri. Shoqëritë me performancë më të dobët me nën 4 orë/ditë furnizim me ujë mbeten UK Kurbin,

UK Roskovec, UK Divjakë të cilat pretendojnë përmirësimin e këtij treguesi me alokimin e forndeve për investime për shkak të gjendjes mjaft të amortizuara të aseteve.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 18 jep grafikisht Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 18. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të, Viti 2018

Në Grupin e III-të për vitin 2018 klasifikohen 13 shoqëri nga 11 që ishin në vitin 2017. Në këtë grup janë shtuar 2 shoqëri të reja përkatësisht, UK Konispol që raporton për herë të parë dhe UK Finiq, e cila nuk ka raportuar për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018, në këtë grup nuk ka asnjë shoqëri që të ofrojë furnizim me ujë pa ndërprerje prej 24 orë/ditë. Shoqëria me performancën më të mirë është UK Fushë Arrëz me 23.30 orë/ditë, duke u ndjekur nga UK Tropojë, UK Konispol dhe UK Pukë që janë mbi kufijtë e performancës së mirë me kohëzgjatje të furnizimit me ujë mbi 18 orë/ditë. Në nivelin e performancës së kënaqshme me kohëzgjatje të furnizimit me ujë nga 8 orë/ditë në 18 orë/ditë janë 5 shoqëri ndërsa nën kufirin e furnizimit me ujë 8 orë/ditë janë 3 shoqëri: UK Këlcyrë, UK Has dhe UK Delvinë.

Tabela 27 paraqet ecurinë e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 27 Ecuria e Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2016 (orë/ditë)	2017 (orë/ditë)	2018 (orë/ditë)	Ndryshim 2018-2017 (orë/ditë)
UK	Konispol			22.30	22.30
UK	Tropojë	12.56	9.74	22.50	12.76
UK	Fushë Arrëz	14.33	16.00	23.30	7.30
UK	Pukë	23.90	17.89	21.90	4.01
UK	Kolonjë	15.98	8.77	12.10	3.33
UK	Pustec		6.91	8.10	1.19
UK	Libohovë	7.97	15.30	16.10	0.80
UK	Has	7.42	7.52	7.70	0.18
UK	Këlcyrë	6.04	5.68	5.60	0.08
UK	Mirditë	15.50	16.14	15.60	0.54
UK	Delvinë	7.84	7.58	7.00	0.58
UK	Poliçan	11.73	15.98	15.30	0.68

Për shoqëritë e këtij grupi përmirësim të dukshëm të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë krahasuar me vitin 2017 kanë patur përkatësisht shoqëritë UK Tropojë me 12.76 orë/ditë, UK Fushë – Arrëz me 7.3 orë/ditë, UK Pukë me 4.01 orë/ditë dhe UK Kolonjë me 3.33 orë/ditë.

Përkeqësim të këtij treguesi me më pak se 1 orë/ditë krahasuar me vitin 2017, siç vërehet dhe nga tabela e mësipërme, kanë pësuar 3 shoqëri UK Mirditë, UK Delvinë dhe UK Poliçan. Shoqëria me performancë më të keqe për këtë grup mbetet edhe për këtë vit UK Këlcyra me furnizim me ujë 5.6 orë/ditë.

Përfundime

Analiza e tre Grupeve tregon se mesatarja e orëve të furnizimit me ujë, për vitin 2018, për konsumatorët është 12.8 orë/ditë, tregues i cili prej vitesh vazhdon të mbetet pothuajse në të njëjtin nivel. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për vitin 2018 vazhdon të qëndrojë shumë larg realizimit të objektivit të performancës së mirë përcaktuar nga ERRU 18 orë/ ditë. Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 3.4-24 orë/ditë. Shoqëritë që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur për vitin 2018 janë vetëm UK Tepelenë me 24 orë/ditë, UK Librazhd dhe UK Korçë pothuajse në nivelin maksimal të shërbimit.

Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm me ujë nga rrjeti shpërndarës është kompesuar nga ana e konsumatorëve me vendosjen e depozitave, një praktikë që duhet të marrë fund sepse furnizimi me ujë nga depozitat individuale përbën rrezik potencial për shëndetin e popullsisë.

Shoqëritë UK duhet të perpiqen më shumë për përmirësimin e këtij treguesi dhe arritjen e objektivave, pasi arritja e niveleve të pranueshme të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë nga ana e shoqërive mund të arrihet edhe me manaxhim me të mirë dhe me profesionalizëm, krahas përpjekjeve për të siguruar projekte për përmirësimin e gjendjes fizike kryesisht të rrjeteve shpërndarëse.

Orientimi afatshkurtër i qeverisë qendrore është sigurimi i furnizimit me ujë të të gjithë zonës bregdetare, si zonë me kërkesë të lartë të cilësisë së shërbimeve për turizimin dhe plazhet, si një burim ekonomik mjaft i rëndësishëm për vendin.

Përmirësimi i këtij treguesi është i lidhur ngushtë dhe me tregues të tjerë si Niveli i Matjes dhe Uji pa të ardhura. Vendosja nga shoqëria e prioritetëve për rritjen e nivelit të matjes duke mbuluar 100% të konsumatorëve me matësa, dhe ndjekja e planeve të veprimit për zvoglimin e humbjeve (kryesisht reduktimin e humbjeve administrative) do të ishin faktorë të rëndësishëm që do të kontribonin në përmirësimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë.

Nga ana tjetër shoqëritë duhet të stimulojnë studime për vlerësimin e saktë të kërkesës për ujë, si për zonën urbane dhe ato rurale, në mënyrë që të planifikojnë rrugët për shtimin e sasisë (prurjeve) të ujit në zonën e tyre të shërbimit, si dhe sigurimin e fondeve për zbatimin e tyre.

2.3.8 Mbulimi me Kanalizime

Treguesi i Mbulimit me Kanalizime të Ujrave të Ndotura është raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK. Shoqëritë të cilat ofrojnë këtë shërbim arrijnë të mbulojnë në nivel kombëtar mesatarisht 52.2 % të popullsisë.

Viti 2019 ka shënuar një tendencë në rënie për këtë tregues. Kjo ka ardhur si pasojë e reformës territoriale ku shoqëritë kanë përfshirë në zonën e tyre të shërbimit edhe zonat rurale, të cilat përgjithësisht nuk kanë rrjete të grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura.

Ky sektor vazhdon të vuaj mungesën e investimeve të mjaftueshme, sepse në fakt investimet nga qeveria qendrore dhe donatorët vitet e fundit kanë qenë më shumë të orientuara në drejtim të furnizimit me ujë. Ky diferencim ka ekzistuar gjithashtu edhe midis zonave urbane dhe rurale, më prioritet kanë patur zonat urbane prandaj dhe treguesi i mbulimit për të dyja shërbimet është më i lartë në zonat urbane.

Që shërbimi me kanalizime të jetë më cilësorë nevojitet që të kenë impiante të trajtimit të ujërave të ndotur. Për vitin 2018 treguesi i mbulimit me ITUN është 11.4 %, me një rritje prej 0.95 % krahasuar me vitin 2017 ku ky tregues ka qënë 10.45 %.

Orientimi kryesor i investimeve për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura ka qenë zona turistike bregdetare për mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e cilësisë së ujërave të plazheve. Trajtimi në zonën bregdetare realizohet kryesisht nga shoqëritë e licencuara UK Durrës, UK Kavajë, UK Lezhë, UK Sarandë dhe UK Shkodër. Gjithashtu jashtë zonës bregdetare janë në eficienë të plotë dhe operohen nga shoqëritë e licensuara UK Korçë dhe UK Pogradec.

Gjithsesi mbetet domosdoshmëri ndërtimi i impianteve të reja për të garantuar një mjedis të shëndetshëm në të gjithë territorin e vendit, si dhe rritja e kapaciteteve të stafeve që operojnë impiantet ekzistues.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2018

Figura 19 jep grafikisht treguesin e Mbulimit me Kanalizime për Grupin e I-rë të shoqërive UK




Figura 19. Mbulimi me Kanalizime për grupin e I-rë, Viti 2018

Në Grupin e I-rë të shoqërive, mbi kufirin 75% të performancës së mirë përformojnë 3 shoqëri, përkatësisht UK Sarandë (90%), UK Tiranë (89%) dhe UK Korçë (75%). UK Kamëz ka raportuar në AKUM 100% të këtij treguesi, por nga verifikimet rezulton që kjo shoqëri i shërben vetëm 38% të popullsisë, pra klasifikohet në shoqëritë me performancë të dobët të këtij shërbimi. Shoqëri të tjera që kanë performuar dobët gjatë vitit 2018 për treguesin e Mbulimit me Kanalizime (nën 50%) janë UK Shkodër (43%), UK Fier me (38%), UK Kavajë (34%) dhe UK Lushnje (32%).

Përkeqsimin me të lartë të treguesit në shoqëritë e klasifikuara me performancë të mirë kanë raportuar UK Pogradec me (19.96%) duke çuar mbulimin me kanalizime në nivelin prej (54%) dhe UK Lezhë me (14.54%) duke e çuar mbulimin në (64%), pra nën nivelin e performancës së mirë prej (75%). Rënia e këtij treguesi për disa shoqëri, ka ardhur si shkak i zgjerimit të zonave të juridiksionit me disa njësi të reja administrative.

Me performancë të pranueshme kanë paraqitur përmirësim të këtij treguesi 4 shoqëri, përkatësisht UK Durrës (54%), UK Vlorë (60%), UK Berat-Kuçovë (64%) dhe UK Elbasan (64%). Përmirësimi i treguesit ka ardhur si rrjedhojë e investimeve fizike në infrastrukturën e kanalizimeve të ujrave të ndotura.

Shoqëritë me performancë të dobët të treguesit të Mbulimit me Kanalizime nën (50%) mbeten përkatësisht UK Shkodër, UK Fier, UK Lushnje dhe UK Kavajë. Kjo e fundit ka një rritje më të ndjeshme të treguesit me (8.28 %) krahasuar me vitin 2017, por që sërish treguesi i mbulimit mbetet në nivele shumë të ulëta në nivelin prej (34 %).

Tabela 28 paraqet ecurinë e treguesit të Mbulimit me Kanalizime për Grupin e I-rë të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 28 .Ecuria e Mbulimit me Kanalizime për Grupin I-të 2018

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Kavajë	24.70	25.72	34.00	8.28
UK	Vlorë	54.27	54.27	60.00	5.73
UK	Sarandë	75.52	84.76	90.00	5.24
UK	Tiranë	89.03	83.80	89.00	5.20
UK	Lushnje	48.03	27.22	32.00	4.78
UK	Durrës	48.85	49.87	53.00	3.13
UK	Berat - Kuçovë	50.63	60.15	63.00	2.85
UK	Elbasan	47.02	60.17	63.00	2.83
UK	Shkodër	42.51	40.95	43.00	2.05
UK	Kamëz		99.93	100.00	0.07
UK	Korçë	76.89	75.52	75.00	0.52
UK	Fier	38.67	38.67	38.00	0.67
UK	Lezhë	86.53	78.54	64.00	14.54
UK	Pogradec	77.71	73.96	54.00	19.96

Grupi i II-të i Shoqërive

Në Grupin e II-të në total nga 29 shoqëri 25 prej tyre ofrojnë edhe shërbimet e kanalizimeve krahas atyre të furnizimit me ujë, ndërsa 4 të tjerat ofrojnë vetëm shërbimet e furnizimit me ujë. Nga këto 25 shoqëri, vetëm 13 prej tyre do të merren në analizë pasi 7 shoqëri kanë raportuar vetëm për vitin 2018 ndërsa pjesa tjetër nuk ka bërë raportime pranë AKUM.

Performanca për Vitin 2018

Figura 20 jep grafikisht treguesin e Mbulimit me Kanalizime për Grupin e II-të të shoqërive UK




Figura 20. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e II-të, Viti 2018

Nga grafiku rezulton që mbi nivelin e performancës së mirë me tregues mbi kufirin 75%, është vetëm UK Tepelenë me 86 % mbulimin me kanalizime. UK Mat është mes dy kufijve të nivelit të mirë dhe nivelit të dobët me mbulim 65 %, ndërsa 11 shoqëritë e tjera përformojnë nën kufirin 50% që i përket performancës së dobët.

Për vitin 2018 rënie të theksuar të mbulimit me kanalizime kanë raportuar 4 shoqëri, UK Gjirokastrë me rënie (54.47%) duke bërë që ky tregues të shkojë në (10 %) mbulim me kanalizime, UK Mat me rënie (14.32 %) duke zbritur këtë tregues në (65 %), UK Krujë me rënie (9.13%) duke zbritur këtë tregues në (28 %), dhe UK Kukës me rënie (7%) që e çon këtë tregues në (38%), ndërsa rasti i performancës me (10%) të UK Gjirokastrë ka rezultuar nga një pakujdesi e raportimit pranë AKUM për këtë tregues.

E njëjta arsye është dhe për UK Kukës ku raportimet janë të pasakta pasi është marrë numri i popullsisë njëherë sipas gjendjes civile njëherë sipas Censurit. Ndërsa për dy shoqëritë e tjera UK Mat dhe UK Krujë ky tregues ka rënie si shkak i marrjes së zonave të reja.

Ky grup në përgjithësi ka përformuar dobët pasi rritje të mbulimit me kanalizime shihet të ketë raportuar vetëm UK Vorë me (9.03 %) duke çuar mbulimin me kanalizime në (44 %) e cila përsëri mbetet nën kufirin (50%) të performancës së dobët.

Tabela 29 paraqet ecurinë e treguesit të Mbulimit me Kanalizime për Grupin e II-të të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 29. Ecuria e Mbulimit me Kanalizime për Grupin II-të 2018

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Kurbin			37.00	37.00
UK	Cërrik			27.00	27.00
UK	Ura Vajgurore			25.00	25.00
UK	Maliq			24.00	24.00
UK	Roskovec			17.00	17.00
UK	Belsh			10.00	10.00
UK	Vorë		34.97	44.00	9.03
UK	Patos	31.89	34.54	36.00	1.46
UK	Dropull			1.00	1.00
UK	Skrapar	39.42	39.23	40.00	0.77
UK	Librazhd	20.12	20.27	21.00	0.73
UK	Himarë	23.81	23.81	24.00	0.19
UK	Malësi e Madhe	13.11			0.00
UK	Mallakastër	22.10	22.09	22.00	0.09
UK	Dibër	39.09	41.23	41.00	0.23
UK	Tepelenë	48.14	86.29	86.00	0.29
UK	Rrogozhinë	15.74	11.38	8.00	3.38
UK	Kukës	56.25	45.00	38.00	7.00
UK	Krujë	20.37	37.13	28.00	9.13
UK	Mat	79.32	79.32	65.00	14.32
UK	Gjirokastër	64.02	64.47	10.00	54.47

Siç shihet nga Tabela 29, ky sektor mbetet me të vërtetë problematik, përmirësimi i të cilit kërkon investime mjaft të mëdha, që krahas atyre që mund të mbulojnë kryesisht nga qeveria qendrore, kërkohet të tërhiqet një vëmendje e veçantë nga kontributet e donatorëve.

Grupi i III-të i Shoqërive

Në Grupin e III-të vetëm 8 shoqëri kanë raportuar të dhëna për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura, por që në analizë do merren 6 prej tyre pasi dy shoqëri UK Poliçan dhe UK Tropojë kanë raportime vetëm për vitin 2018, vit i cili përkon me marrjen e këtij shërbimi nga shoqëritë respektive, ndërsa 5 shoqëritë e tjera nuk kanë raportuar të dhëna për kanalizimet. Nga 6 shoqëritë që merren në analizë shihet se vetëm UK Kolonjë është mbi nivelin e performancës së mirë mbi (75 %) ndërsa 5 shoqëritë e tjera përformojnë nën kufirin e performancës së dobët prej (50 %).

Performanca për vitin 2018

Figura 21 jep grafikisht treguesin e Mbulimit me Kanalizime për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 21. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2018

Nga grafiku vërehet se rënie të këtij treguesi ka paraqitur UK Kolonjë ku për 2 vite rradhazi ka raportuar (100%) mbulimin me kanalizime ndërsa për vitin 2018 ka një rënie me (18 %) duke bërë që ky tregues të zbresë në 82 %. UK Pukë raporton një përkeqsim të këtij treguesi me (27.73%) duke bërë që mbulimi me kanalizime të bjerë në (16 %). Për të dy shoqëritë shkak i rënies së këtij treguesi është përfshirja e zonave të reja rurale në zonën e tyre të shërbimit. Tendencë në përmirësim të këtij treguesi pothuajse nuk paraqet asnjë shoqëri e këtij grupi.

Tabela 30 paraqet ecurinë e treguesit të Mbulimit me Kanalizime për Grupin e II-të të shoqërive për të tre vitet e fundit.

Tabela 30. Ecuria e Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2018

Aktiviteti	Operatori	2016 (%)	2017 (%)	2018 (%)	Ndryshimi 2018-2017 (%)
UK	Poliçan			80.00	80.00
UK	Tropojë			44.00	44.00
UK	Mirditë	67.58	38.93	40.00	1.07
UK	Fushë Arrëz	32.48	32.48	33.00	0.52
UK	Delvinë	38.69	38.69	39.00	0.31
UK	Pustec		24.09	23.00	1.09
UK	Kolonjë	100.00	100.00	82.00	18.00
UK	Bashkia Pukë	43.09	43.73	16.00	27.73

Përfundime

Përgjithësisht, vërehet një tendencë nga shoqëritë UK që të drejtojnë vëmendjen kryesore tek shërbimet e furnizimit me ujë duke nënvlerësuar shërbimet e kanalizimeve të ujërave të ndotura, praktikë e cila nuk duhet të vazhdojë më tej dhe t'i kushtojnë këtij sektori vëmendjen e duhur. Sektori kanalizimeve duhet të konsiderohet si mjaft i rëndësishëm jo vetëm për zonat turistike në veçanti, por për të gjithë mjedisin e vendit në përgjithsi e që lidhet direkt me impakt në shëndetin publik.

Nga analiza për të tre Grupet e shoqërive shihet se në vendin tonë 7 shoqëri arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi (75%) të popullsisë në zonën e juridiksionit, por UK Kamëz nuk merret parasysh pasi kanë bërë raportim të pasaktë dhe mbulimin me kanalizime e kanë (38%) dhe jo (100%) që raportojnë. Në këto kushte mbeten vetëm 6 shoqëri me shërbim mbi nivelin e performancë së mirë, përkatësisht, shoqëritë UK Sarandë, UK Tiranë, UK, Korçë, UK Tepelenë, UK Kolonjë dhe UK Poliçan që raportojnë për këtë tregues në përputhje me zonën e re të shërbimit pas riorganizimit të tyre në kufijtë administrativë të bashkisë.

Më tej siç konstatohet nga grafiku, 7 shoqëri performojnë mes nivelit të dobët (50%) dhe të mirë (75%), ndërsa shoqëritë e tjera arrijnë të mbulojnë me shërbim një përqindje të ulët të popullsisë në juridiksion. Përqindja me mbulim në rang vendi për këtë vit është (52%) me një përmirësim prej vetëm prej (1.9%).

Nga (52%) mbulim me shërbim të kanalizimeve në rang vendi, shihet që (46%) ju ofrohet shërbim zonave urbane dhe vetëm 6 % është për zonat rurale.

Ky tregues nuk duhet parë thjesht si rritje e përqindjes për t'u barazuar me treguesin e mbulimit të Furnizimit me ujë, sepse në zonat rurale kjo përgjithsisht nuk ka sens nga ana ekonomike. Për zonën rurale duhet të rritet vëmendja nga shoqëritë UK që të respektohen kushtet teknike të sistemeve individuale të shkarkimit të ujërave të ndotura me gropa septike. Në përmbushje edhe të kërkesave për mbrojtjen e mjedisit këto sisteme nuk duhet të përbëjnë vetëm sisteme grumbullimi të ujërave të ndotura, por edhe trajtimin e tyre. Shoqëritë UK duhet të përfshijnë në aktivitetin dhe kontratat me konsumatorët edhe këto sisteme kryesisht për kontrollin dhe mbikqyrjen e tyre, si dhe largimin e llumrave në mënyre periodike prej tyre.

Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve duhet të jetë një nga sfidat kryesore për të gjitha shoqëritë UK të cilat gjatë hartimit të planeve të biznesit, krahas investimeve për mbulimin me ujë, duhet të planifikojnë edhe investime dhe të vendosin objektiva për rritjen e këtij treguesi.

Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 8 shoqëri UK Durrës, UK Kavajë, UK Korçë, UK Pogradec, UK Shkodër, UK Sarandës, UK Vlorë (Impianti i Orikumit) dhe UK Lezhë. Është në ndërtim e sipër impianti i trajtimit të ujërave të ndotura për Tiranën, i cili jo vetëm do të rrisë këtë tregues në përputhje edhe me Direktivat Europiane për Ujrat e Ndotura, por do të përmirësojë kushtet e mjedisit për të gjithë popullsinë e kryeqytetit të vendit.

ERRU, si rregullator i sektorit UK, e sheh të domosdoshme prioritetin e qeverisë për reformën në sektorin UK dhe duke patur në fokus rritjen e performancës së shoqërive, punën e tyre për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor të sektorit duke patur në vëmendje direktivat kryesore të BE-së mbi mjedisin.

ERRU do të rrisë kërkesat e saj për monitorimin e sektorit, si dhe të vlerësimit të komponentëve të kanalizimeve të ujërave të ndotura kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja. Kërkesa e parë në këtë

drejtim është që shoqëritë të mbajnë kosto të ndara veç për shërbimet e furnizimit me ujë dhe veç për shërbimet e kanalizimeve. Elemente të reja për vlerësimin e tyre do të jenë pjesë e metodologjisë së vendosjes së tarifave.

Nga ana tjetër, ERRU rekomandon që të gjitha shoqëritë UK t'u japin përparësi zonave të reja të cilat janë përfshirë së fundmi në juridiksionin e tyre duke i bërë pjesë në planet e investimeve dhe zhvillimeve të reja që ato do të ndërmarrin në planet e tyre të biznesit.

3 Konkluzione

- Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK duhet të forcojnë angazhimin e tyre për të përfunduar procesin e riorganizimit sipas reformës me regjistrimin e asetëve dhe hapat e tjerë burokratike të domosdoshme.
- Shoqëritë duhet të kenë në vëmendje të tyre menaxhimin e asetëve, identifikimi dhe hartimi i planeve për menaxhimin e tyre mundëson jo vetëm një menaxhim më të mirë të aktiveve fikse, por për hartimin e planeve për uljen e humbjeve teknike dhe administrative në sistemet e furnizimit me ujë.
- Duke pasur parasysh deficitin financiar të operimit të sektorit UK dhe nevojës për subvencione, për shëndoshjen financiare të sektorit vëmendja kryesore duhet fokusuar në problematikat individuale të shoqërive, duke analizuar performancën e tyre, mundësitë për përmirësim e në fund në orientimin e drejtë të subvencioneve deri sa shoqëritë të bëhen të qëndrueshme nga ana financiare.
- Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK. Shoqëritë duhet të nxiten dhe të mbështeten nga qeveria qendrore që të instalojnë matës si në burim ashtu edhe në pikat e konsumit në mënyrë që të hartohen bilance të sakta të ujit, si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi tyre si një prerogativë ligjore kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja. AKUM të vlerësojë nevojat dhe të incetivojë financimin e hartimit të tyre nga qeveria qendrore dhe donatorët për shoqëritë që kanë mundësi financiare të kufizuara.
- Të rivlerësohet situata për konceptimin e ligjit të ri të sektorit UK si një ligj ku presupozohet përfshirja në një dokument të vetëm e gjithë legjislacionit aktual dhe nënakteve të tij, që e bën atë mjaft të rënduar për t'ju përgjigjur dinamizmit që kërkojnë mjaft pjesë të tij. Rekomandohet mbajtja e tij në kornizat e ligjit aktual nr. 8102 për rregullimin e sektorit i propozuar për t'u rishikuar dhe të trajtohen si nënakte më vete Kodi i Ujit (ka nevojë urgjente për tu rishikuar), si dhe legjislacioni për Akt Miratimin Higjieno Sanitar që lëshon Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, i cili ka mjaft mangësi praktike për realizimin e tij.
- Të analizohen thellësisht elementët bazë të qasjes së re si strategji për përmirësimin e performancës së sektorit në aspektet praktikore ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta.
- ERRU rekomandohet të përfshihet në procesin e përcaktimit të prioriteteve të investimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, si dhe në aprovimin e tyre bazuar në kritere tekniko ekonomike.
- Të thellohet vlerësimi i elementeve të përbalueshmërisë së tarifave nga ERRU në bashkëpunim me

INSTAT, si kriteri përfundimtar verifikues i mbulimit të kostove të shërbimeve nga fatura e konsumatorëve. Nisur nga ky kriter ERRU duhet të vlerësojë dhe të klasifikojë veç ato shoqëri shëndoshja financiare e të cilave kërkon tarifa mjaft të larta të papërbalueshme për konsumatorët dhe që duhet të subvencionohen nga qeveria qendrore apo vendore.

- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve.
- Sektori paraqitet mjaft i fragmentarizuar prandaj ndihet e nevojshme që qeveria qendrore të shoh si prioritet të afërt fillimin e realizimit të strategjisë së agregimit të shoqërive me një ose dy projekte pilot, aty ku shihet më i mundshëm suksesi, duke respektuar kriteret e vullnetit të lirë të pronarëve si dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Strategjia e agregimit të sektorit duhet të orientohet kryesisht në grupin e shoqërive të dimensionit të mesëm, rast pas rasti dhe jo në bllok.

4 Tema e Veçantë : Platforma e Data Baze për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë UK

Gjatë vitit 2018 dhe në vijim, ERRU i ka kushtuar vëmendje forcimit të rolit të tij monitorues për sektorin duke e konsideruar atë si një element shumë të rëndësishëm kur shoqëritë UK aplikojnë për tarifa. Për këtë është shumë i rëndësishëm fakti që bazë e të dhënave operacionale të shoqërive, raportimi, depozitimi dhe përpunimi i tyre të behet në ERRU. Deri tani kjo praktikë është realizuar tek AKUM, nga ku ERRU merr të dhëna për të hartuar raportin e performancës vjetore të sektorit dhe duhet t'i quajë ato të "mirëqena" gjatë analizës së aplikimeve të shoqërive për tarifa të reja.

Në këtë kuadër ERRU ka marrë kështu iniciativën për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave (data baze) për të gjitha shoqëritë e UK dhe në të njëjtën kohe, duke forcuar përgjegjësinë e saj për monitorimin sa më të saktë dhe pranë realitetit të shoqërive UK që operojnë në sektor.

Kjo iniciativë lindi si një nevojë për të mënjanuar problematikat e vazhdueshme që ERRU ka patur në vite për varësinë e të dhënave të marra nga drejtoria e monitorimit të benchmarkut pranë AKUM të cilat janë përdorur si bazë për hartimin e Raportit Vjetor të Performancës së shoqërive UK, si dhe për të minimizuar problemin kronik të vërtetësisë dhe pasaktësisë së të dhënave që jo rrallë ka influencuar në arritjen e konkluzioneve jo të drejta për përmirësimin e performancës së sektorit.

Pajisja e ERRU-së me bazën e saj të të dhënave dhe benchmarkut është bazuar në kompetencat që i jep ligji 8102 që ngarkon ERRU-në për monitorimin e shoqërive që operojnë në Sektorin Ujësjetës Kanalizime.

Data baze është orientuar në sensin praktik për të mos e ngarkuar me të dhëna që për momentin mund të jenë të tepërta për sektorin e UK dhe nuk i shërbejnë qëllimit për të patur një data baze efikase dhe me të dhëna sa më të sakta.

Numri i dhënave të përcaktuara konsiderohet si minimum i domosdoshëm për analizën e aplikimeve për tarifa të reja, për benchmarkun e shoqërive bazuar në llogaritjen e Treguesve Kryesore të Performancës,

si dhe për përgatitjen e Raportit Vjetor të Performancës. Forma e saj e zhvilluar në Excel është e thjeshtë në përdorim, dhe mjaft elastike për ta përshtatur atë me kërkesat e sektorit në të ardhmen.

Modeli në Excel për data baze është konceptuar i ndarë në sete të veçanta për secilin lloj të shërbimeve që ofrojnë shoqëritë në sektor dhe që janë të sanksionuara në licencën e tyre, përkatësisht:

Kategoria A, Grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik (U)

Kategoria B, Përpunimi i ujit për konsum publik (ITUP)

Kategoria C, Grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura (K)

Kategoria D, Përpunimi i ujërave të ndotura (ITUN)

Pra, në totalin e shoqërive që ofrojnë shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në vendin tonë (57 shoqëri), janë 4 shoqëri që ofrojnë vetëm shërbimin (U), 47 shoqëri që ofrojnë shërbimet (U+K), 7 shoqëri me (U+K+ITUN), dhe së fundi 2 shoqëri që ofrojnë shërbimet (U+K+ITUN+ITUP).

Modeli në Excel për data baze është konceptuar i ndarë për secilën natyrë të shoqërive të përshkruara më sipër. Data baze që duhet të plotësohet është i veçantë për shoqëritë sipas kategorisë së licencës së tyre, kjo për të mos krijuar konfuzion tek shoqëritë mbi plotësimin e të dhënave për shërbime që nuk i ofrojnë. Platforma në Excel ka një dimension të vogël lehtësisht i dërgueshëm me e-mail.

Platforma në Excel jepet në tabelën 38 Aneks 8.

Për disa të dhëna të veçanta është parë e nevojshme që të jepen sqarime për plotësimin e tyre me anë të një Udhëzuesi që është pjesë integrale e Modelit në Excel.

Modeli në Excel i data baze është instaluar paraprakisht, me shpjegimet përkatëse në 11 shoqëri sipas listës së mëposhtme për të dhënë komentet dhe rekomandimet e tyre për ti përfshirë në draftin final të Modelit, që të bëhet pjesë integrale e formës së raportimit të të dhënave të të gjithë shoqërive UK në vendin tonë duke filluar nga viti 2019 e në vazhdim. Raportimi nga shoqëritë në ERRU është menduar që të bëhet 2 herë në vit (1 raportim 6 mujor dhe një raportim vjetor), që dërgohet me e-mail.

Lista e Shoqërive për komente të Modelit data basë të dërguar:

1. Tiranë	U+K+ITUP+(ITUN)	(ITUN në ndërtim)
2. Durrës	U+K+ITUN	
3. Korçë	U+K+ITUN	
4. Lezhe	U+K+ITUN	
5. Fier	U+K	
6. Librazhd- Përrenjas	U+K	(sistemi FU me vetërrjedhje)
7. Shkodër	U+K+ITUN	
8. Vau Dejës	U+K	
9. Lushnje	UK	
10. Roskovec	U+K	
11. Berat- Kuçovë	U+K	

Nga ana tjetër këtyre shoqërive iu dërgua edhe një pyetësor për çështje të veçanta që kërkohej opinioni i tyre në shërbim të efikasitetit të plotësimit dhe përdorimit të data bazës.

Përzgjedhja për dërgimin e pyetësorit këtyre shoqërive është menduar për të mbuluar gamën e katër llojeve të shërbimeve që ofrojnë shoqëritë, përkatësisht furnizim me ujë (U), kanalizime të ujërave të ndotura (U+K), trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN), dhe trajtimin e ujit për pirje (ITUP).

Pyetësi i dërguar konsistonte në pyetjet e mëposhtme:

1. A i konsideroni të mjaftueshme numrin e të dhënave të propozuara, apo duhen shtuar/reduktuar? Kush janë propozimet tuaja për shtimin/reduktimin e tyre dhe pse?
2. Data baze ka të dhëna me karakter tekniko-financiar. Të dhënat financiare përfundimisht raportohen zyrtarisht pasi del raporti i auditimit financiar në fund të muajit mars të vitit pasardhës. Në respekt të ligjit ERRU, përgatit raportin vjetor të veprimtarisë së ERRU-së dhe e dorëzon në Kuvendin e Shqipërisë brenda datës 31 janar. Pjesë e këtij raporti është edhe performanca e sektorit UK. A keni mundësi ju që të paktën brenda datës 15-janar të na dërgoni të dhëna të plota vjetore financiare, të cilat në thelb nuk do të ndryshojnë nga ato përfundimtare të auditimit?
3. Raportimi i të dhënave vjetore propozohet që të bëhet në muajin Janar të vitit në vazhdim dhe në fillim të muajit Prill, po të vitit në vazhdim. Propozohet gjithashtu një raportim 6 mujor në muajin Korrik. A jeni dakort me këtë propozim, apo keni rekomandime të tjera në lidhje me natyrën dhe frekuencën e raportimeve?
4. A i konsideroni të mjaftueshme sqarimet për zëra të veçantë që propozohen në Udhëzuesin pjesë të data bazës? Kush janë propozimet tuaja për sqarime shtesë për këto zëra dhe/ose të tjerë që ju i mendoni të nevojshme?
5. Duke patur parasysh që i gjithë procesi i raportimit të të dhënave do të shoqërohet me verifikim të vazhdueshëm të saktësisë së tyre, çfarë propozoni më tej në funksion të realizimit dhe garantimit të saktësisë së të dhënave, si një element që nuk do të tolerohet më tej nga ERRU?
6. A keni ndonjë propozim tjetër shtesë në lidhje me të gjithë procesin e hartimit të data baze, dhe zbatimin e tij në praktikë?

Për të performuar suksesshëm çdo hap i këtij procesi, ishte i nevojshëm për të përcaktuar drejt çështjet që do të trajtoheshin në fazën pilot dhe a ishin të mjaftueshme të dhënat e zgjedhura si në aspektin cilësor dhe atë sasior.

Komentet e marra nga shoqëritë kanë qenë të vlefshme dhe shumica e tyre janë përfshirë në platformën e propozuar.

ERRU është e vendosur që për vitin e ardhshëm 2019 analiza dhe publikimi i raportit të performancës së shoqërive UK të bëhet duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nga sektori i monitorimit dhe performancës pranë ERRU-së.

ERRU konsideron se mundësia e grumbullimit të të dhënave dhe kontrollit të tyre do të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen e përgjegjshmërisë nga ana e shoqërive e cila do të çojë në raportime të sakta dhe të drejta të të dhënave të raportuara nga ana e tyre.

5 Aneke: Të dhënat Kryesore të Sektorit

Tabela 31, Aneks 1. Gjendja e Riorganizimit të Sektorit për të Gjithë Shoqëritë UK

Nr.	Me Licencë		Pa Licence	
	Sipas reformës	Jo sipas reformës	Sipas reformës	Jo sipas reformës
1	Sh.a. UK Gjirokastrë	Sh.a. UK Kurbin	Sh.a. UK Pustec (në proces)	Sh.a. U Bulqizë (në proces)
2	Sh.a. UK Devoll	Sh.a. UK Sarandë	Sh.a. UK Fier (në proces)	Sh.a. UK Tiranë (në proces)
3	Sh.a. UK Lushnjë	Sh.a. UK Dibër	Sh.a. UK Elbasan (në proces)	Sh.a. U Përmet (në proces)
4	Sh.a. UK Lezhë	Sh.a. UK Durrës	Sh.a. UK Kamëz	Sh.a. U Selenicë (në proces)
5	Sh.a. UK Tepelenë	Sh.a. UK Kolonjë	Sh.a. UK Klos	Sh.a. UK Mallakastër (në proces)
6	Sh.a. UK Korçë	Sh.a. UK Has		Sh.a. UK Peqin
7	Sh.a. UK Mat	Sh.a. UK Himarë		Sh.a. UK Divjakë
8	Sh.a. UK Delvinë	Sh.a. UK Finiq		Sh.a. U Këlcyrë (në proces)
9	Sh.a. UK Berat - Kuçovë			Sh.a. UK Fushë Arrëz (në proces)
10	Sh.a. UK Patos			
11	Sh.a. UK Ura Vajgurore			
12	Sh.a. UK Librazhd			
13	Sh.a. U Gramsh			
14	Sh.a. UK Malësi e Madhe			
15	Sh.a. UK Kukës			
16	Sh.a. UK Vorë			
17	Sh.a. UK Pogradec			
18	Sh.a. UK Krujë			
19	Sh.a. UK Poliçan			
20	Sh.a. UK Vau i Dejës			
21	Sh.a. UK Belsh			
22	Sh.a. UK Maliq			
23	Sh.a. UK Cërrik			
24	Sh.a. UK Vlorë			
25	Sh.a. UK Skrapar			
26	Sh.a. UK Mirditë			
27	Sh.a. UK Roskovec			
28	Sh.a. UK Shkodër			
29	Sh.a. UK Tropojë			
30	Sh.a. UK Rrogozhinë			
31	Sh.a. UK Libohovë			
32	Sh.a. UK Kavajë			
33	Sh.a. UK Dropull			
34	Sh.a. UK Konispol			
35	Sh.a. UK Pukë			

Tabela 32, Aneksi 2. Norma e Arkëtimit Korente dhe e Pergjithshme Vitet 2017-2018

Nr	Operatori	Norma e Arkëtimit Korente		Norma e Arkëtimit e Pergjithshme	
		Viti 2017	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2018
1	Shkodër UK	65.1%	71.0%	76.3%	96.3%
2	Fushë Arrëz UK	57.7%	82.3%	57.7%	111.7%
3	Pukë UK	89.3%	72.6%	102.8%	101.5%
4	Vau Dejës UK	81.4%	76.3%	103.7%	121.5%
5	Malësi e Madhe U	54.9%	70.5%	56.3%	79.2%
6	Lezhë UK	79.6%	85.1%	85.1%	99.9%
7	Mirditë UK	69.4%	63.6%	96.2%	115.8%
8	Kurbin UK	80.5%	79.4%	83.0%	99.7%
9	Kukës UK	60.1%	71.2%	62.1%	92.0%
10	Tropojë UK	50.6%	64.0%	56.7%	126.4%
11	Has UK	76.1%	59.3%	83.3%	117.0%
12	Tiranë UK	86.2%	87.1%	97.9%	96.6%
13	Kamëz UK	78.9%	95.8%	88.2%	125.4%
14	Kavajë UK	83.0%	49.9%	101.3%	84.3%
15	Rrogozhinë UK	58.9%	62.1%	62.2%	107.5%
16	Vorë UK	64.3%	64.5%	64.3%	94.1%
17	Durrës UK	67.8%	74.3%	85.7%	96.5%
18	Krujë UK	72.8%	88.9%	79.0%	107.6%
19	Dibër UK	57.3%	48.5%	84.7%	103.3%
20	Bulqizë U	77.6%	74.6%	89.3%	103.3%
21	Mat UK	77.5%	73.9%	109.3%	102.0%
22	Bashkia Klos				
23	Elbasan UK	60.1%	63.1%	92.2%	113.9%
24	Librazhd - Përrenjas UK	97.7%	80.8%	97.7%	110.0%
25	Gramsh U	82.6%	88.0%	87.5%	137.2%
26	Cërrik UK	89.4%	75.8%	96.2%	99.8%
27	Belsh UK	72.8%	68.8%	102.1%	91.5%
28	Peqin UK	71.4%	85.8%	98.0%	104.2%
29	Korçë UK	79.9%	73.8%	96.8%	96.3%
30	Pogradec UK	85.6%	75.3%	99.7%	110.5%
31	Maliq UK	96.4%	82.4%	118.5%	99.2%
32	Pustec UK	46.5%	37.8%	50.1%	47.6%
33	Devoll UK	82.8%	62.8%	103.0%	84.8%
34	Kolonjë UK	92.4%	89.8%	99.4%	93.9%
35	Berat Kuçovë UK	85.9%	82.9%	104.5%	94.9%
36	Ura-Vajgurore U	72.0%	82.9%	77.3%	122.2%
37	Poličan UK	79.3%	79.2%	91.7%	93.9%
38	Skrapar UK	82.4%	84.2%	98.6%	120.0%
39	Fier UK	77.0%	72.4%	98.5%	100.2%
40	Lushnjë UK	70.3%	79.4%	102.1%	113.2%
41	Divjakë UK	86.8%	68.8%	86.8%	86.5%
42	Patos UK	80.3%	81.9%	91.9%	118.3%
43	Roskovec UK	43.2%	41.6%	100.7%	76.5%
44	Mallakastër UK	78.2%	63.4%	90.7%	102.0%
45	Vlorë UK	64.5%	63.3%	76.2%	85.3%
46	Selenicë U	71.7%	75.9%	71.7%	101.6%
47	Himarë UK	75.3%	72.4%	89.7%	82.9%
48	Delvinë UK	72.1%	78.3%	80.9%	101.3%
49	Sarandë UK	74.4%	79.3%	87.7%	93.9%
50	Finiq UK				
51	Konispol UK	94.8%	77.3%	94.8%	88.6%
52	Gjirokastër UK	87.4%	75.4%	103.9%	105.9%
53	Tepelenë UK	75.9%	74.1%	75.9%	117.0%
54	Këlcyrë UK	60.2%	71.3%	86.0%	100.3%
55	Përmet U	86.5%	78.9%	97.3%	102.4%
56	Libohovë UK	65.1%	69.4%	70.1%	81.8%
57	Dropull UK		68.0%		98.1%
	Totali	78.8%	79.0%	92.8%	85.1%

Tabela 34, Aneksi 4. Nevojat Reale për Subvencione për Vitin 2018 dhe Akordimi i tyre (në 000 Leke)

Operatorët	Subvencione nga QQ për O&M	Subvencione nga QQ për Performancë	Subvencione nga bashkia e të tjerë	Totali i Subvencioneve të Përfituara	Nevoja Reale për Subvencioneve për O&M	Diferenca (mbi subvencionuar)	Diferenca (nën subvencionuar)
	1	2	3	4(1+2+3)	5	6(5-4)	7(5-4)
1 Tiranë UK	-	160,641	-	160,641	-	160,641	-
2 Durrës UK	30,000	66,426	-	96,426	-	96,426	-
3 Vlorë UK	20,000	32,147	15,106	67,253	221,865	-	154,612
4 Elbasan UK	15,000	28,961	-	43,961	28,587	15,374	-
5 Fier UK	-	22,618	-	22,618	-	22,618	-
6 Shkodër UK	20,000	19,181	7,262	46,443	39,750	6,694	-
7 Korçë UK	-	20,436	106	20,542	-	20,542	-
8 Berat-Kuçovë UK	-	20,590	-	20,590	-	20,590	-
9 Kavajë UK	35,000	10,209	-	45,209	100,959	-	55,750
10 Lushnje UK	10,000	18,796	-	28,796	48,276	-	19,480
11 Sarandë UK	6,000	11,355	-	17,355	-	17,355	-
12 Pogradec UK	-	13,624	-	13,624	-	13,624	-
13 Kamëz UK	-	12,688	-	12,688	-	12,688	-
14 Lezhë UK	8,000	11,879	-	19,879	-	19,879	-
15 Gjirokastër UK	-	7,819	-	7,819	5,162	2,657	-
16 Maliq UK	7,000	7,865	-	14,865	13,099	1,766	-
17 Dibër UK	6,000	5,501	-	11,501	4,952	6,549	-
18 Devoll U	-	3,162	-	3,162	-	3,162	-
19 Kurbin UK	20,000	4,514	13,556	38,070	74,978	-	36,908
20 Cërrik UK	8,000	4,796	-	12,796	17,825	-	5,029
21 Belsh UK	7,000	4,539	-	11,539	16,625	-	5,086
22 Krujë UK	15,000	5,178	-	20,178	20,513	-	335
23 Kukës UK	-	7,331	5,000	12,331	-	12,331	-
24 Librazhd-Përrenjas UK	2,000	3,214	-	5,214	-	5,214	-
25 Mallakastër UK	10,000	5,297	-	15,297	38,022	-	22,725
26 Patos UK	50,000	4,095	-	54,095	140,012	-	85,917
27 Mat UK	-	4,872	-	4,872	-	4,872	-
28 Rrogozhinë UK	7,000	6,397	-	13,397	16,486	-	3,089
29 Gramsh U	3,000	3,545	910	7,455	-	7,455	-
30 Himarë UK	-	4,556	-	4,556	1,113	3,443	-
31 Divjakë U	6,000	3,906	1,705	11,611	13,188	-	1,577
32 Vorë UK	-	3,479	-	3,479	5,673	-	2,194
33 Përmet U	5,000	2,999	-	7,999	10,532	-	2,533
34 Malësi e Madhe UK	2,000	5,752	-	7,752	-	7,752	-
35 Tepelenë UK	6,000	2,956	-	8,956	31,394	-	22,438
36 Roskovec UK	6,000	3,119	2,220	11,339	8,026	3,313	-
37 Selenicë U	4,000	3,183	-	7,183	15,614	-	8,431
38 Ura-Vajgurore UK	10,000	3,363	-	13,363	21,396	-	8,033
39 Bulqizë U	500	2,754	7,200	10,454	-	10,454	-
40 Peqin UK	15,000	5,060	-	20,060	32,690	-	12,630
41 Vau Dejës UK	15,000	4,528	-	19,528	28,863	-	9,335
42 Dropull UK	2,000	-	2,500	4,500	6,430	-	1,930
43 Skrapar UK	7,000	2,819	-	9,819	10,330	-	511
44 Delvinë UK	2,000	2,894	-	4,894	3,232	1,662	-
45 Tropojë UK	1,000	2,123	-	3,123	2,762	361	-
46 Poliçan UK	3,000	2,285	151	5,436	9,125	-	3,689
47 Mirditë UK	8,000	3,199	-	11,199	13,226	-	2,027
48 Kolonjë UK	-	2,621	-	2,621	-	2,621	-
49 Konispol UK	5,000	2,432	-	7,432	7,870	-	438
50 Pukë UK	2,000	746	-	2,746	170	2,576	-
51 Këlcyrë U	5,000	864	-	5,864	6,842	-	978
52 Has UK	8,000	1,212	-	9,212	9,822	-	610
53 Libohovë UK	4,000	1,254	365	5,619	9,499	-	3,880
54 Pustec UK	1,500	360	2,015	3,875	2,438	1,436	-
55 Fushë Arrëz UK	3,000	724	950	4,674	3,565	1,109	-
56 Bashkia Klos	-	-	-	-	-	-	-
57 Finiq UK	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI (000/Lekë)	400,000	596,864	59,046	1,055,910	1,040,909	485,164	470,163

Tabela 38, Aneks 8. Platforma në Excel

Shoqëria: <input style="width: 150px;" type="text"/>				
UJËSJELLËS + KANALIZIMET E UJËRAVE TË NDOTURA + IMPJANTI I TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA +IMPJANTI I TRAJTIMIT TË UJIT TË PIJSHËM				
Nr	Emërtimi	Njësia	Viti 2018	Shënime
Shërbimet e Ujësllës				
1	Popullsia në zonën juridiksionit *	nr		
2	Popullsia në zonën shërbimit të shoqërisë *	nr		
3	Popullsia që shërbehet me Çesma publike	nr		
4	Popullsia aktive me konsum uji *	nr		
5	Popullsia jo aktive *	nr		
6	Numri total i punonjësve *	nr		
7	Staf administrativ dhe organigrama e shoqërisë *	nr		
8	Vëllimi i ujit të prodhuar me sistemet me rrjedhje të lirë *	000 m³		
9	Vëllimi i ujit të prodhuar me sistemet me ngritje mekanike *	000 m³		
10	Vëllimi i ujit të shitur me shumicë *	000 m³		
11	Vëllimi i ujit të blerë me shumicë *	000 m³		
12	Vëllimi i ujit që hyn në rrjetin e shpërndarjes *	000 m³		
13	Vëllimi i ujit të prodhuar i matur	000 m³		
14	Vëllimi i ujit të prodhuar i vlerësuar*	000 m³		
15	Energjia totale e konsumuar Ujësllës	kwh		
16	Gjatësia e tubacioneve të rrjetit të transmetimit *	km		
17	Gjatësia e tubacioneve të rrjetit shpërndarës *	km		
18	Gjatësia totale e tubacioneve të Ujësllësit *	km		
19	Numri i defekteve në rrjetin e transmetimit *	nr		
20	Numri i defekteve në rrjetin e shpërndarjes *	nr		
21	Numri i lidhjeve të ujit me matës Familjarë	nr		
22	Numri i lidhjeve të ujit pa matës Familjarë	nr		
23	Numri i lidhjeve të ujit me matës Ente Private	nr		
24	Numri i lidhjeve të ujit pa matës Ente Private	nr		
25	Numri i lidhjeve të ujit me matës Institucione	nr		
26	Numri i lidhjeve të ujit pa matës Institucione	nr		
27	Volumi i ujit të faturuar klientë familjarë me matës	000 m³		
28	Volumi i ujit të faturuar klientë familjarë pa matës	000 m³		
29	Volumi i ujit të faturuar Ente Private me matës	000 m³		
30	Volumi i ujit të faturuar Ente Private pa matës	000 m³		
31	Volumi i ujit të faturuar Institucione me matës	000 m³		
32	Volumi i ujit të faturuar Institucione pa matës	000 m³		
33	Volumi i ujit të faturuar Shitje Shumice me matës	000 m³		
34	Shuma e ujit të faturuar familjarë me matës	000 lekë		
35	Shuma e ujit të faturuar familjarë pa matës	000 lekë		
36	Shuma e ujit të faturuar Ente Private me matës	000 lekë		
37	Shuma e ujit të faturuar Ente Private pa matës	000 lekë		
38	Shuma e ujit të faturuar Institucione me matës	000 lekë		
39	Shuma e ujit të faturuar Institucione pa matës	000 lekë		
40	Shuma e ujit të faturuar Shitje Shumice	000 lekë		
41	Totali i faturuar nga tarifa fikse - Familjare	000 lekë		
42	Totali i faturuar nga tarifë fikse - Ente Private	000 lekë		
43	Totali i faturuar nga tarifë fikse - Institucione	000 lekë		
44	Totali i faturuar e Familjareve nga tarifa volumetrike	000 lekë		
45	Totali i faturuar e Enteve Private nga tarifa volumetrike	000 lekë		
46	Totali i faturuar e Institucioneve nga tarifa volumetrike	000 lekë		
47	Totali i të faturuarave nga shërbime të tjera (lidhje, rilidhje, instalime etj)	000 lekë		
48	Totali të Faturuarave Ujësllës	000 lekë		
49	Kosto totale e punës - Ujësllës *	000 lekë		
50	Kosto e stafit administrativ - Ujësllës	000 lekë		
51	Kosto e kimikateve - Ujësllës *	000 lekë		
52	Kosto e energjisë - Ujësllës *	000 lekë		
53	Kosto qeraje - Ujësllës	000 lekë		
54	Kosto e riparimit dhe mirëmbajtjes - Ujësllës *	000 lekë		
55	Kosto e shërbimeve të kontraktuara - Ujësllës *	000 lekë		
56	Kosto e blerjes së ujit *	000 lekë		
57	Kosto të tjera operationale - Ujësllës *	000 lekë		
58	Kosto e karburanteve - Ujësllës	000 lekë		
59	Kosto të tjera - Ujësllës *	000 lekë		
60	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - Ujësllës	000 lekë		
61	Taksa dhe tatime - Ujësllës *	000 lekë		
62	Amortizimi - Ujësllës *	000 lekë		
63	Interesa + principal - Ujësllës *	000 lekë		
64	Provizione për rreziqe dhe shpenzime - Ujësllës *	000 lekë		
65	Shpenzime të tjera financiare - Ujësllës *	000 lekë		
66	Kosto Totale e Operimit (KTO) - Ujësllës	000 lekë		
67	Totali i arkëtuar nga aktiviteti kryesor Familjarë	000 lekë		
68	Totali i arkëtuar nga aktiviteti kryesor Ente Private	000 lekë		
69	Totali i arkëtuar nga aktiviteti kryesor Institucione	000 lekë		
70	Vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë	ore/dite		
71	Cilësia e ujit të pijshëm (Flet - Analiza nga Drejtoria e Higjienës)	n/a		

Shërbimet e Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura			
72	Popullsia në zonën e shërbimit të shoqërisë me kanalizime *	nr	
73	Gjatësia e tubacioneve prej betoni KUN	km	
74	Gjatësia e tubacioneve prej polietileni - plastike KUN	km	
75	Gjatësia totale e tubacioneve të Kanalizimeve	km	
76	Numri i bllokimeve të tubacioneve të kanalizimeve	nr	
77	Energjia totale e konsumuar Kanalizime	kwh	
78	Numri i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve Familjare	nr	
79	Numri i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve Ente Private	nr	
80	Numri i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve Institucione	nr	
81	Numrin i klienteve me gropa septike	nr	
82	Volumi i ujit të faturuar për kanalizimet klientë Familjarë	000 m³	
83	Volumi i ujit të faturuar për kanalizimet Ente Private	000 m³	
84	Volumi i ujit të faturuar për kanalizimet Institucione	000 m³	
85	Totali i faturuar me sistemin e kanalizimeve Familjarë	000 lekë	
86	Totali i faturuar me sistemin e kanalizimeve Ente Private	000 lekë	
87	Totali i faturuar me sistemin e kanalizimeve Institucione	000 lekë	
88	Totali i të faturuarave nga tarifet e tjera (lidhje, rilidhje, instalime etj.)KUN	000 lekë	
89	Totali i të Faturuarave KUN	000 lekë	
90	Kosto totale e punës - KUN *	000 lekë	
91	Kosto e stafit administrativ - KUN	000 lekë	
92	Kosto e kimikateve - KUN *	000 lekë	
93	Kosto e energjisë - KUN *	000 lekë	
94	Kosto qeraje - KUN	000 lekë	
95	Kosto e riparimit dhe mirëmbajtjes KUN *	000 lekë	
96	Kosto e shërbimeve të kontraktuara KUN *	000 lekë	
97	Kosto të tjera operationale - KUN	000 lekë	
98	Kosto e karburanteve - KUN	000 lekë	
99	Kosto të tjera KUN *	000 lekë	
100	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - KUN	000 lekë	
101	Taksa dhe tatime - KUN *	000 lekë	
102	Amortizimi - KUN *	000 lekë	
103	Interesa + principali KUN *	000 lekë	
104	Provizione për rreziqe dhe shpenzime - KUN *	000 lekë	
105	Shpenzime të tjera financiare - KUN *	000 lekë	
106	Kosto Totale e Operimit (KTO) - KUN	000 lekë	
107	Totali i arkëtuar nga aktiviteti i kanalizimeve Familjarë	000 lekë	
108	Totali i arkëtuar nga aktiviteti i kanalizimeve Ente Private	000 lekë	
109	Totali i arkëtuar nga aktiviteti i kanalizimeve Institucione	000 lekë	
Shërbimet e ITUN			
110	Popullsia që shërbehet nga ITUN nëpërmjet sistemit të kanalizimeve *	nr	
111	Popullsia që shërbehet nga ITUN nëpërmjet autoboteve per gropat septike *	nr	
112	Popullsia totale që i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujrave të ndotura *	nr	
113	Energjia totale e konsumuar ITUN	kwh	
114	Numri i lidhjeve të kanalizimeve Familjare që shkarkojnë në ITUN	nr	
115	Numri i lidhjeve të kanalizimeve Ente Private që shkarkojnë në ITUN	nr	
116	Numri i lidhjeve të kanalizimeve Institucione që shkarkojnë në ITUN	nr	
117	Numri total i lidhjeve që shkarkojnë në ITUN (Kanalizime dhe Bote)	nr	
118	Vëllimi i ujit të trajtuar Familjar që faturohet nga ITUN	000 m³	
119	Vëllimi i ujit të trajtuar Ente Private që faturohet nga ITUN	000 m³	
120	Vëllimi i ujit të trajtuar Buxhetore që faturohet nga ITUN	000 m³	
121	Shuma e faturuar nga ITUN - Familjar	000 lekë	
122	Shuma e faturuar nga ITUN - Ente Private	000 lekë	
123	Shuma e faturuar nga ITUN - Institucione	000 lekë	
124	Totali i të Faturuarave ITUN	000 lekë	
125	Kosto totale e punës - ITUN *	000 lekë	
126	Kosto e kimikateve - ITUN *	000 lekë	
127	Kosto e energjisë - ITUN *	000 lekë	
128	Kosto qeraje - ITUN	000 lekë	
129	Kosto e riparimeve dhe mirëmbajtjes - ITUN *	000 lekë	
130	Kosto e shërbimeve të kontraktuara - ITUN *	000 lekë	
131	Kosto të tjera operationale - ITUN	000 lekë	
132	Kosto e karburanteve ITUN	000 lekë	
133	Kosto të tjera - ITUN *	000 lekë	
134	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - ITUN	000 lekë	
135	Taksa dhe Tatime - ITUN *	000 lekë	
136	Amortizim - ITUN *	000 lekë	
137	Interesa + principali ITUN *	000 lekë	
138	Provizione dhe rreziqe - ITUN *	000 lekë	
139	Shpenzime të tjera financiare - ITUN *	000 lekë	
140	Kosto Totale e Operimit (KTO) - ITUN	000 lekë	
141	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujërave (ITUN) - F	000 lekë	
142	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujërave (ITUN) - EP	000 lekë	
143	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujërave (ITUN) - IN	000 lekë	

Shërbimet e ITUP			
144	Popullsia që shërbehet nga ITUP *	nr	
145	Numri total i punonjësve *	nr	
146	Energjia totale e konsumuar ITUP	kwh	
147	Vëllimi i ujit që futet në impjant për tu trajtuar *	000 m ³	
148	Kosto totale e punës - ITUP	000 lekë	
149	Kosto e kimikateve dhe materialeve teknologjike - ITUP *	000 lekë	
150	Kosto e energjisë - ITUP	000 lekë	
151	Kosto qeraje - ITUP	000 lekë	
152	Kosto e riparimeve dhe mirëmbajtjes - ITUP	000 lekë	
153	Kosto e shërbimeve të kontraktuara - ITUP	000 lekë	
154	Kosto e karburanteve ITUP	000 lekë	
155	Kosto të tjera operacionale - ITUP	000 lekë	
156	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - ITUP	000 lekë	
157	Taksa dhe Tatime - ITUP	000 lekë	
158	Amortizim - ITUP	000 lekë	
159	Interesa + principali ITUP	000 lekë	
160	Provizione dhe rrezique - ITUP	000 lekë	
161	Shpenzime të tjera financiare - ITUP	000 lekë	
162	Kosto Totale e Operimit (KTO) - ITUP	000 lekë	
Të Dhëna në Total për të tre Shërbimet (U + KUN + ITUN +ITUP)			
163	Shuma totale e arkëtuar nga tarifa fikse (F + EP + IN)	000 lekë	
164	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti kryesor (Uje+KUN+ITUN) - F	000 lekë	
165	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti kryesor (Uje+KUN+ITUN) - EP	000 lekë	
166	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti kryesor (Uje+KUN+ITUN) - IN	000 lekë	
167	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti i shitjes me shumicë të ujit	000 lekë	
168	Shuma Totale e Arkëtuar nga të gjitha veprimtaritë Ujësjetës	000 lekë	
169	Shuma Totale e Arkëtuar nga të gjitha veprimtaritë KUN	000 lekë	
170	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujrave ITUN	000 lekë	
171	Shuma e arkëtuar nga debitorët *	000 lekë	
172	Shuma Totale e Arkëtimit koherent *	000 lekë	
173	Shuma Totale e Subvencioneve operacionale	000 lekë	
174	Ankesa nga konsumatorët	nr .	
175	Aktivitet Afatgjatë *		
176	Aktive Afatgjatë Jomateriale	000 lekë	
177	Toka	000 lekë	
178	Ndërtesa	000 lekë	
179	Impjante, makineri dhe mjete	000 lekë	
180	Tubacione	000 lekë	
181	Pajisje zyre e informatike	000 lekë	
182	Inventar i imet afatgjatë *	000 lekë	
183	Parapagime për aktive materiale dhe në proces *	000 lekë	
184	Totali i Aktiveve	000 lekë	
185	Shtesat dhe Pakësimet *		
186	Aktive Afatgjatë Jomateriale	000 lekë	
187	Toka	000 lekë	
188	Ndërtesa	000 lekë	
189	Impjante, makineri dhe mjete	000 lekë	
190	Tubacione	000 lekë	
191	Pajisje zyre e informatike	000 lekë	
192	Inventar i imët afatgjatë	000 lekë	
193	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	000 lekë	
194	Totali i ndryshimeve në Aktive Afatgjatë	000 lekë	
195	Amortizimi i akumuluar *		
196	Aktive Afatgjatë Jomateriale	000 lekë	
197	Toka	000 lekë	
198	Ndërtesa	000 lekë	
199	Impjante, makineri dhe mjete	000 lekë	
200	Tubacione	000 lekë	
201	Pajisje zyre e informatike	000 lekë	
202	Inventar i imët afatgjatë	000 lekë	
203	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	000 lekë	
204	Totali i Amortizimit të Akumuluar	000 lekë	
205	Baza e Aseteve të Rregulluara	000 lekë	
* Për detaje të hollësishme shiko Udhëzuesin			

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

